



Duke u ngritur në shërbim

Instituti Ruhi



Libri 2

Duke u ngritur në shërbim

Instituti Ruhi

Librat në Seri:

Më poshtë janë titujt në seri të planifikuara nga Instituti Ruhi. Librat janë caktuar që të përdoren si sekuenca kryesore në një përpjekje sistematike për të rritur kapacitetin e të rinjve dhe të rriturve për t'i shërbyer komuniteteve të tyre. Instituti Ruhi gjithashtu po zhvillon një strukturë kursesh që degëzohen nga libri i tretë në seri për trajnimin e mësuesve të klasave Bahá'í për fëmijë, ashtu si edhe një tjetër seri prej Librit 5 për ngritjen në shërbim të animatorëve të grupeve të para të rinjve. Këto gjithashtu, janë treguar në listën më poshtë. Duhet theksuar se lista do të ndryshojë ndërkohë që eksperiencia në këtë degë përparon dhe do të shtohen titujt të ri ndërkohë që një numër në rritje elementësh kurrikulare në zhvillim arrijnë fazën në të cilën mund të bëhen të gjerësisht të disponueshme.

- Libri 1 *Reflections on the Life of the Spirit*
- Libri 2 *Duke u ngritur në shërbim*
- Libri 3 *Klasa fëmijësh, nivel 1*
Klasa fëmijësh, nivel 2 (kurs degë)
Klasa fëmijësh, nivel 3 (kurs degë)
Klasa fëmijësh, nivel 4 (kurs degë)
- Libri 4 *Manifestimet Binjake*
- Libri 5 *Duke çliruar mundësitë e para të rinjve*
Impulsi Fillestar: Kursi i degës së parë të Librit 5
Rrethi Zgjerues: Kursi i degës së Dytë të Librit 5
- Libri 6 *Mësimdhënia e Kauzës*
- Libri 7 *Duke ecur së bashku në rrugën e shërbimit*
- Libri 8 *Besëlidhja e Bahá'u'lláh*
- Libri 9 *Të fituari e një Perspektive Historike*
- Libri 10 *Ndërtimi Komuniteteve Aktive*
- Libri 11 *Mjetet Materiale*
- Libri 12 *(në përgatitje)*
- Libri 13 *Angazhimi në Veprime Sociale*
- Libri 14 *(në përgatitje)*

Copyright © 1999, 2021 nga Ruhi Foundation, Kolombi
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Botimi 2.1.1.PE i botuar në dhjetor 2021

Originally published in Spanish as *Levantémonos a servir*
Copyright © 1987, 1996, 2020 by the Ruhi Foundation, Colombia
ISBN 978-958-52941-0-3

Permission for a limited printing of this book in Albanian has been granted by the Ruhi Institute.

Ruhi Institute
Cali, Colombia
Email: instituto@ruhi.org
Website: www.ruhi.org

Asambleja Shpirtërore Kombëtare e Bahá'í-ve të Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri
nsa@bahai.al
www.bahai.al

Pasqyra e lëndës

Disa ide për lehtësuesit	v
Gëzimi i të mësuarit.....	1
Biseda frymëzuese.....	17
Tema thellimi.....	37

Disa ide për lehtësuesit

Ky libër, i dyti në sekuencën kryesore të kurseve të ofruara prej Institutit Ruhi, ka lidhje me aftësitë që na mundësojnë ne, të kontribuojmë në biseda kuptimplote dhe frymëzuese. Veprimi specifik i shërbimit në të cilin fokusohet libri përshkruhet në seksionin e tretë. Në një botë në të cilën forca të fuqishme janë duke bërë copash lidhjet shoqërore, praktika e vizitimit të miqve dhe fqinjëve në shtëpitë e tyre për të eksploruar tema kryesore për jetën e shoqërisë, nëse bëhet një tipar i qartë kulturor, mundet të shërojë disa prej sëmundjeve të shkaktuara prej izolimit në rritje. Lidhjet e miqësisë të krijuara kështu, sugjeron seksioni, shërbejnë të forcojnë procesin e ndërtimit të komuniteteve aktive dhe të harmonike.

Një program i mbështetur vizitash në shtëpi në një lagje apo fshat ka nevojë për një shkallë organizimi, duke përfshirë një bërthamë miqsh të përkushtuar, të mbështetur prej institucioneve dhe agjencive të nevojshme administrative. Në udhëheqjen e një grupi përmes një libri, lehtësuesi duhet të ngulitë në mendje që pjesëmarrësit janë duke u përgatitur t'i bashkohen një përpjekjeje të tillë të vazhdueshme. Vizita të planifikuara për ta si një përbërës i studimit të tyre duhet të çojnë në një angazhim për të marrë pjesë në këtë përpjekje vit pas viti, aspekt i rëndësishëm ky i një jete shërbimi.

Praktika e vizitave në shtëpi për qëllimin e sinqertë të eksplorimit të çështjeve me domethënie shpirtërore dhe shoqërore pasuron qartësisht kulturën e një komuniteti. Po ka jetësore në këtë aspekt janë shumë nga diskutimet jozyrtare të cilat ngjasin në shtëpi dhe në vendin e punës, në shkollë dhe në treg. Për të prezantuar parime shpirtërore në bisedat e përditshme hera herës, është një aftësi e cila meriton vëmendje. Zhvillimi i sajë është fokusi i seksionit të dytë, duke shtruar në këtë mënyrë një themel për studimin që ndërmerret tek i treti.

Nëse bisedat tona me miqtë dhe fqinjët behen që të jenë frymëzuese, atëherë duhet të jemi në gjendje të sjellim gëzim në bashkëveprimet tona me ta. Kjo temë trajtohet në seksionin e parë, "Gëzimi i Mësimdhënies". Të gjitha veprimet e shërbimit të rekomanduara prej Institutit Ruhi përfshijnë, në thelb, ndarjen me të tjerët të perlave të urtësisë Hyjnore të cilat i zbulojmë në oqeanin e Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut. Studimi i seksionit të parë ka për qëllim të zgjerojë ndërgjegjësimin e gëzimit të pandarë në këtë përpjekje. Pjesëmarrësit pyeten rreth disa seksioneve për të menduar rreth Fjalës së Zotit dhe se çfarë bekimi është ta ndash atë me të tjerët. Nga ky veprim, njësia propozon, rrit gëzimin i cili gjallëron hapat tanë ndërkohë që ne ecim në shtegun e shërbimit. Sidoqoftë, edhe kur jemi plotësisht të bindur prej kësaj të vërtete thellësisht shpirtërore, ne mund ta humbasim gëzimin e mësimdhënies nëse dështojmë të mendojmë rreth vetive dhe qëndrimeve të cilat duhet të dallojnë shërbimin. Këto janë objekt diskutimi në shumë libra pasues të serisë, dhe pak syresh hulumtohen këtu, duke filluar me shkëputjen në Pjesën 7.

Një përzgjedhje citatesh nga Shkrimet Bahá'í formojnë themelin për reflektim mbi këtë veti, një veti e domosdoshme nëse faktorë të jashtëm nuk duhet të zvogëlojnë gëzimin e

mësimdhënies. Ajo çfarë është e rëndësishme është që pjesëmarrësit të mos largohen nga studimi i tyre me nocionin e gabuar se shkëputja nënkupton ftohtësi apo mungesë kujdesi. Ne duhet në mënyrë të vazhdueshme të përpiqemi të intensifikojmë përpjekjet tona dhe të rrisim efikasitetin e shërbimit tonë ndërkohë që ne përpiqemi të arrijmë rezultate gjithmonë e më të mira. Kjo kërkon një të kuptuar të mjaftueshëm të karakterit të përpjekjes, një temë kjo që trajtohet në Pjesën 8. Optimizmi dhe mirënjohja, dy veti themelore për shtegun e shërbimit, diskutohen shkurtimisht në seksionin tjetër dhe atë final.

Seksioni i dytë i librit, “Biseda Frymëzuese”, fokusohet mbi aftësinë për të ngritur nivelin e bisedave joformale duke ju referuar parimeve shpirtërore kur jepet rasti. Ajo konsiston në një numër fjalish të shkurtra në tema të ndryshme, që edhe pse nuk janë citate të sakta bazohen në thëniet e ‘Abdu’l-Bahá’-it dhe përfshijnë shumë prej fjalëve dhe frazave që Ai përdorte. Si një thirrje Universale, ato u flasin aspiratave dhe shqetësimeve të njerëzve të të gjitha shtresave kulturore. Shpresohet se, duke studiuar thëniet, pjesëmarrësit do të fitojnë frymëzim nga mënyra në të cilën ‘Abdu’l-Bahá’-i shpjegonte parimet shpirtërore dhe do të fitojnë zakonet për të kthyer shikimin tek Ai ndërkohë që përpiqen të zbulojnë perlat që ka në oqeanin e Revelacionit të Bahá’u’lláh-ut, të kuptojnë domethënien dhe implikimet e mësimave të Atit të Tij dhe t’i ndajnë ato me bujari me të tjerët.

Për të arritur qëllimin e seksionit, pjesëmarrësve duhet tu jepet mundësia që ta kalojnë secilën fjalë disa herë, të identifikojnë sekuencën e mendimit dhe të praktikojnë së thëni atë deri sa ata të jenë kaq të familjarizuar me idetë saqë, ata mund t’i shprehin ato natyrshëm. Disa, si fillim, në parim do të memorizojnë fjalitë dhe t’i përsërisin ato pak a shumë në mënyrën që ato janë shfaqur në seksion. Kjo duhet të pritët prej tyre. Ndërkohë që njohuria për Besimin thellohet dhe eksperiencia e tyre rritet, ata do të kenë akses në një sasi më të madhe përmbajtjeje dhe një fjalori më të pasur, gjë që do të reflektohet në bashkëpunimet e tyre me të tjerët. Lehtësuesi duhet të kuptojë që, në këtë fazë, ajo që kërkohet është e dyfishtë: një masë lehtësimi në shpjegimin e mësimave dhe të përputhurit me mendimin e ‘Abdu’l-Bahá’-it.

Pasi anëtarët e grupit mësojnë sesi të prezantojnë përmbajtjen e çdo thëniejeje, ata kalojnë në një aktivitet tjetër në të cilin ata inkurajohen të lidhin idetë që ata kanë studiuar me probleme shqetësuese për familjet e tyre, miqtë dhe bashkëpunëtorët. Për këtë qëllim, atyre u është kërkuar të mendojnë rreth disa temave dhe pyetjeve të ngritura në bisedë dhe të vendosin se cilat do tu ofrojnë atyre mundësinë e prezantimit të ideve në një diskutim. Për disa thënie, përmenden një ose dy shembuj për të ilustruar sesi parimet shpirtërore të shpalluara prej ‘Abdu’l-Bahá’-it hedhin dritë mbi çështje që janë gjithandëj shqetësim për njerëzit.

Ky ushtrim do të japë frute më të mira nëse, ndërkohë që studimi i librit është akoma në progres, lehtësuesi është në gjendje të ndihmojë çdo anëtar në zgjedhjen e thënieve dhe me një çift individësh të bisedojë mbi idetë që përmbajnë. Në këtë mënyrë, mund të lihet kohë për pjesëmarrësit, kur takohen së bashku, për t’i përshkruar njëri-tjetrit dinamikën e bisedave në të cilat ata janë angazhuar.

Për çdo thënie në seksion, disa pasazhe nga Shkrimet e Bahá’u’lláh-ut janë përfshirë për memorizim. Theksin që Instituti Ruhi vendos tek memorizimi, tashmë i dukshëm në librin e parë të serive, bëhet më e theksuar në Librin 2. Pretendohet se, tashmë, pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm për ushqimin shpirtëror që ata marrin nga sjellja në kujtesë e pasazheve prej Shkrimeve hera herës. Në këtë libër, atëherë, ata do të reflektojnë më tej për efektet e Fjalës së Zotit mbi zemrën njerëzore, dhe në seksionin e tretë, si në të dytin, ata do të mësojnë të prezantojnë parime dhe ide të gjetura në Shkrimet në të shprehurën e tyre dhe kur të jetë e përshatshme, do të citojnë pasazhe drejtpërdrejti. Për të shpjeguar mësimet me qartësi, duke

ua dhënë ato të tjerëve në formën e tyre të pastër, është midis aftësive që të gjithë ne kërkojmë të zhvillojmë ndërkohë që ecim në shtegun e shërbimit. Kështu një pikë nisje e shkelqyer duke filluar me studimin e shpjegimeve të ‘Abdu’l-Bahá’-it dhe duke u përpjekur për të shprehur ato në mënyrën që Ai i shprehte, është kushti paraprak i cili nënvizon strukturën e seksionit të dytë.

Siç përshkruhet më sipër, seksioni i tretë, i titulluar “Tema Thellimi”, u kthehet veprave të shërbimit të trajtuara në këtë libër- që është, tu bëhen vizita miqve dhe fqinjëve për qëllimin e sinqertë të angazhimit në biseda jetësore për jetën e komunitetit. Tre tipe bisedash janë parashikuar në seksion dhe, për secilin, sugjerohet përmbajtje specifike. Lloji i parë vërtitet rreth një serie temash për tu eksploruar me banorët e fshatit apo të lagjes në një program vizitash sistematike. Megjithëse përmbajtja e ravijëzuar mund të ndahej më së miri me auditore të interesuara në një shumëllojshmëri mënyrash, qëllimi fillestar i temave – për tu siguruar anëtarëve të shtëpsië mundësinë ta thellojnë dijen e Besimit – mbetet më i spikatur. Pjesa më e madhe e seksionit, pra, i dedikohet kësaj lloji bisede.

Tashmë, praktika e vizitave në shtëpi ka marrë dimensione të reja në vitet e fundit, veçanërisht kur njësi gjithnjë e më të vogla gjeografike, gjatë gjithë rrugës për tek niveli i fshatit dhe lagjeve urbane, kanë parë një rritje në numër të individëve të cilët mundën të veprojnë si lehtësues, animatorë të grupeve të para të rinjve dhe mësues të klasave të fëmijëve. Vihet re, se praktika ka treguar ne vetëvete të jetë thelbësore, jo vetëm për qëllimin e shpalljes së njohurisë së Besimit; por gjithashtu është e detyrueshme për shpalosjen e suksesshme të programeve për fuqizimin shpirtëror të para të rinjve dhe për edukimin shpirtëror të fëmijëve. Në këtë drejtim, ajo që është bërë e qartë është që vizitat e rregullta janë të nevojshme të ndërmerren nga animatorët dhe mësuesit tek prindërit e të rinjve në dy programet për të diskutuar konceptet dhe qasjet të cilat u japin atyre formë. Diskutime të tilla përbëjnë një lloji të dytë bisede, e cila hulumtohet në Pjesën 14 dhe 15. Përmbajtja e mbuluar në këto pjesë nuk është e gjerë, sepse pjesëmarrësit do të bëhen shumë më të njohur me dy programet arsimore në kurset e ardhshme. Por që ata të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij lloji të bisedës dhe të shoqërojnë mësuesit e fëmijëve dhe animatorët e grupeve të para të rinjve në vizitat e tyre te prindërit mund të rezultojë shumë i frytshëm në këtë fazë të hershme.

Një lloji i tretë bisede i parashikuar në seksion i shërben një qëllimi shumë të veçantë. Kaq shumë të rinj e të reja janë duke kërkuar për rrugë përmes së cilave mund të gjejë shprehje dëshira e tyre e zjarrtë për të kontribuar për përmirësimin e botës. Ato përfaqësojnë një rezervuar të pamatë të kapaciteti për të ndryshuar shoqërinë, i cili jo vetëm është në pritje por është përrmalluar të shfrytëzohet. Një bisedë midis moshatarësh në të cilën ata reflektojnë mbi mundësitë dhe përgjegjësitë unike për periudhën e rinisë, me të gjithë energjinë e vetë dhe potencialin e jashtëzakonshëm, mundet, shumë më shpesh, të çojë në diskutime rreth shërbimit dhe të ndezi interesin në punën në proces e sipër në fshatra dhe lagje përreth globit. Shumë veta do të mirëpresin një ftesë për t’ju bashkuar kurseve të institutit si një mjet për të fituar kapacitet për të siguruar edukim shpirtëror për breza që rriten si mësues klasash fëmijësh dhe animatorë të grupeve të para të rinjve. Pjesa 9 dhe 10 synojnë disa ide të cilat mund të eksplorojnë në këtë lloji bisede.

Për të forcuar aftësisë që u mundësojnë individëve të fillojnë dhe të mbështesin biseda kuptimplotë, seksioni duhet, sigurisht, të shkojë përtej sugjerimit të temave të gjera dhe përmbajtjes përkatëse. Përveç aftësisë për të artikuluar idetë me qartësi, pjesëmarrësit duhet të zhvillojnë qëndrimet e nevojshme dhe cilësitë shpirtërore. Këto theksohen në shumicën e shpjegimeve që shpalosen në seksion, por rëndësia e tyre për aftësitë që po diskutojmë bëhet e qartë në Pjesën 4, ku pjesëmarrësit mendojnë rreth cilit lloji të ndjenjave dhe mendimeve duhet të mbushin zemrat dhe mendjet tona në përgatitjen për një vizitë, si dhe në Pjesën 5, ku ata

reflektojnë mbi cilësitë e përljes. Lehtësuesi do të dëshirojë të sigurojë që këto pjesë marrin vëmendje të mjaftueshme prej pjesëmarrësve, pasi pavarësisht sesa njohuri ne fitojmë, pavarësisht sesa mirë ne i artikulojmë idetë, efektiviteti i bisedave tona do të varet mbi cilësitë dhe qëndrimet që ne u ofrojmë atyre.

Duhet theksuar se veprat e shërbimit të përshkruara në këtë seri librash, megjithëse qëndrore për rritjen dhe zhvillimin e komunitetit, janë mbi të gjitha elementet e një procesi që kërkon të ngrejë kapacitetin individual përmes studimit dhe veprimit. Ajo që çdo lehtësues duhet të kuptojë është se këto vepra ndërtohen mbi njëra tjetrën, duke u rritur në terma kompleksiteti nga libri në libër. Të mësuarit për të kryer çdo vepër të shërbimit në mënyrë efektive dëshmon se është thelbësore për aftësinë e kërkuar për të kryer ato që pasojnë. Për të mirëmbajtur një bisedë të vazhdueshme gjatë serisë të disa vizitave në një shtëpi, siç është propozuar në këtë libër, është qartësisht më shumë kërkuese sesa aktiviteti i inkurajuar në Librin 1, ai i një takimi të rregullt devocional, ose në vetminë e dikujt apo në bashkëpunim me pak të tjerë. Dhe nuk është e vështirë të kuptosh që, të ndërmarrësh veprimet komplekse të shërbimit ne vijim, do të jetë thelbësore për pjesëmarrësit përparimi në aftësitë e trajtuara këtu.

Siç u përmend në shënimet e prezantimit në Librin 1, pjesëmarrësit në kurset e institutit në mbarë botën vijnë nga një diversitet prejardhje kulturore dhe si fillim kanë një shkallë të ndryshme familjariteti me mësimet Bahá'í. Në kohën kur ata fillojnë këtë libër të dytë, ata do të kenë filluar me të vërtetë, secili dhe të gjithë, shtegun e shërbimit të hapur para tyre prej kurseve. Por disa dallime mbeten. Në rastin e të rinjve, për shembull, nëse nuk kanë kaluar përmes programeve të edukimit për fëmijë dhe para të rinj, shumë prej thënieve dhe temave të prezantuara në libër do të jenë të reja për ta dhe studimi i tij do të shërbejë si një mjet për të thelluar njohurinë e tyre për Besimin. Lehtësuesi duhet të jetë i gatshëm në këtë drejtim për të shfaqur fleksibilitetin dhe kreativitetin e nevojshëm për të ushqyer të kuptuarit në çdo anëtar të grupit, ndërsa sigurohet që qëllimi kryesor i kursit, për t'i mundësuar pjesëmarrësve të përfshihen në një bisedë kuptimplote dhe ngritëse, është arritur. Për më tepër, në mijëra lokalitete ku po përdoret libri, procesi i ndërtimit të komunitetit në të cilin të tre njësitë kërkojnë të kontribuojnë nuk është në të njëjtën pikë të zhvillimit.

Vënia në veprim e asaj që është mësuar, veç kësaj, mund të marrë një formë deri diku të ndryshme nga njëri lokalitet tek tjetri dhe kjo gjithashtu siguron një të dhënë të kujdesit dhe thellësisë me të cilën një lehtësues duhet tu përgjigjet nevojave të çdo anëtari kur drejton një grup përmes këtyre faqeve.



Gëzimi i të mësuarit

Qëllimi

Të kuptojmë që gëzimi i të mësuarit qëndron
në vetë aktin e ndarjes me të tjerët
së Fjalës së Perëndisë

PJESA 1

Të Ngrihesh të Shërbesh është i dyti në një sekuençë kursesh të ofruara prej Institutit Ruhi të cilat kërkojnë të kombinojnë studimin me veprimin. Qëllimi i tyre është të të ndihmojnë ty të përparosh më tej përgjatë rrugës së shërbimit në të cilën ke hyrë ndërkohë që përpiqesh të përmbushësh një qëllim të dyfishtë: të ndjekësh rritjen tënde shpirtërore dhe intelektuale dhe të kontribuosh në transformimin e shoqërisë. Nga pjesëmarrja jote në kursin e parë, ti duhet të kuptosh tashmë se rruga të cilës ne i referohemi karakterizohet prej një radhe veprash shërbimi, vepra të cilat i zbatojmë me sytë tanë të përqëndruar tek synimi për një rend të ri botëror siç është parashikuar në Shkrimet e Bahá'u'lláh. Si rrjedhim, shumë prej asaj të cilën e quajmë “ecja gjatë shtegut të shërbimit” konsiston në përpjekjet tona për t'i aplikuar mësimet e Tij në vetë jetët tona dhe në jetën e njerëzimit. Ai Vetë flet për Revelacionin e vetë me këto fjalë:

“O shërbëtorë të Mi! Revelacioni Im i shenjtë dhe i urdhëruar në mënyrë hyjnore mund të krahasohet me një oqean, në thellësitë e të cilit fshihen margaritarë të panumërt me vlerë të madhe e me shkëlqim të pakrahasueshëm. Është detyrë e çdo kërkuesi të mobilizohet e të përpiqet të arrijë brigjet e këtij oqeani, për të mundur që, në përputhje me zellin e kërkimit e me përpjekjet që ka bërë, të ketë ato përfitime që janë caktuar në Tabelat e pakundërshtueshme e të fshehta të Perëndisë.”¹

Në këtë seksion të parë, mendimet tona i kthehen gëzimit që mbush zemrat tona ndërkohë që ne zbulojmë perlat e urtisë të cilat gjenden në oqeanin e Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut dhe i ndajmë ato me të tjerët. Tashmë prej studimit të Librit 1 juve keni parë sesa fine e të bukura janë perlat e udhëheqjes hyjnore që gjenden në Shkrimet e Tij. Le të meditojmë në ca pasazhe më shumë:

“Fjala e Perëndisë është një llambë, drita e së cilës janë këto fjalë: Ju jeni frytet e së njëjtës pemë dhe fletët e së njëjtës degë.”²

“Më e shumëdashura e të gjitha gjërave në sytë e Mi është drejtësia; mos u largo prej saj, nëse më do Mua, dhe mos e lër atë pasdore, që Unë të kem besim tek ti.”³

“Interesohuni me kujdes për hallet e epokës në të cilën jetoni dhe i përqendroni diskutimet tuaja në kërkesat e nevojat e saj.”⁴

“Të gjithë njerëzit janë krijuar për të çuar përpara një qytetërim që është në progres të vazhdueshëm.”⁵

“Bota merr fund dhe e përjetshme është vetëm dashuria e Perëndisë.”⁶

“Ti je llamba Ime dhe drita Ime është në ty. Merr ndriçim prej saj dhe mos kërk askënd tjetër veç Meje. Sepse Unë të kam krijuar të pasur dhe kam derdhur bujarisht mbi ty dashamirësinë Time.”⁷

Juve mund të keni dëshirë të mësoni përmendësh këto pasazhe të shkurtra me kohën.

PJESA 2

Për të filluar diskutimin tuaj rreth temës kryesore të kësaj njësie, rilexoni pasazhin e parë të cituar në pjesën e mësipërme dhe plotësoni ushtrimin në vijim:

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme.
 - a. Është detyra jonë të _____ e _____
_____ që të _____ e oqeanit të Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut.
 - b. Ne duhet të përpiqemi të arrijmë brigjet e oqeanit të Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut, në mënyrë që të mundim të ketë ato _____ që janë caktuar në Tabelat e pakundërshtueshme e të fshehta të Perëndisë.
 - c. Të mirat që marrim prej oqeanit të Bahá'u'lláh-ut do të jetë në përputhje me _____.
2. Ç'do të thotë “mobilizosh” veten? _____

3. Ç'do të thotë “të përpiqesh të arrish diçka”? _____

4. Çfarë duhet të përpiqet të arrijë çdo kërkues? _____

5. Ç'do të thotë të jetë diçka “në përputhje” me diçka tjetër? _____

6. Bahá'u'lláh-u na thotë se do të kemi përfitime nga oqeani i Revelacionit të Tij në përputhje me përpjekjet që bëjmë.
 - a. Jepni disa shembuj të përpjekjeve që mund të bëjmë në mënyrë që të kemi këto përfitime: _____

 - b. Jepni disa shembuj të përfitimeve që kemi: _____

PJESA 3

Duke e ditur që Revelacioni i Bahá'u'lláh·ut është si një oqean në thellësitë e të cilit ka margaritarë me vlerë të madhe, secili prej nesh bën të gjitha përpjekjet për të marrë pjesë nga përfitimet që ai sjell dhe për të ndihmuar të tjerët që të arrijnë brigjet e tij. Po sa e largët është rruga për në brigjet e këtij oqeani? Bahá'u'lláh thotë:

“O shërbëtorë të Mi! I vetmi Perëndi i vërtetë Më është dëshmitar! Ky Oqean kaq i madh, i pafund e i valëzuar është pranë, çuditërisht pranë jush. Shikoni, ai është më pranë jush sesa damari i qafës suaj! Veç të dëshironi dhe aq shpejt, sa të hapësh e mbyllësh sytë, ju mund ta arrini atë dhe të merrni nga ky favor i përjetshëm, nga kjo mirësi e dhënë prej Perëndisë, nga kjo dhuratë që s’ka prishje, nga kjo bujari e fuqishme dhe e lavdishme sa s’thuhet..”⁸

1. Çfarë gjëje i referohet fraza “ky oqean kaq i madh, i pafund e i valëzuar? _____

2. Sa pranë nesh është ky oqean? _____

3. Sa shpejt mund ta arrijmë ne këtë oqean? _____

4. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:
 - a. Oqeani kaq i madh i Revelacionit të Bahá'u'lláh·ut është pranë, _____
_____ nesh.
 - b. Oqeani i Revelacionit të Bahá'u'lláh·ut është _____ sesa damari i qafës sonë.
 - c. Shpejt, sa _____ ne mund, veç të dëshirojmë, _____ dhe _____ nga oqeani i Revelacionit të Tij.
 - d. Shpejt, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, _____, ta arrijmë e të marrim pjesë nga oqeani i Revelacionit të Tij.

PJESA 4

Pasi kemi arritur brigjet e oqeanit të Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut, ne marrim nga thesaret e tij dhe ndajmë lirshëm dhe në mënyrë të pakushtëzuar me të tjerët perlat e udhëheqjes hyjnore, të cilat i zbulojmë pareshtur në studimin, në lutje dhe në meditimin tonë dhe në përpjekjet tona për t'i shërbyer Kauzës së Tij dhe njerëzimit. Ju mund të keni dëshirë për të marrë pak kohë për të mësuar përmendësh pasazhin e mëposhtëm, një kujtues i vazhdueshëm i shenjtërisë së kësaj detyre:

“O udhëtar në shtegun e Perëndisë! Merr pjesën tënde të oqeanit të mirësisë së Tij dhe mos ia moho vetes gjërat që fshihen në thellësitë e tij. Ji ndër ata që kanë marrë pjesë në thesaret e tij. Një pikë e vetme e këtij oqeani, po të derdhej mbi të gjithë ata që janë në qiej e mbi tokë, do të mjaftonte për t'i mbushur ata me bujarinë e Perëndisë, të Gjithëfuqishmit, të Gjithëdijshmit, Urplotit. Merr me duart e braktisjes nga ujërat e tij jetëdhënëse dhe, përveç kësaj, spërkat të gjitha gjërat e krijuara, që ato të pastrohen nga të gjitha kufizimet e krijuara prej njeriut dhe t'i afrohen fronit të fuqishëm të Perëndisë, këtij Vendi të shenjtëruar e të ndritshëm.”⁹

PJESA 5

Ndërkohë që përparojmë përmes kurseve të Institutit, duke zbatuar studimin dhe veprimin që ato kërkojnë, kapaciteti ynë për shërbim do të rritet dhe ne do të jemi në gjendje të ndërmarrim vepra shërbimi të cilat sjellin gëzim pafund në zemrat tona dhe na ndihmojnë në në përmbushjen e qëllimit tonë të dyfishtë—vepra të tilla si mësimdhënia në edukimin shpirtëror të fëmijëve, angazhimi i para të rinjve në një program për fuqizimin e tyre shpirtëror dhe ndihmesa ndaj një grupi miqsh për të studiuar librat e sekuencës kryesore. Gjithandej në këtë udhëtim, Fjala e Zotit, të cilën do ta ndajmë me të tjerët, të rinj a të vjetër, do të jetë burimi ynë i vazhdueshëm i frymëzimit. Është e rëndësishme, pra, që të përsiatim thellësisht për fuqinë e Fjalës së Perëndisë dhe ndikimin e saj mbi zemrën njerëzore. Në citatin e mëposhtëm, Bahá'u'lláh.-u flet për këtë fuqi:

“Fjala e Perëndisë i ngjet një fidani, rrënjët e të cilit janë mbjellë në zemrat e njerëzve. Është detyra juaj ta ndihmoni rritjen e tij me ujërat e gjalla të urtisë, të fjalëve të kulluara e të shenjta, në mënyrë që rrënjët e tij të mund të ngulen thellë dhe degët e saj të përhapen deri në qiell e më tej.”¹⁰

1. Me se mund të krahasohet Fjala e Perëndisë? _____

2. Ku janë mbjellë rrënjët e pemës së Fjalës së Perëndisë? _____

3. Si mund ta ndihmojmë ne rritjen e kësaj peme? _____

 Në çfarë lartësish mund të rritet kjo pemë? _____
4. Shpjegoni me pak fjali pse ka rëndësi shumë të madhe të ndash Fjalën e Perëndisë me të tjerët.

PJESA 6

Mendoni tani për veprimtaritë e ndryshme me të cilat merremi në jetën tonë të përditshme. Ne ushqejmë trupat tanë. Studiojmë që të fitojmë njohuri të reja e të zgjerojmë aftësitë tona mendore. Ne punojmë dhe zhvillojmë aftësi të cilat na mundësojnë ne të jetojmë si anëtarë frytdhënës të shoqërisë. Ne merremi me sport dhe zbavitje. Veprimtari të shumta si këto, të gjitha të rëndësishme për përparimin intelektual dhe mirëqenien tonë materiale, zënë një pjesë të madhe të kohës sonë. Por ka në çdo ditë nga ato momente të veçanta, të mbushura me ndjenja shpirtërore, kur ne angazhohemi në lutje, kur ne thellojmë njohuritë tona, vetëm a me miq, mbi mësimet hyjnore; apo kur me një mijë mënyra, ne ndihmojmë ata rrotull nesh të zbulojnë perlat e fshehura në oqeanin e Revelacionit të Bahá'u'lláh'-ut. A nuk janë këto momente tej mase të çmuara? A ka gëzim më të madh se sa të jesh në gjendje të marrësh pjesë nga këto bekime qiellore?

Ne duhet ta kujtojmë gjithmonë sesi 'Abdu'l-Bahá-i na inkurajonte ne t'ja kushtonim veten tonë frymëzimit të njerëzimit:

“Ne të gjithë jemi të bashkuar në një qëllim të vetëm Hyjnor, ne nuk kemi asnjë synim material dhe dëshira jonë më e madhe është të përhapim dashurinë e Perëndisë në mbarë botën!”¹¹

Supozoni se ju krijohet mundësia që ju të ndani me një mik një prej citateve të Seksionit 1 të cilin ju e keni memorizuar. Prej nga buron gëzimi që ndjeni në zemrën tuaj? Natyrshëm, ju shpresoni se miku juaj do të frymëzohet prej fjalëve të Bahá'u'lláh'-ut. Por çfarë do të ndodhi nëse ai ose ajo nuk tregojnë entuziazmin që juve prisnit? A zhduket papritur gëzimi në zemrën tuaj? Pse jo?

PJESA 7

Kur ne kuptojmë që, nga të gjitha gjërat që bëjmë në jetën tonë, momentet që kalojmë duke ndarë Fjalën e Perëndisë me të tjerët janë të veshura me bekime të posaçme, ne arrijmë në një konkluzion shumë të rëndësishëm: që gëzimi që ne marrim prej shërbimit gjendet tek vetë shërbimi. Ne shpresojmë që, sigurisht, veprimet e shërbimit që ne ndërmarrim do të prodhojnë rezultate të vlefshme, por nëse jemi shumë të varur tek rezultatet, nëse ne ndikohemi së tepërmi prej lëvdatës apo kritikës, ne do të humbasim gëzimin e të dhënit mësim. Ajo që duhet të na frymëzojë për mësimdhënie është dashuria për Perëndinë e jo dëshira për sukses, për të pasur përfitime, apo për të fituar famë. Shkëputja prej të gjitha këtyre është një gjë e nevojshme për një shërbim të hareshëm. Studimi i citateve të mëposhtëm do t'ju ndihmojë të reflektoni mbi këtë temë:

“O njeri me dy pamje! Mbylle njërin sy dhe hap tjetrin. Mbylle njërin për botën e të gjitha gjërat që janë në të, dhe hape tjetrin për bukurinë e shenjtëruar të të Shumëdashurit.”¹²

“O Miq! Mos e braktisni bukurinë e përjetshme për një bukuri që duhet të vdesë, dhe mos ia kushtoni dashurinë tuaj kësaj bote të vdekshme prej pluhuri.”¹³

“O Bir i Fjalës! Ktheje fytyrën tënde nga Imja dhe hiq dorë prej të gjithëve veç Meje, sepse mbretëria Ime vazhdon dhe sundimi Im nuk merr fund. Po kërkove dikë tjetër veç Meje, sikur ti të kërkoje gjithësinë përgjithmonë, kërkesa jote do të jetë e kotë.”¹⁴

“O Mik i panjohur! Qiriu i zemrës sate është ndezur nga dora e fuqisë Sime, mos e shuaj atë me erërat e kundërta të egoizmit e të pasionit. Shëruesi i të gjitha sëmundjeve të tua është kujtimi për Mua, mos e harro këtë. Bëje dashurinë Time thesarin tënd dhe kujdesu për të si për syrin e për jetën tënde.”¹⁵

“Shkëputja është si dielli; në çfarëdo zemre që të shkëlqejë shuan zjarrin e lakmisë dhe të egos. Ai që e ka pamjen të ndriçuar me dritën e të kuptuarit me siguri do ta shkëpusë veten nga bota e kotësitë e saj... Le të mos ju brengosë bota dhe poshtërsitë e saj. Lum ai që pasuria nuk e fryn me vetëmburrje, dhe as e mbush me trishtim varfëria.”¹⁶

1. Të jesh i shkëputur nga kjo botë a do të thotë të jetosh si heremit? _____
-

2. A është e mundur të jesh i shkëputur nga bota dhe në të njëjtën kohë të zotërosh gjëra?

3. A është i shkëputur nga gjërat e botës një person që praktikisht i dedikon çdo orë të jetës punës së tij? _____

4. A është i shkëputur nga gjërat e botës një person që punon vetëm për të siguruar nevojat bazë të jetës dhe pjesën tjetër të kohës së vet e shpenzon duke mos bërë asgjë? _____

5. A është i shkëputur prej botës një njeri i paaftë të tolerojë mungesën e rehatisë materiale në fushën e shërbimit? _____
6. Ka shumë gjëra ndaj të cilave mund të jemi të varur përveç zotërimeve materiale. Ndaj çfarë gjërash do të ishe i varur nëse do të ishe një person i cili:
- dëshiron të dorëzohet kur ai ose ajo kryen një vepër shërbimi dhe askush nuk e vlerëson atë? _____
 - ndjehet i ligështuar kur dikush nuk i pranon idetë që ai apo ajo është duke ndarë? _____
 - fsheh ato që beson nga frika e refuzimit prej të tjerëve? _____
7. Shkëputja nuk nënkupton ftohtësi apo mungesë kujdesi. Cilat prej këtyre më poshtë mund të ishin një shenjë kur dikush nuk është i shkëputur?
- _____ Të provosh gëzim kur sheh të tjerët të përparojnë
 - _____ Të ndalosh së dhëni mësim në një klasë kur disa fëmijë sillen keq
 - _____ Të mburresh rreth arritjeve të tua
 - _____ Të studiosh shumë dhe të ndihesh i kënaqur me përparimin tënd
 - _____ Të punosh shumë për të zhvilluar kapacitetin tënd për t'i shërbyer të mirës së përbashkët
 - _____ Të përpiqesh për shkëlqyeshmëri në angazhimet e tua
 - _____ Të ushtrosh pastërtinë dhe të mbash një shtëpi të pastër dhe të rregullt
 - _____ Të kujdesesh për zotërimet e tua
 - _____ Të kujdesesh për mirëqënien e të tjerëve
 - _____ Të shkuraqohesh kur nuk lëvdohesh për përpjekjet e tua

8. Kaq e rëndësishme është shkëputja për secilin nga ne sa që ju sugjerohet të mësoni përmendësh të gjitha citatat e kësaj pjese.

PJESA 8

Për të marrë bekimet e një jete të gëzueshme shërbimi ndaj njerëzimit, ne duhet të kemi dëshirë të ushtrijmë përpjekje, dhe përpjekjet tona mund të kërkojnë një shkallë të caktuar sakrifice. Ne e përdorim shpesh fjalën “sakrificë” në jetën tonë të përditshme. Nëse një mik po kthehet nga një udhëtim herët në mëngjes, ne duhet të zgjohemi herët për ta pritur atë. Në këtë rast themi se kemi sakrifikuar disa orë gjumë. Dikush që është i dashur për ne mund të jetë sëmurë; ne heqim dorë nga disa orë nga koha jonë e lirë për t’u kujdesur për të. Ka raste në jetë kur ne duhet të punojmë jashëtzakonisht shumë dhe mund të mendojmë se po sakrifikojmë rehatinë me qëllim për të arritur një synim.

Ne të gjithë kemi dëshirën më të madhe për t’i shërbyer Kauzës, duke ofruar me bujari kohën dhe energjinë tonë dhe, në masën e duhur, një pjesë të burimeve tona materiale. Kur bëjmë këtë, ne duhet të kujtojmë që në shtegun e shërbimit, mund të heqim dorë prej gjërave të kësaj bote, por ajo që ne marrim është gëzimi i vërtetë, ndërkohë që rritemi shpirtërisht. Ne do të kemi mundësinë për të reflektuar më shumë mbi natyrën e sakrificës në kurset e ardhshme. Ajo që është e rëndësishme për tu dalluar qysh prej fillimit është se ajo përfshin mohimin e asaj që është më e ulët për atë që është më e lartë, ashtu si fara sakrifikon vetveten në mënyrë që një pemë të mund të mbijë. Sakrifika është mbartësja e gëzimit dhe ky gëzim nuk do të jetë yni, nëse nuk jemi të gatshëm të bëjmë përpjekje të vazhdueshme.

Bahá’u’lláh pohon:

“Puna e zellshme është e nevojshme nëse ne kërkojmë Atë; pasioni është i nevojshëm nëse duam të pimë nga mjalti i bashkimit me Të; dhe nëse shijojmë nga kjo kupë, do ta flakim tej botën.”¹⁷

Dhe ‘Abdu’l-Bahá na këshillon:

“... mos pushoni, mos kërkonit qetësi, mos rendni pas kënaqësive të kësaj bote jetëshkurtër, çlirojeni veten nga çdo lidhje me të dhe përpiquni me mish e me shpirt të vendoseni plotësisht në Mbretërinë e Perëndisë. Fitoni thesaret qiellore. Bëhuni çdo ditë e më të ndriçuar. Qasuni gjithnjë e më pranë pragut të njëshmërisë.”¹⁸

Ne të gjithë besojmë se, për të arritur qëllimet tona, na duhet të ushtrijmë përpjekje. Por ky besim i thjeshtë ka implikime të caktuara në praktikë të cilat ne nuk duhet t’i harrojmë. Pikë së pari, është e nevojshme të kujtojmë se ka një lidhje midis sasisë së energjisë së kërkuar dhe nivelit të vështirësisë së qëllimit apo të detyrës që kemi në dorë. Jemi duke mashtruar veten nëse mendojmë se mund të arrihet me më pak mundime. Por shkalla e ushtrimit nuk është i vetmi faktor për tu marrë në konsideratë. Ka nevojë për qëndrueshmëri dhe këmbëngulje. Nevojitet fokusim. Është thelbësor zakoni i përfundimit të detyrave dhe jo kapërcimi nga një detyrë tek një tjetër, duke e lënë punën të papërfunduar. Përpjekjet me gjysëm zemër nuk

mbartin fryte. Imagjinoni një klasë të përjavshme për edukimin shpirtëror të fëmijëve. Një mësues duhet t'i kushtojë një numër të caktuar orësh për t'u përgatitur për çdo ore mësimi, të ketë përqëndrimin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë përmbajtjen e mësimit, t'u bëjë vizita të vazhdueshme prindërve të fëmijve dhe të ndjekë javë pas jave përparimin e tyre individual. Cili është fati i një klase, mësuesi i të cilës përgatitet vetëm me raste, e mbyll seksionin para kohe dhe papritur kur ndihet i lodhur dhe dështon t'i kushtojë kohën e nevojshme të menduarit rreth çdo fëmije dhe diskutimit me prindërit e tij për përparimin që kanë bërë? Dhe çfarë ndodh kur thjesht anulon orën e mësimit sa herë që mësuesi dëshiron të shlyejë një detyrim tjetër, të themi të dalë në takim me një mik që vjen nga jashtë qytetit?

Këto pak vërejtje janë për të na bindur ne, që duhet t'i kushtojmë vëmendje si sasisë ashtu dhe cilësisë së mundimit që kërkon çdo përpjekje që ndërmarrim. Kjo vlen jo vetëm për veprat e shërbimit në të cilat ne angazhohemi; ajo vlen njësoj për vetë zhvillimin tonë. Madje edhe zakonet shpirtërore që trajtuam në librin e parë të kësaj serie — të lutemi rregullisht, të lexojmë Shkrimet çdo ditë, të meditojmë sesi t'i menaxhojmë jetët tona në përputhje me mësimit, të marrim pjesë me gjithë zemër në takimet devocionale — varen nga përpjekjet e vazhdueshme. Më poshtë ka një numër fjalish të lidhura me përpjekjen. Duke vendosur se cilat janë të vërteta do t'u ndihmojë të reflektoni më tej mbi këtë çështje:

- _____ Nëse jeni i zgjuar, nuk është nevoja të punoni shumë.
- _____ Pse t'i biesh gjatë; gjithmonë kërko një rrugë që bie shkurt.
- _____ Pa dhimbje s'fiton gjë.
- _____ Ëndërro shumë; dëshirat e tua do të plotësohen.
- _____ Sa më e madhe trofeja, aq më të mëdha përpjekjet.
- _____ Sa më e madhe përpjekja, aq më i ëmbël shpërblimi.
- _____ Nëse nuk ke sukses në fillim, përpiku, përpiku përsëri.
- _____ Pse të punosh kur të tjerë mund të punojnë për ty?
- _____ Nëse kërkon shumë përpjekje, nuk është e thënë të ndodhi.
- _____ Hapa të vegjël - të shpeshtë dhe të qëndrueshëm - mund të të çojnë larg.
- _____ Asgjë që ja vlen nuk vjen me lehtësi.
- _____ Shkëlqyeshmëria kërkon përkushtim me gjithë zemër.
- _____ Udhëtimi prej njëmijë kilometrash fillon me një hap të vetëm.
- _____ Thjesht sa për të kaluar nuk është mirë mjaftueshëm.
- _____ Ne nuk duhet të presim që gjërat të ndodhin; ne duhet t'u shkojmë pas.
- _____ Suksesi është një çështje fati.
- _____ Ne nuk do ta arrijmë qëllimin tonë të dyfishtë me magji.
- _____ Ne duhet t'i kërkojmë llogari vetes çdo ditë.

Ne ecim në shtegun e shërbimit, duke u përpjekur të arrijmë rritjen tonë shpirtërore dhe intelektuale dhe të kontribuojmë për transformimin e shoqërisë. Është e qartë se ndjekja e këtij synimi të dyfishtë kërkon një masë të madhe përpjekjeje nga ana jonë. Bahá'u'lláh-u na thotë:

“Krijuesi i pakrahasueshëm i ka krijuar të gjithë njerëzit nga e njëjta substancë dhe e ka lartësuar realitetin e tyre mbi pjesën tjetër të krijesave të tij. Prandaj suksesi ose dështimi, fitimi ose humbja duhet të varen nga përpjekjet e vetë njeriut. Sa më shumë të përpiqet ai, aq më i madh do të jetë përparimi i tij.”¹⁹

Ju mund të dëshironi të mësoni përmendësh pasazhin e mësipërm nëse nuk e keni bërë këtë tashmë.

PJESA 9

Që të jemi në gjendje të kemi gëzim prej shërbimit, ne duhet të ushqejmë qëndrime të caktuara tek vetja jonë. Për shembull, ne duhet të jemi falenderues për bekimin që Zoti na ka falur; është e pamendueshme të imagjinohet që ne jemi duke i bërë Zotit një nder kur ne i shërbejmë Kauzës së Tij. Ne duhet të mësojmë gjithashtu të shmangim pesimizmin dhe t'i qasemi jetës me një këndvështrim optimist ndaj botës. Pengesat në shtegun e shërbimit mund të kthehen në gurë sokaku drejt përparimit të mëtejshëm. Edhe në mes të vështirësive, ne shikojmë me sy besimi te e ardhmja. Fjalët e mëposhtme të ‘Abdu’l-Bahá-it na orientojnë drejt shpresës dhe optimizmit që duhet të karakterizojnë përpjekjet tona:

“Sa e vogël është fara në fillim, por në fund ajo bëhet një pemë e madhe. Mos shikoni farën, shikoni pemën dhe lulet e saj, fletët dhe frytet e saj.”²⁰

“Dijeni pra rëndësinë jetësore të kësaj fare të vogël që Kopshtari i vërtetë e ka mbjellë në fushat e lëruara të Zotit me duart e mëshirës së Vet, e ka ujitur me shiun e dhuntive e të blatimeve dhe tani po e ushqen me nxehtësinë dhe dritën e Diellit të së Vërtetës.”²¹

“Kur ju shihni një pemë në rritje dhe në zhvillim, jini shpresëplotë për rezultatin e saj. Në fund do të lulëzojë dhe do të japë fruta. Nëse shihni pemë të thata apo pemë të vjetra, nuk ka asnjë shpresë për fruta.”²²

“Prandaj të dashurit e Perëndisë, me të gjitha forcat, me ujërat e përpjekjeve të tyre të kujdesen, të ushqejnë e të rritin këtë pemë të shpresës.”²³

“Në qoftë se zemra largohet nga të mirat që ofron Perëndia, si mund të shpresojë ajo për lumturi? Në qoftë se ajo nuk e mbështet shpresën dhe besimin në Mëshirën e Perëndisë, ku mund ta mbështesë atë?”²⁴

Për të reflektuar mbi pasazhet e mësipërm, plotësoni fjalitë e mëposhtme:

1. Në fillim, sa e vogël është fara, por në fund _____
_____ .
2. Ne nuk duhet të shohim farën e vogël, por atë _____
_____ .
3. Ne duhet të vlerësojmë pra, rëndësinë e farës së vogël që Zoti, me duart e mëshirës së Tij, ka _____

_____ .
4. Kur ne shohim një pemë që rritet dhe zhvillohet, duhet të jemi _____
_____ .
5. Kur ne shohim një pemë që rritet dhe zhvillohet, ne duhet të kemi shpresë se ajo do të _____
_____ .
6. Me ujrat e përpjekjeve tona, ne duhet _____
_____ .
7. Nëse zemra largohet prej bekimeve që Zoti ofron _____
_____ ?
8. Nëse zemra nuk e vendos shpresën dhe besimin e vetë në Mëshirën e Zotit, _____ ?

Tani reflekto për një moment: a jeni dakort që shpirti ynë i gëzueshëm dhe shpresëplotë i kombinuar me një qëndrim mirënjohjeje të përlurur është një burim gëzimi për të tjerët? Dhe le të mbajmë gjithmonë në mendje që, kur ngrihemi t'i shërbejmë Kauzës, ne mbartim lajmet e gëzuara të agimit të një Dite të re, Dita e mbledhjes së njerëzimit. Kumbofshin fjalët e Bahá'u'lláh-ut në zemrat tona:

“Të lumtur janë ata të cilët veprojnë; të lumtur janë ata që kuptojnë; i lumtur njeriu që është kapur tek e vërteta, i shkëputur nga gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është mbi tokë.”²⁵

REFERENCE

- 1 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CLIII.
- 2 . Po aty, CXXXII, par. 3.
- 3 . Bahá'u'lláh, *Fjalët e Fshehura*, nga persishtja no. 2.
- 4 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CVI, par. 1.
- 5 . Po aty, CIX, par. 2.
- 6 . Bahá'u'lláh, ne “*Gratë*” përmbledhur nga Departamenti i Kërkimeve të Shtëpisë Universale të Drejtësisë, no. 53.
- 7 . *Fjalët e Fshehura*, nga arabishtja no. 11.
- 8 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CLIII, par. 5.
- 9 . Po aty, CXXIX, par. 1.
- 10 . Po aty., XLIII, par. 9, p. 109.
- 11 . ‘Abdu’l-Bahá, Bisedat e Parisit, no. 32.2.
- 12 . *Fjalët e Fshehura*, nga persishtja no. 12.
- 13 . Po aty, nga persishtja no. 14.
- 14 . Po aty, nga arabishtja no. 15.
- 15 . Po aty, nga persishtja no. 32.
- 16 . Bahá'u'lláh, i cituar në *The Bahá'í World* [Bota Bahá'í], vëll. 1, Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1980, f. 42.
- 17 . *Thirrja e të Shumdashurit Hyjnor: Vepra të Zgjedhura Mistike të Bahá'u'lláh-ut* (Haifa: Bahá'í World Centre, 2018), nr. 2.12, f. 17.
- 18 . *Tabela të Planit Hyjnor: të Reveluara prej ‘Abdu’l-Bahá-it për Bahá'í-të Amerikano Veriorë* (Wilmette: Shtëpia Botuese Bahá'í, botuar 1993,2006), nr 13.6, p.95-96.
- 19 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, XXXIV, par. 8.
- 20 . *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e ‘Abdu’l-Bahá-it*, no. 40.3.
- 21 . Po aty, no. 40.3, p. 119.
- 22 . ‘Abdu’l-Bahá, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] Nga një fjalim i mbajtur më 11 maj 1912, par. 2.

-
23. *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e 'Abdu'l-Bahá-it*, no. 206.13.
 24. 'Abdu'l-Bahá Bisedat e Parisit, no. 34.8.
 25. Bahá'u'lláh, *Epistle to the Son of the Wolf* [Letër për të Birin e Ujikut] (Wilmette: Bahá'í Publishing Trust, 1988, 2016), p. 139.



Biseda frymëzuese

Qëllimi

Për të fituar aftësinë për të prezantuar
parimet shpirtërore në një bisedë

PJESA 1

Në seksionin e parë të këtij libri, ne folëm për gëzimin e pamatë që marrim prej veprimit të ndarjes së Fjalës së Zotit me të tjerët. Ndërkohë që ecim në shtegun e shërbimit, na vijnë mundësi të panumërta për të diskutuar me miqtë dhe të njohurit, mendimet që qëmtojmë prej Revelacionit të Bahá'u'lláh-ut. Midis aftësive që ne të gjithë kemi nevojë të zhvillojmë, pra, janë ato që na aftësojnë ne të kontribuojmë në biseda kuptimplote dhe frymëzuese. Qëllimi i këtij seksioni dhe tjetrit është t'ju aftësojnë në këtë aspekt. Këtu ju do të merrni ide sesi, kur jepet mundësia, të ngrini nivelin e bisedës duke ju referuar parimeve shpirtërore. Në seksionin tjetër, ju do të mendoni rreth asaj sesi të filloni dhe të mbështesni një seri bisedash mbi tema të caktuara si pjesë e një përpjekjeje sistematike për të ndërtuar një komunitet të gjallë në fshatin apo në lagjen tuaj.

Ajo çfarë do të bëjmë në seksionet që pasojnë është të shohim një numër të caktuar thëniesh mbi tema të ndryshme të cilat, edhe pse nuk janë citate ekzakte, janë të bazuara të gjitha në bisedat e Tabelat e 'Abdu'l-Bahá-it dhe përfshijnë shumë nga frazat që ai përdorte. Ju duhet të lexoni çdo thënie disa herë, të identifikoni sekuencën e ideve dhe duke respektuar rradhën me anëtarët e tjerë të grupit tuaj duke i thënë ato me zë të lartë derisa të mund t'i shprehni ato natyrshëm. Ky ushtrim do t'ju ndihmojë të përgatiteni të flisni me lehtësi kur juve ju duket e përshtatshme të merrni nga mësimet e Besimit për të nxitur një bisedë.

Ju do të vazhdoni në këtë seksion, natyrisht, të mësoni përmendësh pjesë nga Shkrimet, të cilat kanë një fuqi të veçantë dhe depërtojnë në zemrat e njerëzve dhe kur do të futen në fjalimin tuaj, do të kenë një efekt të thellë tek dëgjuesi. Megjithatë, citimi nga Shkrimet në një bisedë kërkon mençuri. Ajo që është e nevojshme është moderimi, ekuilibrit midis citimit të drejtpërdrejtë nga Shkrimet dhe shtjellimit me fjalët tuaja për të shpjeguar mësimet e Besimit. Për të arritur këtë ekuilibër, duhet t'i kushtoni shumë kohë e energji studimit të Shkrimeve, në mënyrë që ato t'u japin formë mendimeve e ndjenjave tuaja.

PJESA 2

Pasazhi i parë që kërkohet të studioni e që shpesh do t'ju ndihmojë në bisedat tuaja, ka të bëjë me nevojat e njerëzimit për një Edukator.

Kur shqytojmë egzistencën, ne vëzhgojmë që mbretëria e mineraleve, e bimëve, e kafshëve dhe e njerëzve, secili dhe të gjithë, kanë nevojë për një edukator. Një kopësht ka nevojë për një kopshtar. Për të prodhuar të korra të shumta, toka ka nevojë për një bujk. Nëse një njeri lihet vetëm në një vend të shkretë, ai do të marrë mënyrat e sjelljes së një kafshe. Ndërsa po të edukohet, mund të arrijë majat më të larta të mjeshtrisë. Po të mos kishte edukatorë, nuk do të kishte kurrfarë qytetërimi.

Edukimi është tre llojesh: material, njerëzor dhe shpirtëror. Edukimi material ka të bëjë me zhvillimin e trupit. Edukimi njerëzor ka të bëjë me qytetërimin dhe përparimin. Ai ka të bëjë me qeverisjen, rendin shoqëror, mirëqenien njerëzore, tregtinë dhe industri, artet e shkencat, me shpikjet dhe zbulimet e mëdha. Edukimi shpirtëror

është të fituarit e përsosurive hyjnore. Ky është edukim i vërtetë, sepse me ndihmën e tij zhvillohet shpirtërorja, natyra më e lartë e njeriut.

Që të ecë përpara, njerëzimi ka nevojë për një edukator që ka autoritet të qartë si edukator material, njerëzor dhe shpirtëror. Nëse dikush do të thoshte “Unë kam inteligjencë të përsosur dhe nuk kam nevojë për një edukator të tillë”, ai do të mohonte atë që është e qartë e që duket sheshit. Ai do të ishte si një fëmijë që thotë: “Unë nuk kam nevojë për edukim; unë do të veproj sipas arsyes e inteligjencës sime, dhe vetë do të arrij përsosurinë”.

Njerëzimi gjithmonë ka pasur nevojë për një edukator të tillë të përsosur, një të tillë që ta ndihmojë të organizojë punët që kanë të bëjnë me ushqimin dhe shëndetin trupor, ta frymëzojë që të përparojë në dijet, shpikjet e zbulimet, dhe, ç’është më e rëndësishmja, të futë në të jetën e vërtetë të shpirtit. Asnjë qenie njerëzore e zakonshme nuk mund t’i kryejë këto detyra madhështore. Vetëm Manifestimet e Perëndisë kanë fuqi t’i kryejnë ato. Këta janë Shpirtra të zgjedhur që dërgohen nga Perëndia kohë pas kohe për të qenë Edukatorët Universalë të njerëzimit.

1. Lexojeni pasazhin e mësipërm disa herë në grupin tuaj dhe ndihmoni njëri-tjetrit të kuptoni mirë përmbajtjen e tij. Ju duhet t’i drejtoni njëri-tjetrit pyetje të tjera lidhur me idetë e shtjelluara në këtë pasazh dhe të praktikoheni t’i shprehni ato natyrshëm dhe me lehtësi.
2. Më tej, diskutoni në grupin tuaj sesi idetë që keni mësuar të artikuloni këtu mund të prezantohen në një bisedë. Dukshëm ju nuk keni për t’u thënë papritur miqve tuaj që edukimi është tre llojesh. Ja vlen pra që ju të mendoni rreth llojeve të bashkëveprimit në të cilët idetë më sipër do të provonin të ishin të duhurat. Ndoshta çështja që po diskutojmë është rënia e moralit të shoqërisë apo sesi të punoni për përmirësimin e botës. Reflektoni mbi bisedat e ndryshme në të cilat ju angazhoheni me miqtë, anëtarët e familjes apo të njohurit. Midis problemeve që ka në kokën e tyre, a ka ndonjë që do t’i futë ata në një diskutim rrotull ideve në këtë thënie?

3. Shpesh ngrihen pyetje në biseda rreth temave si ajo që ju sapo keni studiuar. Si do të përgjigjeshit ju nëse dikush do t’ju pyeste: “Cilët janë disa nga këta Edukatorë për të cilët po flisni?”

4. Më poshtë janë disa citate nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut lidhur me nevojën e njerëzimit për një Edukator. Reflektoni mbi to dhe memorizoni të paktën një. Në këtë mënyrë, ju do të keni mundësi të endni pasazhe nga Shkrimet në të folurin tuaj kur është e përshtatshme.

“Të gjithë njerëzit janë krijuar për të çuar përpara një qytetërim që është në progres të vazhdueshëm.”¹

“Qëllimi i të Vetmit Perëndi të Vërtetë, lartësuar qoftë lavdia e Tij, në revelimin e Vetes së Tij para njerëzve është të nxjerrë në dritë ata margaritarë që rrinë të fshehur brenda minierës së qenies së tyre të vërtetë e më të brendshme.”²

“Qëllimi i Perëndisë në dërgimin e Profetëve të Tij midis njerëzve është i dyfishtë. I pari është t'i çlirojë bijtë e njerëzve nga errësira e injorancës dhe t'i çojë ata drejt dritës së të kuptuarit të vërtetë. I dyti është të sigurojë paqen e qetësinë e njerëzimit dhe të gjejë të gjitha mjetet me të cilat ato mund të vendosen.”³

“Njerëzit kudo e kurdoherë kanë nevojë për dikë që t'i nxitë, t'i udhëheqë, t'i udhëzojë e t'i mësojë.”⁴

PJESA 3

Paragrafët e mëposhtëm tregojnë sesi Perëndia mund të njihet vetëm nëpërmjet Manifestimeve të Tij, dhe do të jenë një ndihmë për ju kur të bisedoni me miqtë:

Shihni gjithësinë e pafund. A është e mundur që ajo të jetë krijuar pa një Krijues? Apo që realiteti i Krijuesit nuk mundet kurrë të kuptohet nga ajo që Ai krijoi? Nëse vrojtojmë gjithë krijimin, vëmë re se gjithçka që është më e ulët nuk e kupton dot fuqinë e asaj që është më e lartë.

Kështu, guri, dhe pema, sado të evoluojnë, nuk mundet kurrë të imagjinojnë fuqitë e të parit dhe të dëgjuarit. Kafsha nuk mundet kurrë të kuptojë realitetin e një qenieje njerëzore dhe të ndërgjegjësohet për fuqitë e shpirtit njerëzor. Po ashtu si mundemi ne, krijesat, të kuptojmë realitetin e Krijuesit tonë?

Megjithëse mendja e njeriut nuk mund ta arrijë kurrë Perëndinë, ai nuk është i privuar nga njohja e Tij. Herë pas here në tokë shfaqet një Qenie Njerëzore që është Manifestimi i Perëndisë. Gjithë përsosuria, mirësia dhe shkëlqimi që vijnë nga Perëndia duken te Manifestimi i Shenjtë, ashtu si dielli që shkëlqen në një pasqyrë të lëmuar e të pastër. Të thuash se këto Pasqyra janë Manifestimi i Diellit të së Vërtetës nuk do të thotë se Dielli ka zbritur nga lartësitë e Tij të Lavdisë dhe është mishëruar te Pasqyra. Kuptimi i kësaj është se gjithçka që njerëzimi di, zbulon e kupton nga emrat, atributet dhe përsosuritë e Perëndisë u referohet Manifestimeve të Tij të Shenjta.

1. Pasi ta keni lexuar këtë pasazh disa herë në grupin tuaj dhe t'u jeni përgjigjur pyetjeve që i keni drejtuar njëri-tjetrit në lidhje me përmbajtjen e tij, duhet të praktikoheni ta thoni atë me një masë lehtësie.
2. Tani diskutoni në grupin tuaj sesi mund të ndërtoni në një bisedë natyrshëm idetë që keni mësuar këtu. Kjo mund të bëhet me lehtësi, për shembull, në një diskutim rreth egzistencës së Perëndisë apo qëllimit të jetës. Cilat janë disa tema dhe pyetje të tjera të ngritura në një bisedë në familje a mes miqsh të cilat do t'ju ofronin mundësinë e ndarjes së këtyre ideve?

3. Supozoni që në një bisedë me miqtë tuaj keni mundësi të paraqitni temën që sapo studiuat. Si do të përgjigjeshit sikur dikush t'ju bënte këtë pyetje: “Cilat janë disa nga gjërat që ne dimë për Perëndinë përmes Manifestimeve të Tij?”

4. Ju mund të dëshironi të mësoni përmendësh një ose më shumë nga pasazhet e mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut në mënyrë që të mund t'i citoni ato kur flisni me miqtë për këtë temë:

“Dijet për Atë, Që është origjina e të gjitha gjërave, dhe arritja tek Ai janë të pamundura ndryshe, veçse nëpërmjet dijes për këto Qenie të shkëlqyera, që rrjedhin nga Dielli i së Vërtetës.”⁵

“Personi i Manifestimit gjithmonë ka qenë përfaqësuesi e zëdhënësi i Perëndisë. Ai, me të vërtetë, është Agimi i Titujve më të shkëlqyer të Perëndisë dhe Burimi i Atributeve të Tij të larta.”⁶

“Sidomos të jeni të sigurt se punët dhe veprat e secilit e të të gjitha këtyre Manifestimeve të Perëndisë, madje çdo gjë që u përket atyre ose që ata do të shfaqin në të ardhmen, janë urdhëruar të gjitha prej Perëndisë dhe pasqyrojnë Vullnetin e Qëllimin e Tij.”⁷

PJESA 4

Njëshmëria e fesë është një temë me interes për shumë njerëz dhe idetë e mëposhtme do t'ju ndihmojnë në raste të shumta:

Ne duhet ta duam dritën, pavarësisht nga ç' llambë vjen ajo. Ne duhet ta duam trëndafilin, pavarësisht se në ç'kopësht lulëzon ai. Ne duhet të jemi kërkues të së vërtetës, pavarësisht nga ç'burim vjen ajo. Tërheqja pas një llambe mund të na pengojë të vlerësojmë dritën kur ajo ndriçon në një llambë tjetër. Kur kërkojmë të vërtetën, ne duhet ta shkëpusim veten tonë prej nocioneve të formuara më parë dhe të heqim dorë prej paragjyqimeve. Nëse kupa jonë është plot me veten tonë, në të nuk ka vend për ujën e jetës..

Feja është drita e botës. Ajo i udhëheq hapat tanë dhe na hap ne dyert e lumturisë pafund. Kur ne hetojmë mësimet e të gjitha feve të mëdha, të lirë prej kufizimeve të besimeve dogomatike dhe imitimit të verbër, ne arrijmë të kuptojmë që ato bazohen mbi të njëjtin themel. Ato të gjitha zbulojnë njohurinë e Zotit. Ato kërkojnë përparimin e botës së njerëzimit.

Ka sigurisht, ndryshime ndërmjet ligjeve shoqërore dhe rregullave të shpallura prej çdo feje sipas kërkesave të kohës dhe vendit. Por në thelb të tyre të gjitha fetë janë një. Ato kultivojnë besim, njohuri, siguri, drejtësi, devotshmëri, fisnikëri, besueshmëri, dashuri për Zotin, dhe bamirësi. Ato mësojnë pastërtinë, shkëputjen, përlulësinë, vetpërbajtjen, durimin dhe qëndrueshmërinë. Këto virtyte njerëzore rinovohen në çdo Dispensacion.

Përveç kësaj, fatkeqësisht ndodh që, për arsye të paragjyqimeve dhe imitimit të verbër, shumë veta nuk janë në gjendje të shohin njëshmërinë themelore të fesë. Udhëzimi i Zotit për njerëzimin është e vërteta dhe e vërteta nuk ka ndasi; është një. Nëse hetojmë të vërtetën në mënyrë të pavarur, duke vendosur mënjane nocionet e formuluar më parë, kërkimi ynë do të çojë në unitet. Feja duhet të na bashkojë ne; duhet të krijohet lidhje dashurie midis njerëzve. Nëse bëhet shkak armiqësie dhe grindjesh, mungesa e saj është e preferueshme.

1. Si dhe në pjesën e mëparshme, ju duhet ta lexoni pasazhin e mësipërm disa herë në grup, t'i drejtoni njëri-tjetrit pyetje lidhur me idetë dhe të praktikoheni t'i thoni ato sa më mirë.
2. Merrni në shqyrtim në grupin tuaj sesi mund të endni idetë që keni studiuar në një bisedë, të themi, rreth konfliktit fetar, i cili është shpesh në mendjet e njerëzve. Por ju mund të gjeni gjithashtu veten midis disa miqve duke diskutuar rëndësinë e hetimit të së vërtetës dhe duke mos u manipuluar prej propogandës. Mendoni pas sërish tek bisedat tuaja të fundit me miqtë dhe fqinjët, bashkëpunëtorët dhe të njohurit. Cilat janë disa nga problemet në mendjen e tyre të cilat do të përfitonin nga një diskutim rreth këtyre ideve?

3. Si do të përgjigjeshit nëse, pas ndarjes së ideve më sipër në bisedë, dikush ju pyet juve, “Cilat janë disa nga të vërtetat e përbashkëta për të gjitha fetë?”

4. Ju sugjerohet të mësoni përmendësh një ose dy nga pasazhet e mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut:

“Nuk mund të ketë asnjë dyshim se popujt e botës, të çfarëdo race ose feje qofshin, e marrin frymëzimin nga i vetmi Burim qiellor dhe janë nënshtruar të të vetmit Perëndi.”⁸

“Mbani marrëdhënie me pasuesit e të gjitha feve në një frymë miqësie e shoqërie.”⁹

“Qëllimi themelor që frymëzon Besimin e Perëndisë dhe Fenë e Tij është të mbrojë interesat dhe t’i japë shtytje unitetit të racës njerëzore . . .”¹⁰

“Feja e Perëndisë është për dashurinë dhe unitetin; mos e bëni atë shkak armiqësie e përçarjeje.”¹¹

PJESA 5

Marrëdhënia ndërmjet shkencës dhe fesë është çështja tjetër e cila ju kërkohet të studioni.

Feja duhet të jetë në pajtim me shkencën. Zoti na ka paisur me arsye që ne të mund të perceptojmë atë çfarë është e vërtetë. Shkenca dhe besimi pritet që të dyja të arrijnë standartet e arsyes. Prandaj, ato duhet të jenë në pajtim me njëra-tjetrën. Ata janë dy krahët mbi të cilët inteligjenca njerëzore mund të ngrihet në lartësi të mëdha, dy krahët me të cilët njerëzimi mund të fluturojë. Një krah nuk është i mjaftueshëm.

Shkenca është një bujari prej Zotit. Ajo zbulon ligjet e botës fizike dhe na aftëson që t’i kapërcejmë kufizimet që natyra na ka imponuar ne. Me ndihmën e instrumentave shkencore, ne shohim gjëra të padukshme me sy të lirë dhe komunikojmë përmes distancash të pamata në një çast. Shkenca bashkon të tashmen dhe të shkuarën dhe depërton misteret e së ardhmes. Përparimi i një populli varet nga arritjet e shkencës.

Feja e Zotit është nxitësja e së vërtetës, mbështetësja e njohurisë dhe civilizuesja e racës njerëzore. Pa fe, shkenca bëhet një mjet që shtyn materializmin, që çon si përfundim në dëshpërim. Kur feja kundërshton shkencën, kthehet thjesht në supersticion. Nëse feja dhe shkenca ecin së bashku në harmoni, shumë prej urrejtjes dhe hidhësisë, të cilat sjellin tani mjerimin për njerëzimin do t'u vijë fundi.

1. Si gjithmonë, lexojeni pasazhin disa herë në grupin tuaj, paragraf pas paragrafi, dhe i bëni njëri-tjetrit pyetje derisa ta mësoni mirë përmbajtjen dhe të mund ta paraqitni atë natyrshëm.
2. Si do t'i përgjigjeshit dikujt që tha sa vijon: “Feja është një e kaluar; shkenca do të zgjidhë të gjitha problemet e njerëzimit.” A do të ishte e dobishme për ju të sqaronit se feja nuk është e njëjtë me bestytinë, por bëhet kështu pa shkencë dhe se shkenca pa fe çon në dëshpërim të lindur nga materializmi? A mund të jepni shembuj se si ndodh kjo?

3. Ju sugjerohet të mësoni përmendësh një ose më shumë nga pasazhet e mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut:

“I pari e më kryesori midis këtyre favoreve që Fuqiploti u ka dhënë njerëzve, është dhuntia e të kuptuarit... Kjo dhunti i jep njeriut fuqinë për të dalluar të vërtetën në të gjitha gjërat, e çon atë ndaj asaj që është e drejtë dhe e ndihmon për të zbuluar sekretet e krijimit.”¹²

“Shiko botën dhe ndalu një çast për të përsiatur rreth saj. Ajo shpalos para syve të tu librin e vetes së saj dhe zbulon atë që ka shkruar në të Pena e Zotit tënd, Artuesit, të Gjithëdijshtimit.”¹³

“Dijet janë si flatrat për jetën e njeriut dhe si një shkallë për ngjitjen e tij. Të fituarit e tyre është detyrë e të gjithëve.”¹⁴

PJESA 6

Njëshmëria e njerëzimit është një temë që jehon në zemrat e njerëzve sot kudo, dhe shumë do të mirëpresin të diskutojnë me ju idetë e paraqitura më poshtë.

Një kopsht në të cilin lule me shumë ngjyra dhe aroma rriten krah për krah është i këndshëm për syrin. Dhe megjithëse të ndryshme, secila lule freskohet nga i njëjti shi dhe merr ngjohësi nga i njëjti diell. Kjo është e vërtetë edhe për njerëzimin. Ai është i

përbërë nga raca e ngjyra të ndryshme. Por të gjithë vijnë nga i njëjti Perëndi dhe të gjithë kanë të njëjtën prejardhje. Ndryshueshmëria në familjen njerëzore duhet të jetë shkak harmonie, si në muzikë; nota të ndryshme përzihen së bashku për të bërë një akord të përkryer.

Uniteti është i domosdoshëm për ekzistencën. Dashuria është shkaku i mirëfilltë i jetës. Në botën materiale elementet të gjitha gjërat mbahen së bashku nga ligji i tërheqjes. Ligji i tërheqjes mbledh së bashku disa elemente në formën e një luleje të bukur. Por kur tërheqja hiqet, lulja shpërbëhet dhe pushon së ekzistuari. E njëjta gjë ndodh me njerëzimin. Tërheqja, harmonia dhe uniteti janë forcat që e mbajnë njerëzimin së bashku.

Bahá'u'lláh-u ka bërë një projekt për të bashkuar të gjithë popujt e botës. Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i tërhequr ata në këtë qark uniteti. Kur takojmë njerëz të racave, kombësive, feve, opinioneve të ndryshme nga ato tonat, ne nuk duhet të lejojmë që këto dallime të bëhen barriera midis nesh. Ne duhet t'i mendojmë ata si trëndafila të ngjyrave të ndryshme që rriten në kopshtin e bukur të njerëzimit dhe duhet të jemi të gëzuar që ndodhemi mes tyre.

1. Pasi të studioni pasazhin e mësipërm siç bëtë ato të mëparshmet, mendoni për shumë biseda që po zhvillohen rreth jush. Cilat janë disa nga çështjet në mendjet e njerëzve që do të hapnin mundësinë që ju të ndani këto ide me ta?

2. Një bisedë mbi unitetin e njerëzimit mund të çojë në një diskutim rreth rëndësisë së unitetit në komunitetin tuaj. A mund të thoni disa fjalë sesi secili prej nesh mund të kontribuojë në të?

3. Ju mund të dëshironi të mësoni përmendësh një ose më shumë nga citatet e mëposhtme për t'iu referuar atyre kur flisni për këtë temë me miqtë tuaj:

“Faltorja e unitetit është ngritur; mos e shikoni njëri-tjetrin si të huaj. Ju jeni frytet e një peme të vetme dhe gjethet e së njëjtës degë.”¹⁵

“Ka q e fuqishme është drita e unitetit, sa mund të ndriçojë gjithë botën.”¹⁶

“Kthejini fytyrat nga uniteti dhe lereni të ndriçojë mbi ju shkëlqimi i dritës së Tij. Mblidhuni së bashku dhe, për hir të Perëndisë, vendosni të çrrënjosi çdo gjë që është burim kundërvënieje midis jush.”¹⁷

“Njeriu duhet t’i përmbahet fort asaj që favorizon vëllazërinë, mirësjelljen dhe unitetin.”¹⁸

PJESA 7

Pasazhi i mëposhtëm do t’ju ndihmojë të kontribuoni në diskutime mbi temën e drejtësisë, një çështje shumë shqetësuese për shumicën e njerëzve:

Dallimet midis individëve për nga aftësitë janë themelore për ekzistencën njerëzore. Prandaj, nuk është e mundur të jenë të gjithë njësoj, të gjithë të barabartë. Megjithatë, punët njerëzore, në tërësinë e tyre, duhet të qeverisen nga parimi i drejtësisë. Drejtësia duhet të jetë e shenjtë dhe të drejtat e çdo personi duhet të mbrohen.

Drejtësia nuk është e kufizuar; është një cilësi universale. Ajo duhet të veprojë në të gjitha nivelet e shoqërisë. Çdo pjesëtar i shoqërisë duhet të gëzojë të mirat e e qytetërimit, sepse çdo individ është një pjesëtar i trupit të njerëzimit. Po qe se një pjesëtar i këtij trupi është në ankth e shtrëngesë, të gjithë pjesëtarët e tjerë duhet domosdoshmërisht të vuajnë. Si mundet që një pjesëtar i tij të jetë në hall dhe të tjerët t’ia kalojnë mirë? Shoqërisë së sotme i mungon reciprociteti dhe simetria e nevojshme; ajo nuk është e rregulluar mirë. Janë të nevojshme ligje e parime që të sigurojnë mirëqenien dhe lumturinë e pjesëtarëve të familjes njerëzore.

Drejtësia është e vendosur mbi shtyllat e shpërblimit e të dënimit. Qeveritë e drejtuara nga ata që nuk besojnë, pa pasur frikë nga ndëshkimi hyjnor, do të zbatojnë ligje të padrejta. Shpresa për shpërblim dhe frika nga ndëshkimi janë të dyja të nevojshme nëse shtypja do të parandalohet. Ligjvënësit dhe administruesit e ligjeve duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat shpirtërore të vendimeve të tyre. Sundimtarët që besojnë se pasojat e veprimeve të tyre do t’i ndjekin përtej kësaj jete tokësore dhe që e dinë se gjykimet e tyre do të peshohen në peshoren e drejtësisë hyjnore me siguri do të shmangin tiraninë dhe shtypjen.

1. Pasi të keni mësuar të shprehni idetë e mësipërme natyrshëm, merrni parasysh se cilat tema bisede do të përfitonin nga njohuritë që ofron pasazhi.

2. Si do t'i përgjigjeshit dikujt që beson se padrejtësia nuk do të mbarojë kurrë?

3. Më poshtë janë disa citate nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut në lidhje me drejtësinë që ju inkurajoheni t'i mbani mend.

“Drita e njerëzve është Drejtësia. Mos e shuani atë me erërat e kundërta të shtypjes e të tiranisë. Qëllimi i drejtësisë është shfaqja e unitetit në mes njerëzve.”¹⁹

“Asnjë ndriçim nuk mund të krahasohet me atë të drejtësisë. Organizimi i botës dhe qetësia e njerëzimit varen prej saj.”²⁰

“Ajo që e mëson botën është Drejtësia, sepse ajo mbështetet mbi dy shtylla, shpërblimin dhe ndëshkimin. Këto dy shtylla janë burimet e jetës për botën.”²¹

PJESA 8

Hendeku ndërmjet të pasurve dhe të varfërve zgjerohet me çdo ditë që kalon, dhe pasazhi më poshtë do t'u ndihmojë ju të bisedoni me miqtë mbi këtë dhe çështje që lidhet me të.

Sot, për arsye të mungesës së marrëdhënieve reciproke dhe të harmonishme, disa anëtarë të shoqërisë janë të kënaqur, duke jetuar në rehati dhe luks, ndërkohë që të tjerë janë në kërkim të ushqimit dhe të strehës. Disa janë jashtëzakonisht të pasur dhe të tjerët jetojnë në varfëri të skajshme.

Ligjet e shoqërisë duhet të formulohen dhe të imponohen në mënyrë të tillë, sa që të mos jetë e mundur për një pakicë të grumbullojë pasuri të tepruar dhe që të tjerë të jenë të varfër. Kjo nuk do të thotë që të gjithë duhet të jenë të barabartë, pasi ndryshimet në cilësi dhe kapacitet janë të qenësishme për krijesat. Por superbollëku mjerman i pasurisë i shoqëruar prej varfërisë ligështuese mund të shfuqizohet. Nëse do të jetë e drejtë për një kapitalist të zotërojë një pasuri, është po aq e drejtë që punëtori duhet të ketë mjete të mjaftueshme të egzistencës. Kur ne shohim varfëri të skajshme, diku do të ketë tirani.

Esenca e çështjes është që drejtësia Hyjnore duhet të manifestohet në kushtet njerëzore. Bazat e gjendjes së përgjithshme ekonomike janë hyjnore në natyrë dhe shoqërohen me botën e zemrës dhe shpirtit. Të pasurit duhet të japin nga bollëku i tyre; ata duhet të zbusin zemrat e tyre dhe të kultivojnë një inteligjencë të dhembshur. Zemrat duhet të jenë kaq të lidhura së bashku, dashuria duhet të jetë kaq dominuese sa që i pasuri do të marrë masa me gjithë zemër për të hedhur bazat e modifikimit ekonomik në mënyrë të përhershme. Ata vetë duhet të kuptojnë se nuk është as e drejtë dhe as e ligjshme që ata duhet të zotërojnë pasuri të madhe, ndërsa ekziston varfëri e madhe në komunitet. Në

këtë mënyrë, ata do të japin me dëshirë nga pasuria e tyre, ndërkohë që mbajnë aq sa do t'i mundësojë ata të jetojnë në mënyrë komode.

1. Lexoni përmes thënies dhe studioni në grupin tuaj në mënyrën e zakonshme. Ka shumë probleme në mendjet e njerëzve të cilat lidhen me pasurinë dhe varfërinë -punësimin, pagat, strehimin, sa për të emërtuar disa prej tyre. A mund të mendoni për tema të tjera për diskutim, që të mund të përfitonit prej ideve të kësaj thënieje?

2. Si do t'i përgjigjeshit nëse dikush i cili ju dëgjoj ju të përmendni idetë e mësipërme ju pyet sa më poshtë: “Mos jeni duke thënë që të pasurit do të arrijnë të kuptojnë dhe të mbështesin ligje strikte për taksa dhe ata do të paguajnë me dëshirë atë që duhet të paguajnë në fakt? Çfarë të bën të mendosh se kjo është e mundur?”

3. Ju sugjerohet të mësoni përmendësh një ose dy nga pasazhet e mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut:

“... ju duhet të jepni fryte të bukura e të mahnitshme, që vetë ju dhe të tjerët të përfitonit prej tyre. Pra, është detyrë e secilit të merret me një zeje ose profesion, sepse në këtë qëndron sekreti i pasurisë, o njerëz që kuptoni!”²²

“Në qoftë se sytë e tu janë kthyer drejt mëshirës, atëherë lëri gjërat që të sjellin përfitim ty dhe kapu pas asaj që do t'i sjellë dobi njerëzimit. Dhe në qoftë se sytë e tu janë kthyer ndaj drejtësisë, atëherë zgjidh për të afërmin atë që dëshiron për veten tënde.”²³

“I bekuar është ai që preferon vëllain e tij para vetvetes.”²⁴

“Asnjë bamirësi nuk ka humbur e as do të humbasë, sepse veprat mirëbërëse janë thesare të ruajtura nga Perëndia në përfitim të atyre që i kryejnë.”²⁵

“... kini kujdes të mos i kapërceni kufijtë e moderimit e të mos renditeni midis prishanikëve.”²⁶

PJESA 9

Më poshtë ka disa ide të cilat do t'ju ndihmojnë për të marrë pjesë në diskutime mbi temën e paragjyqimeve.

Paragjykimet në të gjitha format- fetare, gjinore, etnike, ekonomike- shkatërrojnë strukturën e njerëzimit dhe janë kundër urdhrave të Zotit. Për mijëra vite njerëzimi ka vuajtur prej luftës dhe gjakderdhjes të shtyra prej njerit apo tjetrit nga këto paragjykime. Sa kohë që ato përsëriten njerëzimi nuk do të ketë paqe.

Zoti ka dërguar Profetët e Tij për qëllimin e vetëm për të krijuar dashuri dhe unitet. Të gjitha Librat Qiellore janë fjala e shkruar e dashurisë. Nëse ato provojnë të jenë shkak i ftohjes, ato janë bërë të pafrytshëm. Prandaj, paragjykimi fetar është veçanërisht kundër vullnetit dhe urdhrat të Zotit.

Paragjykimi kombëtar është tërësisht i pajustificueshëm. Toka është një truall, një shtet. Vijat dhe kufijtë që ndajnë kombet janë imagjinare, ato nuk janë krijuar prej Zotit. Njerëzit deklarojnë një lumë të jetë vija kufi ndërmjet dy vendeve, duke i dhënë secilës anë një emër, ndërkohë lumi u krijua për të dyja dhe është një arterie natyrore për të gjithë. A nuk është imagjinatë dhe injorancë që i shtyn njerëzit që t'i kthejnë bekimet e jetës në shkak lufte dhe shkatërrimi?

Paragjykimi racia nuk është asgjë tjetër veçse supersticion. Ngjyra e lëkurës së një personi është thjesht rezultat i adaptimit të paraardhësve të tij me kohën ndaj klimës dhe mjedisit. Karakteri është kriteri i vërtetë i njerëzimit. Shkëlqyeshmëria nuk varet nga raca apo ngjyra. Besimi, pastërtia e zemrës, veprat e mira dhe të folurit e lavdërueshëm janë ajo çfarë është e pranueshme në pragun e Zotit.

Për pjesën më të madhe të kohës, gratë kanë qenë të varura prej burrave dhe të keqtrajtuara. Dallimi midis mashkullit dhe femrës është një kërkesë e botës fizike; në botën e shpirtit ata janë të barabartë. Në vlerësimin e Zotit, nuk ka dallim për meshkujt apo për femrat. Gjithë njerëzimi është paisur prej Tij me inteligjencë dhe perceptim. Të gjithë kanë aftësinë për të fituar virtyte. Në asnjë rrethanë sot gjinia e një personi s'mund të bëhet shkak për ushtrimin e diskriminimit.

Sipas fjalëve në Testamentin e Vjetër, Zoti ka thënë: “Le ta bëjmë njeriun në përfytyrimin tonë, sipas pamjes tonë.” Kjo qartazi aplikohet si për gratë dhe për burrat gjithashtu. Qenia njerëzore është krijuar në imazhin e Zotit; kjo do të thotë, virtytet hyjnore janë reflektuar dhe zbuluar në realitetin njerëzor. Kjo është e vërtetë për të gjithë njerëzimin. Sa thellësisht e papërshtatshme është të pretendosh që vetëm ata të një ngjyre, etnie apo kombësie janë krijuar në ngjashmërinë e Zotit. Sa absurde të nënkuptosh që vetëm të pasurit janë bërë sipas imazhit të Tij apo të mendosh se kriter afërsie ndaj Zotit të jetë rangi i lartë në shoqëri. Njerëzimi nuk mundet të arrijë ndriçim përveç përmes braktisjes së paragjykimeve dhe përvetësimit të moralit të Mbretërisë.

1. Studiojeni këtë thënie ashtu siç keni bërë me ato paraardhëse dhe më pas mendoni disa sfida që miqtë dhe fqinjët tuaj kanë ngritur në bisedë të cilat bëjnë thirrje për eliminimin e paragjykimit.

-
-
2. Si do t'i përgjigjeshit nëse dikush me të cilin ju ndani idetë më sipër ju pyet ju:
“A mund të kemi paragjykime dhe të mos e dimë?”

-
-
3. Ju mund të gjeni rastin të përfshini në diskutimet tuaja mbi këto ide njërin ose tjetrin nga citimet e mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut:

“Toka është një vend i vetëm dhe njerëzimi qytetarët e tij.”²⁷

“Të gjithë fidanët e botës janë shfaqur prej një Peme, dhe të gjitha pikat prej një Oqeani, dhe të gjitha qeniet ja detyrojnë egzistencën një Qenieje.”²⁸

“Me të vërtetë njeri është ai që sot i përkushtohet shërbimit të mbarë gjinisë njerëzore.”²⁹

“Drita e një karakteri të mirë ia kalon dritës së diellit dhe rrezëllimit të saj.”³⁰

“Shquarsia e njeriut nuk qëndron në stolitë e pasurinë, por në sjelljen e virtytshme e në të kuptuarit e vërtetë.”³¹

“Dhëntë Perëndia që ti të ndihmohesh me dashamirësi kurdoherë për të thyer idhujt e bestytnisë dhe për të shqyer perdet e imagjinatave të njerëzve.”³²

“Më i shkujdesuri nga të gjithë njerëzit është ai që grindet për gjëra të kota e që kërkon të dalë mbi vëllanë e vet.”³³

PJESA 10

Kur bisedoni me miq, shpesh do të keni mundësinë të përdorni edhe idetë e pasazhit që vijon mbi barazinë e burrave me gratë:

Dielli fizik, përmes dritës e nxehtësisë së tij, zbulon realitetin e të gjitha gjërave mbi tokë. Fruti i fshehur në pemë shfaqet në degët e saj në përgjigje të fuqisë së diellit. Po kështu, Dielli i së Vërtetës, që ndriçon me shkëlqim të plotë në qiellin shpirtëror, nxjerr në dritë realitete që nuk ishin të dukshme në të kaluarën. Kjo është arsyeja pse, në këtë epokë, parimi i barazisë së burrave dhe grave është njohur plotësisht dhe tani është një fakt i vërtetuar.

Bahá'u'lláh-u ka deklaruar me termat më të qartë se në sytë e Perëndisë nuk ka dallim midis burrave e grave. Gjendja e pabarazisë që ka ekzistuar në shekuj nuk është rezultat i epërsisë së burrit; është thjesht sepse grave nuk u janë dhënë të njëjtat mundësi për të zhvilluar të gjitha aftësitë e tyre. Pavarësisht nga paragjykimet kundër tyre, historia, megjithatë, flet për jetën e shumë grave që kanë pasur arritje nga më të mëdha.

Një grua e tillë ishte poetja Persiane, Tâhirih. Ajo lindi në kohën e hershme të viteve 1800 në një vend ku gratë ishin plotësisht të varura nga burrat. Ajo ishte e para grua që pranoi të Vërtetën e Revelacionit të ri të Perëndisë. Kur pa agimin e një dite të re, ajo u bind se kishte ardhur koha që realiteti i barazisë së burrave dhe grave të njihej. Ajo ia kushtoi energjitë e saj shpalljes së kësaj të vërtete. Dijet dhe gojëtaria e saj mahnisnin burrat më të ditur të kohës. Edhe pse të gjitha forcat e një mbreti shtypës e një kleri injorant e fodull u ngritën kundër saj, ajo nuk ngurroi për asnjë moment të fliste të vërtetën. Dhe në fund ajo dha jetën për Besimin që kish përqaftuar në mënyrë aq të vendosur.

Të besosh atë që nuk ka qenë qëllimi i Perëndisë është injorancë e bestytни. Sot grave duhet t'u jepet çdo mundësi për t'u shkolluar e për të zënë një pozitë të barabartë me burrin në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore. Sa kohë që barazia e burrave me gratë të mos jetë bërë realitet në këtë botë, ashtu siç është në mbretërinë shpirtërore, përparimi i vërtetë i njerëzimit nuk është i mundur.

1. Duhet ta studioni, si gjithmonë, këtë pasazh me grupin tuaj dhe të praktikoni thënien e ideve. A ka ndonjë bisedë që ju e keni bërë tani së fundmi me miqtë tuaj nga e cila do të kishit përfituar prej kuptimeve që ajo ofron? Cilat ishin çështjet në diskutim?

2. Cilat janë disa prej besimeve dhe qëndrimeve që dominojnë në shoqërinë e sotme të cilat do të duhen të ndryshojnë nëse gratë duhet të pretendojnë një pozicion të barabartë me burrat në të gjitha fushat e përpjekjes njerëzore?

3. Më poshtë janë disa citate nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut që ju mund të dëshironi t'i mësoni përmendësh:

“Gratë dhe burrat kanë qenë dhe do të jenë gjithnjë të barabartë në sytë e Perëndisë.”³⁴

“Nuk e dini pse ju kemi krijuar të gjithë nga i njëjti pluhur? Që askush të mos e lëvdojë veten mbi tjetrin.”³⁵

“Në këtë Ditë Dora e mirësisë hyjnore i hoqi të gjitha dallimet. Shërbëtorët e Perëndisë dhe shërbëtorët e Tij shihen në të njëjtin plan.”³⁶

PJESA 11

Pasazhi përfundimtar që kërkohet të studioni është për temën e shkollimit universal:

Mbështetja e shkollimit universal është një kërkesë tepër e ngutshme e kohës sonë. Asnjë komb nuk mund të arrijë begatinë nëse nuk e bën shkollimin një nga preokupacionet kryesore të tij. Arsyeja parësore e rënies së popujve është mungesa e qasjes në njohuri.

Edukimi duhet të fillojë që në fëmijëri. Është detyra e babait dhe e nënës të përpiqen me çdo mjet të edukojnë fëmijët e tyre, të përsosin karakterin e tyre sipas ligjeve shpirtërore e morale, dhe të sigurojnë që ata të trajnohen në arte dhe shkenca. Nënata janë edukatorët e para të njerëzimit; ata ushqejnë fëmijët e tyre në gjirin e dijes. Çdo fëmijë duhet të shkollohet; kjo nuk është një çështje që mund të lihet pasdore. Nëse prindërit janë në gjendje të përballojnë shpenzimet, ata duhet ta bëjnë këtë. Përndryshe, komuniteti duhet të sigurojë mjetet për shkollimin e fëmijës.

Edukimi duhet të zhvillojë në çdo qenie njerëzore dëshirën për të shkëlqyer. Ne duhet të dashurohemi pas përsosmërisë njerëzore dhe ta ndjekim atë me pasion. Ne duhet të aspirojmë për shquarsi shpirtërore, të bëhemi të njohur për virtytet njerëzore – sinqeritet, ndershmëri, shërbim ndaj njerëzimit, dashuri e drejtësi. Ne duhet të kërkojmë të shquhemi nëpërmjet përpjekjeve tona në mbështetje të paqes e të unitetit dhe të përkrahjes së diturisë. Të udhëheqësh njerëzit në këtë rrugë është qëllimi i vërtetë i edukimit.

1. Pasi ta keni studiuar këtë pasazh në grupin tuaj, përpiquni të identifikoni disa nga shqetësimet që miqtë tuaj kanë për edukimin. Si i adresojnë shqetësimet e tyre idetë e mësipërme?

2. Sugjerohet që të mësoni përmendësh një ose më shumë citate të mëposhtme nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut:

“Nuk është e dëshirueshme që një njeri të mbetet pa dijeni apo aftësi, sepse atëherë, ai është vetëm një pemë shterpë.”³⁷

“Prireni mendjen e vullnetin nga edukimi i popujve e i fiseve të tokës. . .”³⁸

“Artet, zejet e shkencat e ngrejné botën e qenies dhe çojné në lartësimin e saj.”³⁹

“Me të vërtetë, dija është një thesar i njëmendtë për njeriun dhe burim lavdie, bujarie, gëzimi, lartësimi, kënaqësie e ngazëllimi për të.”⁴⁰

PJESA 12

Paqja është një çështje në mendjen e gjithësecilit. Vendosja e saj është shumë urgjente dhe jetësore. Tani që ju i keni dhënë vëmendje parimeve të parashtruara në thëniet pararendëse, juve mund t’ju duket me përfitim të reflektoni mbi çështjen e paqes universale.

Sigurisht, varet shumë prej qeverive, që të ndërmarrin hapa praktike për të eliminuar luftën. Marrëveshjet politike që zgjidhin debatet dhe që pakësojnë armatimet janë esenciale për kërkimin e paqes, ashtu siç mund të jenë mijëra forma të bashkëpunimit ndërkombëtar midis kombeve. Sidoqoftë, pavarësisht sa të rëndësishme janë masa të tilla, ato nuk do të çojné në paqe të qëndrueshme nëse parimet e diskutuara më parë nuk janë vendosur gjithandej botës. Nëse njerëzit nuk mësojnë të zbulojné realitetin dhe të kuptojné se e vërteta është një, armiqësitë shekullore, duhet të pyesim veten, a do të vazhdojnë të eksistojné? Ne të gjithë kemi të njëjtën origjinë. Perëndia i ka sytë tek të gjithë ne dhe na edukon të gjithëve përmes Manifestimeve të Tij. Mësimet e Tyre mësojnë tek i njëjti themel i dashurisë dhe i miqësisë. Vetëm kur njëshmëria e fesë të njihet atëherë do të pushojné fërkimet fetare dhe drita e fesë do të ndriçojë shtegun drejt paqes. A nuk është e nevojshme që shkenca dhe feja të bashkëpunojné në harmoni, duhet të pyesim veten më tej, në mënyrë që t’i shpërndajmë retë e injorancës dhe të demonstrojmë fallsitetin e çdo lloj paragjykimi, secila një barrierë e fuqishme për paqen? A mund të ndërtohet një botë paqësore, mbetet kjo një pyetje për t’u bërë, nëse pabarazia e tanishme e pazakontë midis të pasurve dhe të varfërve nuk trajtohet në çdo qoshe të globit? Dhe, jo derisa gratë të lejohen të ecin në të gjitha sferat e përpjekjes njerëzore me të drejta të barabarta me burrat atëherë dhuna që ka karakterizuar kaq shumë historinë do t’i japë shtysë paqes dhe përparimit të vërtetë. Brezat që po rriten duhet të edukohen universalisht sipas parimeve të tilla, përndryshe çdo shpresë për paqe do të shkatërrohet. Ju mund të dëshironi të memorizoni fjalët e mëposhtme të Bahá’u’lláh’ut në mënyrë që të mund t’i ndani ato me të tjerë që janë të shqetësuar për të ardhmen e njerëzimit:

“Mirëqenia e njerëzimit, paqja dhe siguria e tij janë të paarrtshme, po të mos krijohet e përderisa nuk do të jetë vendosur në mënyrë bindëse uniteti i saj.”⁴¹

REFERENCE

- 1 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CIX.
- 2 . Po aty., CXXXII, par. 1.
- 3 . Po aty., XXXIV, par. 5.
- 4 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 11.1.
- 5 . Bahá'u'lláh, *Kitáb-i-Íqán*, par. 151.
- 6 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, XXVIII, par. 2.
- 7 . Po aty, XXIV, par. 1.
- 8 . Po aty, CXI, par. 1.
- 9 . Po aty, XLIII, par. 6.
- 10 . Po aty, CX, par. 1.
- 11 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 15.4.
- 12 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, XCV, par. 1.
- 13 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 9.13.
- 14 . Po aty., no. 5.13.
- 15 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXII, par. 1.
- 16 . Po aty, CXXXII, par. 3.
- 17 . Po aty, CXI, par. 1.
- 18 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 7.20, p. 90.
- 19 . Po aty, no. 6.25, pp. 66–67.
- 20 . Bahá'u'lláh, cituar në Shoghi Effendi, *Ardhja e Drejtësisë Hyjnore*, par. 42.
- 21 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 3.23.
- 22 . Bahá'u'lláh, *Fjalët e Fshehura*, nga persishtja no. 80.
- 23 . *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 6.19.

-
24. Po aty, no. 6.37, p. 71.
 25. Bahá'u'lláh, ne *Huqúqu'lláh përmbledhur nga Departamenti i Kërkimeve të Shtëpisë Universale të Drejtësisë*, no. 16.
 26. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXVIII, par. 2.
 27. Po aty, CXVII, par. 1, p. 282.
 28. Bahá'u'lláh, cituar në Shoghi Effendi, *The Promised Day Is Come*, par. 279.
 29. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXVII, par. 1.
 30. *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 4.11.
 31. Ibid., no. 6.3, p. 57.
 32. Ibid., no. 6.3, p. 58.
 33. *Fjalët e Fshehura*, nga persishtja no. 5.
 34. Bahá'u'lláh, ne “*Gratë*” përmbledhur nga Departamenti i Kërkimeve të Shtëpisë Universale të Drejtësisë, no. 54.
 35. *Fjalët e Fshehura*, nga arabishtja no. 68.
 36. Bahá'u'lláh, ne “*Gratë*” përmbledhur nga Departamenti i Kërkimeve të Shtëpisë Universale të Drejtësisë, no. 3.
 37. Bahá'u'lláh, cituar në *Përmbledhja e përmbledhjeve: Përsosmëri në të gjitha gjerat*, no. 5.
 38. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CLVI, par. 1, p. 378.
 39. Bahá'u'lláh, *Epistle to the Son of the Wolf* [Letër për të Birin e Ujikut] (Wilmette: Bahá'í Publishing Trust, 1988, 2016), p. 26.
 40. *Tabela të Bahá'u'lláh-ut të reveluar pas Kitáb-i-Aqdas*, no. 5.13.
 41. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXXXI, par. 2, p. 324.



Tema thellimi

Qëllimi

Të zhvillojmë zakonet e të vizituarit të miqve dhe fqinjëve për të biseduar mbi tema me rëndësi shpirtërore.

PJESA 1

Ky seksion i tretë, ashtu si paraardhësi, ka lidhje me aftësitë që na mundësojnë të hyjmë në biseda frymëzuese dhe kuptimplota. Fokusi ynë në seksionin e dytë ishte në rastet e shumta që na paraqiten për të ngritur nivelin e bisedave duke ju referuar parimeve shpirtërore. Këtu fokusi kalon tek vizitat që ne bëjmë në shtëpitë e miqve dhe fqinjëve për të eksploruar së bashku temat qëndrore për jetën e komunitetit.

Në fshatra dhe lagje nëpër botë, grupe miqsh po angazhohen në një seri aktivitete të ndërlidhura të cilat përfshijnë takime devocionale të rregullta, klasa për edukim shpirtëror të fëmijëve, takime të para të rinjve, qarqe studimi, dhe kampe të rinjsh si dhe fushata të llojeve të ndryshme. Ndërkohë që ky model aktiviteti zë rrënjë në një lokalitet dhe ndërkohë që numra në rritje ja kushtojnë veten veprave të shërbimit, bërthama e miqve rritet në masë dhe në forcë. Një program sistematik vizitash në shumë e më shumë shtëpi në fshat apo lagje është një përbërës jetësor i procesit të ndërtimit të komunitetit që tani po merr vrull. Një shumëllojshmëri temash trajtohen gjatë vizitave të tilla. Mësuesi i një klase fëmijësh Bahá'í, për shembull, duhet të telefonojë në mënyrë të shpeshtë prindërit e të rinjve për të diskutuar tema në përputhje me edukimin. Vizita të ngjashme është nevoja të kryhen në shtëpitë e para të rinjve dhe të rinjve prej atyre që shërbejnë si animatorë dhe tutorë, për të diskutuar tema që mbartin sfida dhe mundësi të lidhura me këto vite premtuese në jetën e një qenieje njerëzore. Biseda të mbajtura me anëtarë të një shtëpie mbi tema që thellojnë njohuritë e tyre të Besimit, dëshmojnë të jenë gjithashtu thelbësore. Në tërësi, efekti i vizitave të tilla në kulturën e miqësisë që shfaqet në komunitet nuk mundet të mbivlerësohet.

PJESA 2

Për qëllimin e këtij seksioni, ne do të shohim në një lagje imagjinare në të cilën procesi i përshkruar më sipër është duke përparuar, dhe ne do ta përdorim atë si kontekst për të egzaminuar llojet e bisedave që mund të shpalosen gjatë një vizite në një shtëpi.

Alejandra është një grua e re në vitin e tretë të universitetit. Ajo dhe njëri prej vëllezërve të saj, gjithashtu student, jetojnë me prindërit e tyre në lagjen që ne jemi duke imagjinuar, në shtëpinë ku ata u lindën dhe u rritën. Katër prej tyre dhe një çift i ri të cilët u shpërngulën tani në lagje takohen çdo javë për t'u lutur dhe konsultuar mbi përparimin e aktiviteteve që janë duke u krijuar rrotull tyre brenda një popullsie prej rreth 8,000 vetash. Tre të tjerë janë duke marrë pjesë herë pas here në këto takime javore dhe janë duke filluar të mendojnë sistematikisht jo vetëm për veprimet e tyre të shërbimit, por gjithashtu për gjithë procesin komunitet-ndërtues: një mësues i klasës së fëmijëve i cili filloi gjashtë muaj më parë dhe dy të rinj shtatëmbëdhjetëvjeçarë të cilët po drejtojnë përpjekjet e një grupi para të rinjsh me ndihmën e një vëllai më të madh të Alejandrës, i cili ishte animator i grupit të tyre kur ata ishin më të rinj dhe i cili viziton rregullisht prindërit e tij.

Seria e parë e bisedave që do të egzaminojmë është midis Alejandrës dhe Sanchez-ve, një familje e mirënjohur dhe e respektuar në lagje. Burri dhe gruaja janë në të gjashtëdhjetat e tyre dhe pasi kanë rritur vajzat dhe djemtë e tyre, jetojnë vetëm për vetëm pak blloqe më tej shtëpisë së Alejandrës. Zoti dhe zonja Sanchez dinë shkrim e këndim, por nuk kanë ndonjë

shkollë të madhe. Ata kanë fituar respekt në komunitet për veprat të tyre dhe për motivet e pastra që kanë treguar në marrëdhëniet me të tjerët. Ka ca kohë që ata janë ndërgjegjësuar rreth mësimave Bahá'í, por vetëm tani së fundmi kanë vendosur t'i hetojnë ato me zell. Një javë më parë ata komunikuan me prindërit e Alejandrës dëshirën e tyre për t'ju bashkuar komunitetit. Është planifikuar tashmë një takim për t'i mirëpritur ata dhe, për më tepër, është rënë dakort që Alejandra do t'i vizitojë ata regullisht për disa javë për të ndarë me ta një seri temash që do t'i ndihmojnë ata të thellojnë njohurinë e tyre rreth Besimit. Duke ndjekur raportin e vizitave, ju do të jeni në gjendje të eksploroni këto tema dhe në të njëjtën kohë të reflektoni mbi dinamikat e bisedës në raste të tilla.

PJESA 3

Alejandra planifikon të mbështesë bisedën e saj të parë me Z. dhe Znj. Sanchez në shpjegimin e shkurtër më poshtë të temës, Besëlidhja e Përjetshme e Perëndisë.

Krijuesi i të gjitha gjërave është Perëndia, i Vetmi, i Pakrahasueshmi, i Vetë-qenëshmi. Bahá'u'lláh-u na mëson se thelbi i Perëndisë është i pakapshëm nga mendja njerëzore, sepse ajo që është e kufizuar nuk mund të përfshijë të pakufishmen. Paraqitjet që pasuesit e feve të ndryshme i bëjnë Atij s'janë veçse fryte të imagjinatës së tyre. Perëndia nuk është njeri, dhe Ai nuk është thjesht një forcë e shpërndarë në mbarë Gjithësinë. Fjalët që detyrimisht duhet të përdorim për t'iu referuar Burimit të qenies sonë, si Ati Qiellor, Fuqia Qiellore, Shpirti i Madh, shprehin secila një nga emrat dhe atributet e Tij në gjuhën njerëzore, e cila është krejt e papërshtatshme për ta përshkruar Atë.

Në Fjalët e Fshehura lexojmë:

“O Bir i Njeriut! Unë e doja krijimin tënd, pra të krijova ty. Prandaj të më duash Mua, që Unë të përmend emrin tënd dhe ta mbush shpirtin tënd me frymën e jetës.”¹

Në këtë pasazh, Bahá'u'lláh na tregon se dashuria e Perëndisë për ne është vetë shkak i ekzistencës sonë. Ne duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm për këtë dashuri që na mbron, na mbështet dhe na mbush me shpirtin e jetës. Në çaste vështirësie ose qetësie, brengje ose gëzimi, ne duhet të kujtojmë se dashuria e Tij gjithmonë na përqafton.

Nga Mësimet Bahá'í mësojmë se duke na krijuar nga dashuria e Tij, Zoti ka hyrë në një Besëlidhje me ne. Fjala “besëlidhje” do të thotë një pakt ose premtim midis dy ose më shumë vetëve. Sipas Besëlidhjes së Përjetshme, Krijuesi Bujariplotë kurrë nuk na braktis, dhe kohë pas kohe na bën të njohur Vullnetin dhe Qëllimin e Vet nëpërmjet njërit prej Manifestimeve të Tij.

Folja “të manifestosh” do të thotë të revelosh, të tregosh diçka që më parë nuk njihet. Manifestimet e Perëndisë janë ato Qenie të veçanta, që na revelojnë Fjalën e Perëndisë. Ata janë Edukatorë Universalë, që na mësojnë si të jetojmë sipas Vullnetit të Perëndisë dhe si të arrijmë lumturinë e vërtetë. Midis këtyre Manifestimeve janë Krishna, Moisiu,

Zoroastri, Buda, Krishti, Muhameti dhe, sigurisht, Báb-i dhe Bahá'u'lláh-u, Manifestimet Binjake për epokën e sotme në historinë njerëzore.

Pra, në Besëlidhjen e Përvjetshme të Perëndisë, pjesa që i takon Atij gjithmonë është përmbushur. Një pyetje themelore të cilën duhet të gjithë t'ja bëjmë vetes është, “Si e përmbush unë pjesën time të Besëlidhjes?” Përgjigjja të cilën e gjejmë në të gjitha shkrimet fetare është: duke njohur Manifestimin e Zotit dhe duke ju bindur mësimëve të Tij. Kjo përgjigje e ka syrin tek vetë qëllimi i jetëve tona, i cili është ta njohim dhe ta adhurojmë Perëndinë. Në Lutjen e Shkurtër të Detyrueshme, ne deklarojmë:

“Unë dëshmoj, O Perëndia im, se Ti më ke krijuar që të të njoh e të të adhuroj Ty. Unë dëshmoj në këtë çast pafuqinë time dhe fuqinë Tënde, varfërinë time dhe begatinë Tënde.

“Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, Ndhmës në Rrezik, të Vetëqenëshmit.”²

Meqenëse është e pamundur për ne ta njohim Perëndinë përveçse nëpërmjet Manifestimeve të Tij, e vetmja mënyrë që ne mund ta arrijmë qëllimin e jetëve tona është duke i njohur Ata dhe duke ndjekur mësimet e tyre. Sot, zemrat tona mbushen plot e për plot me mirënjohje për bekimin që jetojmë në një kohë kur premtimi i bërë në të gjitha Librat e Shenjtë, që paqja dhe drejtësia të vendosen mbi tokë, po përmbushet. Bahá'u'lláh-u shpall:

“Kjo është Dita në të cilën favoret më të çmuara të Perëndisë janë derdhur mbi njerëzit, Dita në të cilën hiri më i fuqishëm i Tij është futur në gjithë gjërat e krijuara. U bie për detyrë të gjithë popujve të botës të pajtojnë të gjitha mosmarrëveshjet e tyre dhe, në bashkim e paqe të përsosur, të qëndrojnë nën hijen e Pemës së kujdesit e të dashamirësisë së Tij.”³

Përpara se të vazhdojmë me historinë tonë, ju duhet të lexoni historinë më sipër dhe të reflektoni mbi të, paragraf pas paragrafi, me pjesëmarrësit e tjerë të grupit tuaj. Ju mund t'i bëni pyetje njëri-tjetrit dhe t'u përgjigjeni atyre së bashku, derisa secili prej jush të jetë në gjendje t'i shprehë natyrshëm dhe me lehtësi idetë. Është shumë e rëndësishme veçanërisht mësimi i citateve, pasi ndarja e pasazheve nga Shkrimet në diskutime të këtij lloji është e domosdoshme. Ushtrimet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë juve të mendoni rreth ideve të prezantuara në këtë seksion dhe mbi kuptimin e pasazheve të cituara:

1. Si do t'ja shpjegonit dikujt se Perëndia është esencë që nuk njihet? Paragrafi i parë më lart duhet t'u vijë në ndihmë juve në këtë aspekt.

2. Përse na krijoi Perëndia? _____

3. Ç'do të thotë fjala “besëlidhje”? _____

4. Çfarë ka premtuar Perëndia në Besëlidhjen e Vet të përjetshme me njerëzimin? _____

5. Cili është qëllimi i jetës sonë? _____

6. Nëse ne nuk mund të njohim kurrë thelbin e Perëndisë, çfarë do të thotë që qëllimi i jetës tonë është të njohim Perëndinë? _____

7. Ç'do të thotë fjala “të manifestosh”? _____

8. Përmendni disa nga Manifestimet e Perëndisë: _____

9. Çfarë kërkohet nga ne për të përmbushur pjesën tonë në Besëlidhje? _____

10. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:
 - a. Kjo është Dita _____ të Perëndisë kanë reshur mbi njerëzit.
 - b. Kjo është Dita _____ i Tij më i fuqishëm u është futur të gjitha gjërave të krijuara.
 - c. Në këtë ditë ne duhet _____ mosmarrëveshjet tona dhe në bashkim e paqe të plotë, _____.
11. Çfarë kërkon Bahá'u'lláh që të bëjnë njerëzit e botës? _____

PJESA 4

Përmbajtja e temës që Alejandra planifikon të ndajë me z. dhe znj. Sanchez nuk është e vetmja gjë që ka qenë në mendjen e saj. Ajo shpreson të ndërtojë një lidhje të fortë miqësie me çiftin. Nga eksperiencia e herës së parë, ajo i di efektet e këqia si të paragjykimëve ashtu edhe të qëndrimit patronizues. Këto ajo do t'i mënjanojë në mënyrë të natyrshme; studimet e saj të shkollës së lartë nuk e kanë pakësuar thjeshtësinë e saj. Ajo nuk ka asgjë tjetër në zemër përveçse dashuri të vërtetë dhe respekt për Sanchezët. Ndërkohë që ajo mendon sesi do ta shpjegojë temën e parë, ajo e kujton veten se ky është fillimi i një bisede e cila do të shpalojë gjatë shumë javëve. Ajo vlerëson që megjithëse është e rëndësishme për ta prezantuar sekuencën e ideve me qartësi, duhet të ndalet në pika të caktuara për të dëgjuar përgjigjen e çiftit. “Duhet të përpiqem të mos jem nervoze,” i thotë ajo vetes, “sepse kjo ndodh kur unë flas e flas papushim dhe nuk mbetet mundësi që biseda të marri formë.” Alejandra vazhdon të mendojë rreth vizitës së saj për ca kohë përgjatë këtyre kontureve. Nëse do të ishit në vendin e saj, cilën prej këtyre më poshtë do ta konsideronit si mendime të duhura për tu futur në kokën tuaj?

- _____ Është puna ime t'i instruktoj Sanchezët në Besim dhe të sigurohem që ata e mësojnë çdo gjë që unë u mësoj.
- _____ Është një privilegj i madh të jesh në gjendje të kalosh ca kohë me këtë familje të mrekullueshme dhe të bisedosh me ta rreth citateve nga Shkrimet e Shenjta.
- _____ E di që kjo vizitë është e rëndësishme. Por shpresoj që kjo nuk do të zgjasë shumë, pasi kam gjëra të tjera për të bërë sot.
- _____ Citimet do të jenë shumë të vështira për ta. Unë thjesht duhet të përmend disa ide të thjeshta. Ajo që ka rëndësi është të tregoj dashuri ndaj tyre.
- _____ Në moshën e tyre, Sanchezët nuk mund të mësojnë shumë.
- _____ Unë po pres me padurim vizitën dhe të dëgjoj njohuritë e tyre ndërsa diskutojmë temën dhe reflektojmë në citimet.
- _____ Dinë të lexojnë. Unë thjesht do të prezantoj subjektin dhe do t'u lë citate që t'i studiojnë vetë.
- _____ Kur t'u shtjelloj idetë do të duhet që shpesh të bëj pauza, në mënyrë që të mund t'i studiojmë citatat së bashku dhe të konsultohemi lidhur me to.
- _____ Shpresoj të mund ta paraqes të gjithë temën pa ndërprerje dhe t'i pyes nëse kanë ndonjë pyetje në fund.

A mund të mendoni për ndjenja të tjera që do të donit ose nuk do të donit të kishit në përgatitjen e një vizite të tillë?

PJESA 5

Vizita e parë e Alejandrës tek shtëpia e Sanchezëve shkon mirë. Çifti vëren nervozizmin e saj dhe e bëjnë të ndihet mirë me ngrohtësinë dhe mirësjelljen e tyre. Ata e dëgjojnë me kujdes dhe marrin pjesë plotësisht në diskutim, duke i kushtuar vëmendje të veçantë pyetjeve. I vetmi moment vështirësie është në fund kur znj. Sanchez e befason Alejandrën me një pyetje: “A jam duke e harruar Krishtin duke ju bashkuar komunitetin Bahá’í?” Alejandra e di përgjigjen, por merr kohë për ta formuluar atë. Z. Sanchez i buzëqesh dhe i vjen në ndihmë: “Unë mendoj se dashuria ime për Krishtin është rritur faktikisht që kur ne kemi dëgjuar rreth mësimëve Bahá’í”. “Dhe kjo është rruga për shumë veta gjithandej botës,” shton Alejandra, e cila e ka mbledhur veten. “Dashuria e tyre për Moisiun, Krishtin, Krishnën, Budhën, Zoroastrin, dhe Muhametin është forcuar për arsye se Bahá’u’lláh u na mëson rreth unitetit të Zotit, unitetit të fesë, dhe unitetit të njerëzimit.”

Do të ishte e dobishme që ju të ndaloni një moment në grupin tuaj për të diskutuar disa prej cilësive dhe qëndrimeve të cilat duhet të ishin vënë në pah gjatë vizitës së Alejandrës për ta bërë atë të frytshme. Kryesore midis atyre që është nevoja të merrni në konsideratë është përlësia. Baza e të gjithë përlësisë është përlësia përpara Perëndisë. Nga kjo e ka burimin përlësia përpara krijesave të Tij. Asnjëherë qëndrimi i përunjur nuk është më i rëndësishëm sesa kur dikush flet për Perëndinë dhe Manifestimet e Tij. Ju duhet të reflektoni për citatin e mëposhtëm dhe të bëni të gjitha përpjekjet që ta mësoni atë përmendësh:

“Ata që janë të shumëdashurit e Perëndisë, kudo që të mblidhen e këdo që të takojnë, duhet të tregojnë, në qëndrimin e tyre ndaj Perëndisë dhe në mënyrën sesi e lartësojnë e i thurin lavdi Atij, një përunjësi e nënshtrim të tillë sa që çdo grimcë e pluhurit nën këmbët e tyre të dëshmojë për thellësinë e devocinit të tyre. Biseda e këtyre shpirtrave të shenjtë duhet të përshkohet nga një fuqi e tillë, sa që vetë këto grimca pluhuri të drithërohen nga ndikimi i tyre. Ata duhet të sillen në mënyrë të tillë, sa që toka që shkelin të mos mundë kurrë t’u thotë atyre fjalë si këto: “Unë duhet të preferohem ndaj jush. Sepse shikoni sa e duruar jam unë duke mbajtur barrën që hedh mbi mua bujku. Unë jam instrumenti që u shpërndan vazhdimisht të gjitha qenieve bekimet që më ka besuar Ai që është Burimi i çdo mirësie. Me gjithë nderin që më është dhënë dhe dëshmitë e panumërta të pasurisë sime – një pasuri që plotëson nevojat e gjithë krijimit – shikoni sa e përunjur jam unë dhe me çfarë nënshtrimi të plotë lejoj të më shkelin këmbët e njerëzve . . .”⁴

Siç është përmendur më sipër, përlësia përpara qenieve njerëzore buron nga përlësia përpara Perëndisë. Është me po të njëjtën përlësi që marrim një qëndrim lutjeje kur vizitojmë shtëpinë e një miku a të një fqinji për të thelluar së bashku të kuptuarit tonë për tema të caktuara. Gjatë bisedës, ne i kthejmë mendimet tona shpesh tek Perëndia, duke i kërkuar Atij të na ndriçojë mendjet dhe zemrat tona dhe ato të gjithkujt të pranishëm. Ka shumë fraza apo fjali prej lutjeve të cilat ne mund t’i memorizojmë me këtë qëllim në mendje. Këto janë vetëm fare pak:

“Ndriçoji zemrat tona, na dhuro sy që shohin e veshë të vëmendshëm.”⁵

“O Zot! Jep dhuratat e Tua të pafund dhe bëj që të shkëlqejë drita e udhërrëfimit Tënd”⁶

“Hapi portat e të kuptuarit të vërtetë dhe bëj që drita e besimit të shndritë me shkëlqim.”⁷

“O Zot! Ndriço sytë tanë që të mund të shohim dritën Tënde.”⁸

“Të drejtohem krejtësisht Ty, duke t’U përgjëruar me zjarr me tërë zemrën, mendjen e gjuhën të më mbrosh nga çdo gjë që është në kundërshtim me atë që do Ti në këtë cikël, ciklin e unitetit Tënd hyjnor . . .”⁹

PJESA 6

Zemra e Alejandrës është plot me gëzim pas vizitës së saj tek shtëpia e Sanchezëve dhe bisedës me ta mbi temën e Besëlidhjes së Përyetshme. “Vizita e ardhshme,” mendon ajo, “do të ishte një mundësi e mirë për ta të thellojnë njohurinë e tyre për jetën e Bahá’u’lláh·ut”. Më poshtë është një prezantim mbi të cilin ajo do të marri idenë:

Bahá’u’lláh·u lindi më 12 Nëntor 1817 në Teheran, kryeqytetin e Persisë. Që në fëmijëri Ai shfaqte cilësi të jashtëzakonshme, dhe prindërit e Tij ishin të bindur se Ai ishte i destinuar për diçka të madhërishtme. I ati i Bahá’u’lláh·ut, një ministër i shquar në oborrin e mbretit, ushqente një dashuri të pafund për Djalën e tij. Një natë ai pa në ëndërr sikur Bahá’u’lláh·u po notonte në një oqean të paanë dhe trupi i tij shkëlqente e ndriçonte detin e gjerë. Rreth kokës i përhapeshin flokët e gjatë, që pluskonin në të gjitha drejtimet. Një mori peshqish ishin mbledhur rreth Tij, duke u mbajtur secili pas një fije floku. Numri i peshqve ishte i madh, por asnjë fije floku nuk u shkul nga koka e Bahá’u’lláh·ut. Ai lëvizte lirshëm dhe i papërmbajtur, dhe të gjithë e ndiqnin Atë. I ati i Bahá’u’lláh·ut pyeti një njeri të njohur për urtinë e tij që t’i shpjegonte ëndrrën. Ai i tha se oqeani i paanë ishte bota e qenies. I vetëm e pa kurrfarë ndihme, Bahá’u’lláh·u do të fitonte sovranitet mbi të. Moria e peshqve përfaqësonte trazirën që Ai do të shkaktonte midis popujve të botës. Ai do të kishte mbrojtjen e sigurt të Fuqiptotit, dhe asgjë nuk do të mund ta lëndonte Atë.

Në moshën katërbëdhjetë vjeç, Bahá’u’lláh·u ishte i njohur në oborrin e mbretit për urtinë dhe dijet e tij. Ai ishte njëzetë e dy vjeç kur i vdiq i ati dhe qeveria i ofroi pozicionin e tij Bahá’u’lláh·ut. Por Ai nuk kishte si synim të harxhonte kohën për drejtimin e punëve të kësaj bote. Ai la oborrin dhe ministrat e tij, për të ndjekur rrugën që kishte caktuar për Të Zotit. Ai ia kushtoi kohën e Tij ndihmës për të shtypurit, të sëmurët e të varfrit dhe shpejt u bë i njohur si mbrojtës i çështjes së drejtësisë.

Në moshën njëzetë e shtatë vjeçare, Bahá’u’lláh·u mori, nëpërmjet një të dërguari të posaçëm, disa nga Shkrimet e Báb·it, i Cili po shpallte agimin e një Dite të re, të Ditës kur një Manifestim i ri i Perëndisë do t’i sillte botës paqen, unitetin dhe drejtësinë, që

njerëzimi kishte kohë që i priste. Bahá'u'lláh·u e pranoi menjëherë Mesazhin e Báb·it dhe u bë një nga pasuesit e Tij më entuziastë. Por fatkeqësisht, ata që sundonin mbi popullin e Persisë, të verbuar nga dëshirat e tyre egoiste, vendosën t'i përndiqnin pasuesit e Báb·it me egërsi të madhe. Bahá'u'lláh·u, megjithëse i njohur për fisnikërinë e Tij, nuk u përjashtua nga përndjekjet. Kishin kaluar pak më shumë se tetë vjet pas deklarimit të Báb·it dhe dy vjet pas martirizimit të Tij, Ai u burgos në një birucë të errët, të quajtur Pusi i Zi. Zinxhirët që i kishin vendosur në qafë ishin aq të rëndë sa që Ai nuk e ngrinte dot kokën. Aty Bahá'u'lláh·u kaloi katër muaj të tmerrshëm në vështirësi të mëdha. Por pikërisht në atë birucë Fryma e Perëndisë mbushi shpirtin e Tij dhe i zbuloi se Ai ishte i Premtuari i të gjitha kohëve. Nga ky burg i errët dielli i Bahá'u'lláh·ut u ngrit duke ndriçuar gjithë krijimin.

Pas atyre katër muajve në Pusin e Zi, Bahá'u'lláh·un e zhveshën nga të gjitha zotërimet dhe së bashku me familjen e syrgjynosën. Në të ftohtin e hidhur të dimrit, ata udhëtuan përgjatë maleve perëndimore të Persisë drejt Bagdadit, që në atë kohë ishte një qytet i Perandorisë Osmane, ndërsa sot është kryeqyteti i Irakut. Nuk mund të përshkruhen me fjalë vuajtjet e tyre duke ecur në këmbë qindra milje nëpër dëborë e mbi tokën e mbuluar nga akulli gjatë rrugës për në atë qytet të destinuar nga fati.

Fama e Bahá'u'lláh·ut u përhap shpejt në të gjithë Bagdadin dhe në qytetet e tjera të asaj zone. Gjithnjë e më tepër njerëzit vinin te dera e këtij të Burgosuri syrgjyn për të marrë Bekimet e Tij. Por ishin disa të tjerë që u bënë xhelozë për famën e tij. Midis tyre ishte edhe vetë vëllai nga babai i Bahá'u'lláh·ut, Mírzá Yaḥyá·i [Mirza Jahja], i cili jetonte nën kujdesin e Tij dashamirës. Komploti i Mírzá Yaḥyá·it solli përçarje midis pasuesve të Báb·it dhe i shkaktoi hidhërim të madh Bahá'u'lláh·ut. Një natë, pa i thënë askujt, Ai u largua nga shtëpia dhe shkoi në malet e Kurdistanit. Atje Ai bënte një jetë të veçuar, i zhytur në lutje e meditim. Ai rrinte në një shpellë të vogël dhe ushqej me ushqimet më të thjeshta. Askush në atë zonë nuk e dinte prejardhjen e Tij dhe askush nuk ia dinte emrin. Por më pas, gradualisht, njerëzit e asaj zone filluan të flisnin për "i Paemri", një Shenjtor i madh që kishte njohuri të dhuruara nga Perëndia. Kur 'Abdu'l-Bahá·i, Djali i madh i Bahá'u'lláh·ut, mësoi lajmet për Personin e Shenjtë, Ai menjëherë njohu shenjat e Babait të Tij të dashur. Atij i dërguan letra me një të dërguar të posaçëm, ku i luteshin Bahá'u'lláh·ut të kthehej në Bagdad. Ai e pranoi këtë, duke i dhënë fund një periudhe ndarjeje të dhimbshme, që kishte zgjatur për dy vjet.

Gjatë mungesës së Bahá'u'lláh·ut, gjendja e komunitetit Bábí kishte pësuar rënie të shpejtë. Në shtatë vite që Ai jetoi në Bagdad në vijim të kthimit të Tij prej maleve, Bahá'u'lláh·u futi tek pasuesit e persekutuar dhe të çoroditur të Báb·it një shpirt të ri. Megjithëse ende nuk e kishte shpallur Pozitën e Vet të lartë, fuqia dhe urtia e fjalëve të Tij filloi të fitonte besnikërinë e një numri gjithnjë e më të madh Bábí·sh dhe admirimin e njerëzve nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Por klerikët myslimanë fanatikë nuk e duronin dot kur shihnin ç'ndikim kolosal kishte Bahá'u'lláh·u mbi një numër aq të madh shpirttrash. Ata bënë ankesa pas ankesash pranë autoriteteve, derisa qeveria e Persisë u mor vesh me disa zyrtarë të perandorisë Osmane për ta çuar Bahá'u'lláh·un akoma më larg atdheut të Tij, kësaj radhe në Kostandinopojë.

Prilli i vitit 1863 qe muaj i një hidhërimi të madh për popullin e Bagdadit. Ai, për të cilin ata kishin arritur të kenë aq shumë dashuri, po largohej nga qyteti i tyre, për të

shkuar diku në një destinacion të paditur për ta. Përpara largimit të Tij, Bahá'u'lláh·u u vendos në një kopsht në rrethinat e qytetit, ngriti Tendën e Tij dhe për dymbëdhjetë ditë priti turma vizitorësh që u mblodhën për t'i dhënë lamtumirën. Pasuesit e Báb-it erdhën në këtë kopsht me zemër të lënduar, disa prej tyre do të shoqëronin Bahá'u'lláh·un në këtë fazë tjetër të syrgjynosjes së Tij, megjithëse shumë të tjerëve u duhej të mbeteshin pas dhe të privoheshin nga kontaktet e ngushta me Të. Por Perëndia nuk kishte dashur që ky të ishte një rast dëshpërimi. Dyert e bujarisë së Tij të pafund u hapën dykanatësh dhe Bahá'u'lláh·u u shpalli atyre që ndodheshin rreth Tij se ishte Ai për të cilin kishte folur Báb·i – Ai që Perëndia do ta shfaqte. Dëshpërimi ia la vendin haresë; zemrat u ngritën dhe shpirtrat u ndezën me zjarrin e dashurisë për Të. Kjo periudhë dymbëdhjetë-ditëshe në Prill festohet kudo si Festivali e Ridvánit, përvjetori i deklarimit të Bahá'u'lláh·ut, të Misionit të Tij mbarëbotëror.


Kostandinopoja ishte selia e Perandorisë Osmane. Edhe këtu, gjatë vetëm katër muajve, urtia e madhe dhe hiri vetjak i Bahá'u'lláh·ut filluan përsëri të tërhiqnin një numër gjithnjë e më të madh njerëzish. “Ai nuk duhet të qëndrojë më tepër në Kostandinopojë”, pëshpërisnin klerikët fanatikë myslimanë, të cilët i bindën autoritetet që ta syrgjynosnin Atë në qytetin e Adrianopojës. Në Adrianopojë, ku qëndroi për katër vjet e gjysmë, Bahá'u'lláh·u u shkroi Tabela mbretërve e sundimtarëve të botës, duke u bërë thirrje atyre të hiqnin dorë nga shtypja dhe t'i përkushtoheshin mirëqenies së popullit të vet. Më pas, armiqtë e Tij menduan një ndëshkim tepër mizor. Ai dhe familja e Tij do të syrgjynoseshin në ‘Akká, e cila në atë kohë ishte kolonia penale më e keqe në mbarë perandorinë. “Me siguri Ai do të vdiste në kushtet e vrazhdëta të atij qyteti-burg”, mendonin njerëzit mendjelehtë, që imagjinonin se mund ta ndalnin atë që Vetë Perëndia kishte vënë në lëvizje.

Vuajtjet që Bahá'u'lláh·u përjetoi në ‘Akká nuk kanë të numëruar. Ai nuk kishte asnjë pajisje për t'u rehatuar dhe ishte i rrethuar ditë e natë nga armiq. Por kushtet e burgimit gradualisht ndryshuan. Banorët e ‘Akká·s dhe qeveritarët e saj u bindën për pafajësinë e grupit të vogël Bahá'í të syrgjynosur në qytetin e tyre. Përsëri njerëzit u tërhoqën nga urtia dhe dashuria e këtij Personi të jashtëzakonshëm, megjithëse shumica nuk e kuptonin Pozitën e Tij të lartë. Pas rreth nëntë vjetësh, dyert e qytetit-burg u hapën për Bahá'u'lláh·un dhe pasuesit e Tij. Djali i Tij i shumëdashur Abdu'l-Bahá·i ishte në gjendje të siguronte një vend dinjitoz për Atin e Tij që të jetonte jashtë mureve të qytetit, dhe në fund u bë e mundur për Abdu'l-Bahá·in të merrte me qira një shtëpi në fshat ku Bahá'u'lláh·u ishte në gjendje të kalonte 13 vitet e pjesës së mbetur nga jeta e Tij në paqe dhe qetësi relative. Ne tani e njohim këtë shtëpi si Residencia e Bahji-t dhe atje Ai ndërroi jetë në Maj 1892, në kulmin e madhështisë e të lavdisë së Tij.

Bahá'u'lláh·u ngriti flamurin e paqes e të miqësisë dhe reveloi Fjalën e Perëndisë. Megjithëse armiqtë bashkuan forcat kundër Tij, Ai doli fitimtar mbi ta, ashtu sikurse i kishte premtuar Perëndia kur ishte i lidhur me zinxhirë në birucën e errët në Tihrán. Gjatë jetës së Tij, Mesazhi i sjellë prej Tij ringjalli zemrat e mijëra njerëzve. Dhe sot Mësimet e Tij vazhdojnë të përhapen në mbarë botën. Asgjë nuk mund ta ndalojë Atë të arrijë qëllimin e Tij të fundit, që është unifikimi i njerëzimit në një Kauzë mbarëbotërore, në një Besim të përbashkët.

Përmbledhja e mësipërme mbi jetën e Bahá'u'lláh-ut është relativisht e gjatë. Para se të kalojmë në ushtrimet e mëposhtme, ju duhet ta lexoni tregimin disa herë, paragraf për paragraf, në grupin tuaj dhe t'i bëni njëri-tjetrit pyetje derisa të keni mësuar mirë përmbajtjen dhe të mund t'a paraqitni me lehtësi.

Harta e mëposhtme do t'ju ndihmojë të thirrni në mendje rrugën e mërgimeve të Bahá'u'lláh-ut dhe të kujtoni ngjarjet që ndodhën gjatë rrugës.



1. Ju mund ta gjeni të dobishme të shkruani në hapësirën e dhënë, bazuar në rrëfimin e mësipërm, sekuencën e ngjarjeve kryesore që lidhen me jetën e Bahá'u'lláh-ut.

2. Në një diskutim rreth temës së jetës së Bahá'u'lláh·ut, ka një numër konceptesh që është nevoja të nënvizohen, veçmas nga sekuenca e ngjarjeve. E një rëndësie të posaçme është reflektimi mbi vuajtjet që Ai duroi nga dashuria e Tij për njerëzimin, si edhe për fitoret e jashtëzakonshme të arritura prej Besimit të Tij përballë opozicionit. Le të rrënjosen në mendjet dhe zemrat tona këto fjalë:

“Bukuria e Lashtë ka pranuar të lidhet me zinxhirë që njerëzimi të çlirohet nga zgjedha dhe ka pranuar të burgoset në këtë Fortesë të llahtarshme që gjithë bota të arrijë lirinë e vërtetë. Ai e ka pirë me fund kupën e dhimbjes që gjithë popujt e tokës të arrijnë gëzimin e përjetshëm e të mbushen me hare. Kjo bëhet me dashjen e Zotit tuaj, Zemërdhembshurit, Më të Mëshirshmit. Ne kemi pranuar të na poshtërojnë, o ju që besoni në Unitetin e Perëndisë, që ju të lartësoheni, dhe Ne kemi hequr vuajtje të shumta që juve t’ju ecë mbarë e të begatoheni. Shihni sesi Ai që ka ardhur për të ndërtuar sërish mbarë botën, është detyruar, nga ata që e vënë veten në një radhë me Perëndinë, të jetojë në qytetet më të shkretuara!”¹⁰

3. Kur flasim për vuajtjet e Bahá'u'lláh·ut, duhet të kemi kujdes që të mos paraqesim Atë si viktimë të pafuqishme të armiqve të Tij. Ai pranoi vullnetarisht të lidhej në zinxhirë, me qëllim që të çlironte njerëzimin. Historia e jetës së Tij, megjithëse e mbushur plot vuajtje të mëdha, në thelbin e saj është një triumf. Me ndihmën e lehtësuesit të grupit tuaj, a mund të përgatisni një bisedë të shkurtër mbi vuajtjet dhe fitoret e Bahá'u'lláh·ut duke u bazuar në njohuritë tuaja për jetën e Tij? Pyetjet e mëposhtme mund t’ju ndihmojnë.

- a. Pse Bahá'u'lláh·u pranoi të lidhej me zinxhirë? _____

- b. Pse Bahá'u'lláh·u pranoi të burgosej? _____

- c. Pse Bahá'u'lláh·u piu kupën e hidhërimit? _____

- d. Pse Bahá'u'lláh·u pranoi të poshtërohej? _____

- e. Pse Bahá'u'lláh·u vuajti kaq shumë fatkeqësi? _____

f. A pranoi Bahá'u'lláh-u të vuante, sepse ishte i pafuqishëm të vepronte ndryshe?

g. Nëse Bahá'u'lláh-u nuk ishte i pafuqishëm përpara armiqve të Tij, atëherë përse Ai pranoi të vuante? _____

PJESA 7

Vizita e dytë e Alejandrës tek shtëpia e Sanchezëve është aq e gëzueshme sa edhe e para. Z. dhe Znj. Sanchez janë tashmë disi të familjarizuar me historinë e jetës së Bahá'u'lláh-ut, por ata janë të lumtur të mësojnë më shumë prej prezantimit të Alejandrës dhe janë qartësisht të prekur prej rrëfimit të vuajtjeve të Tij. “Duket,” mendon znj. Sanchez në një pikë, “që Manifestimet e Zotit gjithmonë vuajnë nga duart e atyre që janë të etur për udhëheqje dhe fuqive tokësore.” Alejandra vendosi se ishte e duhur të ndante me ta citatin që ajo ka memorizuar—të cilin ju, gjithashtu, e dini nga studimet tuaja të seksionit të fundit—në të cilin Bahá'u'lláh-u flet për vuajtjet që Ai ka pësuar për hir të njerëzimit, që ne të mund të jemi të çliruar prej dhunës dhe të arrijmë lumturi të qëndrueshme. Të gjithë tre miqtë ndihen të elektrizuar prej diskutimit të asaj dite.

Duke meditaruar mbi vizitën e saj të ardhshme, Alejandra shpejt arrin në përfundimin se pozita e ‘Abdu’l-Bahá-it do të ishte një temë e natyrshme për diskutim. Këto janë çështjet që ajo do të sigurohet t’i mbulojë:

Djali i madh i Bahá'u'lláh-ut, ‘Abdu’l-Bahá-i është një figurë krejt unikale në historinë njerëzore, dhe ne nuk gjejmë asnjë personazh si Ai në ndonjë fe të mëparshme. Ai njohu pozitën hyjnore të Atit të Tij, ndërkohë që ishte ende fëmijë dhe përjetoi më Të syrgjynosjet dhe vuajtjet e Tij. Pas ndërrimit jetë të Tij Bahá'u'lláh-u e la nën kujdesin dhe ruajtjen e Abdu’l-Bahá-it komunitetin Bahá’í. Ne nuk mundemi kurrë të vlerësojmë plotësisht se çfarë bekimi të pafund Bahá'u'lláh-u i fali njerëzimit jo vetëm duke na dhënë ne Manifestimin e Tij më sublim, por gjithashtu Birin e Vet, nëpërmjet dijës e urtisë së të cilit, siç ka thënë Ai, njerëzimi do të ndriçohet.

Kur ne studiojmë jetën dhe fjalët e ‘Abdu’l-Bahá-it ne fitojmë të kuptuarit i thellë mbi pozitën unike që Ai zë në këtë Dispensacion. Tre aspekte të kësaj pozite janë të rëndësishme për ne që t’i mbajmë në mendje.

Së pari, ‘Abdu’l-Bahá-i është Qendra e Besëlidhjes së Bahá'u'lláh-ut. Bahá'u'lláh-u bëri një besëlidhje me pasuesit e Tij duke u bërë thirrje që t’i drejtojnë zemrat e tyre drejt kësaj qendre dhe të jenë plotësisht besnikë ndaj saj. Në Vullnetin dhe në Testamentin e Tij, ‘Abdu’l-Bahá-i e emëroi Shoghi Effendi-n, Ruajtësin e Çështjes, të jetë qendra drejt të Cilit të gjithë duhet të kthehen pas ndërrimit jetë të Tij. Sot, kjo qendër është Shtëpia Universale e Drejtësisë, e cila u krijua në përputhje me urdhrin e drejtpërdrejtë të Bahá'u'lláh-ut dhe me orientimet e qarta të ‘Abdu’l-Bahá-it dhe të

Ruajtësit. Fuqia e Besëlidhjes e mban komunitetin Bahá'í së bashku dhe e mbron atë nga përcarja dhe shpërbërja.

Së dyti 'Abdu'l-Bahá-i është Interpretuesi i pagabueshëm i Fjalës së Bahá'u'lláh-ut. Kaq i gjerë është Revelacioni i Bahá'u'lláh-ut, kaq të thella janë kuptimet që përmban çdonjëra prej fjalëve të Tij, saqë Ai e gjykoj të nevojshme të linte pas një interpretues, Një të Cilin Ai Vetë do ta frymëzonte. Kështu, për brezat që do të vijnë, njerëzimi do të jetë në gjendje të kuptojë Mësimet e Bahá'u'lláh-ut duke studiuar interpretimet e 'Abdu'l-Bahá-it në Tabelat e Tij të shumta dhe në riprodhimet e verifikuara të bisedave të Tij. Ruajtësi ishte interpretuesi i Mësimeve të Bahá'u'lláh-ut pas 'Abdu'l-Bahá-it; me të detyra e interpretimit u përfundua dhe askush nuk ka të drejtën të interpretojë Fjalët e Bahá'u'lláh-ut për gjithë kohën e Dispensacionit të Tij që mbetet.

Në të shkuarën të gjitha fetë kanë vuajtur nga ndarja mbi interpretimet e ndryshme të pasazheve nga Shkrimet e Shenjta. Kurse në këtë Dispensacion, kur ka ndonjë pasiguri për kuptimin e një thënieje të Bahá'u'lláh-ut, të gjithë u drejtohen interpretimeve të 'Abdu'l-Bahá-it e të Ruajtësit. Nëse mbetet ndonjë pasiguri, njeriu mund t'i drejtohet për sqarim Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Kështu nuk lihet vend për konflikte rreth kuptimit të Mësimeve dhe uniteti i Besimit ruhet.

Së treti, 'Abdu'l-Bahá-i është shembulli i përsosur i Mësimeve të Atit të Tij. Megjithëse nuk mund të shpresojmë kurrë të arrijmë një shkallë të tillë përsosurie, ne duhet të kemi gjithnjë parasysh Atë dhe të përpiqemi të ndjekim shembullin e Tij. Kur lexojmë në Shkrime për dashurinë, ne mund t'i drejtohem 'Abdu'l-Bahá-it, dhe do të shohim tek Ai vetë thelbin e dashurisë e të përzemërsisë. Kur lexojmë për dëlirësinë, drejtësinë, virtytshmerinë, gëzimin e bujarinë, ne mund t'i drejtohem Atij dhe të mendojmë për jetën e Tij, dhe do të shohim sesi i shfaqte Ai këto cilësi me përsosmërinë më të madhe.

Shenja dalluese e jetës së 'Abdu'l-Bahá-it është, sigurisht, shërbimi i Tij. Ju e dini se emri 'Abdu'l-Bahá do të thotë "shërbëtor i Bahá-it", dhe ky ishte titulli që Ai preferoi mbi të gjithë të tjerët që i ishin atribuar Atij. Fjalët e mëposhtme të 'Abdu'l-Bahá-it janë shprehje e dëshirës së Tij të zjarrtë për të shërbyer:

"Emri im është 'Abdu'l-Bahá. Formimi im është 'Abdu'l-Bahá. Realiteti im është 'Abdu'l-Bahá. Lëvdimi im është 'Abdu'l-Bahá. Nënshtrimi ndaj Përsosurisë së Bekuar është diadema ime e lavdishme e plot shkëlqim, dhe shërbimi ndaj mbarë gjinisë njerëzore është feja ime e përherëshme... Asnjë emër, asnjë titull, asnjë shquarsi, asnjë lavdërim nuk kam unë, dhe kurrë nuk do të kem, përveçse 'Abdu'l-Bahá. Kjo është dëshira ime më e zjarrtë. Kjo është aspirata ime më e madhe. Kjo është jeta ime e përjetshme. Kjo është lavdia ime e pasosur."¹¹

Është e qartë se ajo çfarë Alejandra planifikon të ndajë me Sanchezët në vizitën tjetër të saj nuk është më shumë sesa një prezantim i një figure tepër unike; vlerësimi i tyre për pozitën që zë 'Abdu'l-Bahá-i në këtë Dispensacion do të vazhdojë të rritet në vitet që do të vijnë. Në vetë jetën tuaj, ndërkohë që ecni në shtegun e shërbimit, ju do të keni shumë mundësira për të kujtuar me mendjen tuaj shembullin e Tij dhe për të reflektuar mbi fjalët e Tij. Tashmë, në seksionin e parë ju e familjarizuat veten me disa prej thënieve të Tij, dhe ju u inkurajuat të mësoni të shprehni në mënyrën e Tij idetë e prezantuara në Tabelat dhe në bisedat e Tij publike.

Tani për tani, që të konsolidoni të kuptuarin tuaj të tanishëm të pozitës së Tij, ju duhet të konsultoheni me anëtarët e tjerë të grupit tuaj mbi pikat kryesore të përmendura më sipër dhe të praktikoni t'i thoni ato mirë. Reflektimi mbi pasazhin e cituar do t'u frymëzojë në përpjekjet tuaja për të përparuar në shtegun e shërbimit.

PJESA 8

Pyetja që Alejandra ka patur në mendje që kur ajo filloi vizitat e saj me z. dhe znj. Sanchez është se cilat janë ato tema diskutimi, që do t'i ndihmojnë ata më shumë, të bëhen protagonistë të konfirmuar dhe aktivë të procesit komunitet-ndërtues në lagje. Nga njëra anë, ka tema si lutja, pavdekësia e shpirtit dhe qëndrueshmëria në dashurinë e Zotit, të cilat ajo shpreson t'i diskutojë me ta, pasi themelet e jetës së tyre shpirtërore duhet të forcohen vazhdimisht. Nga ana tjetër, do të jetë e rëndësishme për ta të fitojnë një vizion të llojit të komunitetit që po zhvillohet gradualisht dhe të dinë se ata po japin kontribute të vlefshme për realizimin e tij. Gjatë bisedës së saj me z. dhe znj. Sanchez rreth pozitës së 'Abdu'l-Bahá-it, Alejandra gradualisht arrin të kuptojë se cila duhet të jetë tema e vizitës së saj të ardhshme. "Ata kanë një qartësi të madhe rreth qëllimit të Besimit për të bashkuar njerëzit," mendon ajo. "Kështu, tema që ne ndoshta duhet të eksplorojmë tani është sesi të ndërtojmë dhe të mirëmbajmë një komunitet të bashkuar."

Alejandra fillon vizitën e saj të katërt duke përshkruar aktivitetet të cilat janë ndërmarrë momentalisht nga një grup relativisht i vogël miqsh në lagje. "Ndërkohë që numrat tanë rriten," shpjegon ajo, "përgjegjësia më sfiduese që ne duhet të mbajmë mbi supe do të jetë të bëhemi gjithnjë e më të bashkuar në fjalët tona, në mendimet tona dhe në veprimet tona. Nëse ju jeni dakort, atëherë sot ne mund të eksplorojmë temën e unitetit së bashku."

"Unë mund të shoh sesa i rëndësishëm është uniteti për zhvillimin e komunitetit tonë," përgjigjet znj. Sanchez.

"Dhe mbi të gjitha ishte mesazhi i Bahá'u'lláh-ut për unitetin që na tërhoqi së pari zemrat tona tek mësimet e Tij," thotë z. Sanchez.

"Unë kam zgjedhur një numër idesh dhe kam gjetur një citat për secilin," thotë Alejandra. "Nëse, ju nuk e keni problem, ne mund t'i kalojmë ato njëra pas tjetrës dhe t'i diskutojmë ato."

Më poshtë është lista e ideve të Alejandrës:

- Që një komunitet Bahá'í të jetë me të vërtetë i bashkuar, çdo besimtar duhet të largohet njëherë e mirë nga grindjet dhe zënkat. Bahá'u'lláh-u thotë:

"Asgjë në këtë Ditë nuk mund t'i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, konflikt, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë. Shmangiuni atyre me fuqinë e Perëndisë e me ndihmën e Tij sovranë, dhe përpiquni t'i bashkoni zemrat e njerëzve në emër të Tij, që është Bashkuesi, i Gjithëdijshmi, Urtiploti."¹²

- Ne duhet të kemi dashuri për këdo në komunitet, një dashuri që është një reflektim i dashurisë sonë për Zotin. ‘Abdu’l-Bahá-i thotë:

“Të jeni në unitet të plotë. Mos u zemëroni kurrë me njëri-tjetrin.... Duajini krijesat për hir të Perëndisë e jo për veten e tyre. Ju kurrë nuk do të zemëroheni as do të jeni të paduruar nëse i doni ato për hir të Perëndisë. Njerëzimi nuk është i përsosur. Ka papërsosuri në çdo qenie njerëzore, dhe ju kurdoherë do të ndiheni të hidhëruar nëse do të shpresoni te njerëzit në vetvete. Por nëse kthehemi ndaj Perëndisë, ju do t’i doni ata dhe do të jeni të përzemërt me ta, sepse bota e Perëndisë është bota e përsosurisë dhe e mëshirës së plotë.”¹³

- Nëse, megjithë dashurinë që ndiejmë për njëri-tjetrin, lindin tensione midis nesh, ne duhet menjëherë të kujtojmë këtë këshillë të ‘Abdu’l-Bahá-it:

“Ju porosis të gjithë ju t’i përqëndroni të gjitha mendimet e zemrës suaj te dashuria e uniteti. Kur të vjen një mendim lufte, kundërviju atij me një mendim më të fortë paqeje. Një mendim urrejtjeje duhet zhdukur me një mendim më të fuqishëm dashurie. Mendimet e luftës sjellin shkatërrimin e çdo harmonie, mirëqenieje, qetësie e kënaqësie.

“Mendimet e dashurisë sjellin vëllazërim, paqe, miqësi e lumturi”¹⁴

- Dhe nëse, megjithëse kemi bërë të gjitha përpjekjet për t’i mbajtur ato nën kontroll, shohim se pasionet tona po na mposhtin dhe e gjejmë veten në konflikt me të tjerët, duhet t’i kujtojmë vetes këto fjalë të Bahá’u’lláh-ut:

“Në qoftë se midis jush shfaqen mosmarrëveshje, më shikoni Mua që qëndroj para jush dhe mos shihni të metat e njëri-tjetrit, për hir të emrit Tim dhe si shenjë e dashurisë suaj për Kauzën Time të dukshme e të shndritshme.”¹⁵

- Disiplina shpirtërore për të mos vënë re gabimet e të tjerëve e për t’u përqëndruar te cilësitë e tyre të lavdërueshme dhe mosmarrja absolutisht me thashetheme është një masë tepër efektive kundër përçarjes. Kapërcimi i prirjes për të bërë thashetheme është më e lehtë kur ne e duam njëri-tjetrin. Duhet të mos harrojmë se ne priremi të mos i shohim gabimet e atyre që duam dhe nuk e kemi vështirë t’i shohim ata me syrin e mbulimit të gabimeve. ‘Abdu’l-Bahá-i thotë:

“Syri i papërsosur kap papërsosuritë. Syri që i mbulon gabimet sheh drejt Krijuesit të shpirtëve. Ai i ka krijuar ata, i ushtron e kujdeset për ta, u jep atyre aftësi e jetë, shikim e dëgjim; prandaj ata janë shenja të madhështisë së Tij. Ju duhet të doni e të jeni të përzemërt me gjithsecilin, të kujdeseni për të varfërit, të mbronin të dobët, të shëroni të sëmurët, të mësoni dhe edukoni të paditurit.”¹⁶

Bahá’u’lláh na këshillon:

“O Shok i Fronit Tim! Mos dëgjo e mos shih asnjë të keqe, mos e poshtëro veten, as mos psherëti e vajto. Mos fol keq, që të mos dëgjosh të flasin keq për ty, dhe mos i zmadho të metat e të tjerëve, që të mos duken të mëdha të metat e tua; mos

dëshiro poshtërimin e askujt, që të mos dalë në shesh poshtërimi yt. Jetoji, pra, ditët e jetës sate, që janë më të shkurtëra sesa një çast kalimtar, me mendje të pastër, me zemër të panjollë, me mendime të kulluara dhe me karakter të shenjtëruar, në mënyrë që, i lirë e i kënaqur, të flakësh tutje këtë trup të vdekshëm dhe të shkosh në parajsën mistike e të jetosh përgjithmonë në mbretërinë e përjetshme”¹⁷

Dhe Ai na thotë ne:

“O Njerëz endacakë! Ju kam dhënë gjuhën për të më përmendur Mua, mos e ndyni atë me shpifje. Në qoftë se ju mposht zjarri i egoizmit, kujtoni të metat tuaja e jo të metat e krijesave të Mia, përderisa secili prej jush njihet më mirë veten sesa një të tjerët.”¹⁸

- Uniteti, sigurisht, nuk është thjesht mungesa e kundërshtive dhe grindjeve, dhe dashuria nuk mund të shprehet vetëm me fjalë. Ne mund të themi se uniteti i vërtetë ekziston midis nesh nëse dashuria jonë për njëri-tjetrin shprehet me shërbim ndaj komunitetit dhe nëse aktivitetet tona mbizotërohen nga një shpirt bashkëpunimi dhe ndihme të ndërsjellë. ‘Abdu’l-Bahá na bën thirrje:

“Mos pushoni, as edhe për një çast, dhe mos kërkonit rehati, as edhe për një moment; përkundrazi punoni me zemër dhe shpirt që ju të mund t’i jepni shërbim të devotshëm sikur vetëm njërit prej miqve dhe t’i sillni lumturi dhe gëzim sikur vetëm një zemre të ndritshme. Kjo është mirësi e vërtetë dhe përmes kësaj syri i ‘Abdu’l-Bahá-it çelet. Jini ju shoku dhe shoqëruesi im në këtë çështje.”¹⁹

Dhe Ai shpall:

“Nevoja supreme e njerëzimit është bashkëpunimi dhe reciprociteti. Sa më të fuqishme të jenë lidhjet e miqësisë dhe të solidaritetit midis njerëzve, aq më e madhe do të jetë fuqia e dobisë dhe e arritjeve në të gjitha planet e aktivitetit njerëzor.”²⁰

- Një çelës i rëndësishëm për veprimin e sukseshëm të një komuniteti është konsultimi i çiltër e i përzemërt për çdo çështje. Nëpërmjet konsultimit mënyrat e ndryshme sesi secili prej nesh e sheh çështjen shkrihen së bashku dhe ne zbulojmë drejtimin më të mirë që duhet të ndjekim në veprimet tona kolektive. Nëpërmjet konsultimit ne arrijmë unitetin e mendimit dhe, me mendimet e këndvështrimet tona të bashkuara, krijojmë plane efikase për përparimin e komuniteteve tona. ‘Abdu’l-Bahá-i thotë për ata që konsultohen:

“Kërkesat kryesore për ata që këshillohen bashkërisht janë pastërtia e qëllimit, ndriçimi i shpirtit, shkëputja nga çdo gjë tjetër veç Perëndisë, tërheqja ndaj Aromave të Tij Hyjnore, përvuajtja e përunjësia midis të dashurve të Tij, durimi e nënshtrimi kokulur në vështirësi dhe shërbimi ndaj Pragut të Tij të lavdëruar. Po qe se ndihmohen me përdëllim që t’i fitojnë këto attribute, atyre do t’u dhurohet fitorja prej Mbretërisë së padukshme të Bahá-it.”²¹

- Uniteti i mendimit nuk është i plotë nëse nuk shndërrohet në unitet veprimi. Të veproni në unitet nuk do të thotë që të gjithë ne të bëjmë të njëjtën gjë. Në të kundërtën, në veprime të unifikuara talentet e ndryshme të anëtarëve të një komuniteti janë përdorur në maksimum. Fuqitë tona shumëfishohen, dhe madje edhe kur numri i anëtarëve tanë është akoma i vogël, ne jemi në gjendje të realizojmë atë që organizatat më të mëdha e të fuqishme në botë nuk janë të afta ta bëjnë. ‘Abdu’l-Bahá i thotë:

“Kurdoherë që shpirta të shenjtë, duke tërhequr fuqitë e qiellit, do të ngrihen me të tilla cilësi të shpirtit dhe do të ecin në mirëkuptim, me radhë të shtrënguara, secili prej këtyre shpirtave do të jetë si njëmijë, dhe valët e dallgëzuara të atij oqeani të madh do të jenë si batalionet e Tubimit të epërm.”²²

Pasi ta keni lexuar sa më sipër me kujdes dhe ta keni diskutuar përmbajtjen pikë për pikë me pjesëmarrësit në grupin tuaj, do të dëshironi ta ndihmoni njëri-tjetrin të praktikoni temën siç keni bërë me tre të parat. Ju do t’i gjeni ushtrimet më poshtë deri diku ndihmuese në përpjekjet tuaja.

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

- Asgjë në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa _____ e grindja, sherri, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë.
- Asgjë në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e _____, sherri, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë
- _____ në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, sherri, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë.
- Asgjë në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, sherri, ftohtësia e _____, midis të dashurve të Perëndisë.
- Asgjë në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, _____, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë.
- Asgjë në këtë Ditë nuk mund t’i shkaktojë kësaj Kauze më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, sherri, _____ e apatia midis të dashurve të Perëndisë.

g. Asgjë në këtë Ditë nuk mund t'i shkaktojë kësaj _____ më shumë dëm sesa mosmarrëveshja e grindja, sherri, ftohtësia e apatia midis të dashurve të Perëndisë.

2. Në citatin e dytë 'Abdu'l-Bahá-i na thotë se:

- a. Ne duhet të jemi në _____ të plotë.
- b. Kurrë të mos _____ me _____.
- c. Ne duhet t'i duam njerëzit për _____ dhe jo për ata vetë.
- d. Ne kurrë nuk do të _____ ose të _____ nëse i duam njerëzit për hir të _____.
- e. Njerëzimi nuk është _____.
- f. Ne gjithnjë do të ndjehemi të _____ nëse do të shpresojmë të _____.
- g. Nëse kthehemi ndaj _____, ne do t'i _____ njerëzit dhe do të jemi _____ me ta.

3. Në citatin e tretë 'Abdu'l-Bahá-i na thotë se:

- a. Secili prej nesh duhet t'i përqëndrojë të gjitha mendimet e zemrës së vet te _____ dhe _____.
- b. Kur ju vjen një mendim lufte, kundërvijuni atij me një _____.
- c. Një mendim urrejtjeje mund të eliminohet me _____.
- d. Mendimet e luftës sjellin shkatërrim e _____, _____, _____ e _____.
- e. Mendimet e dashurisë sjellin _____, _____, _____, e _____.

4. Çfarë duhet të bëni kur shihni të lindin mosmarrëveshje midis jush e të tjerëve në komunitetin tuaj? _____

-
-
5. Përshkruani disiplinën shpirtërore që ju ndihmon të kontribuoni në ruajtjen e unitetit në komunitetin tuaj: _____

6. Cilat prej këtyre që pasojnë kontribuojnë për Unitetin?
_____ Të shohësh gabimet e të tjerëve
_____ Të mos i vësh re gabimet e të tjerëve
_____ Të komentosh gabimet e një tjetri me një mik
_____ Të ekzagjerosh apo dhe të ndryshosh një histori me qëllim që të bësh dikë të duket i keq
_____ Të mendosh për gabimet e të tjerëve
7. Përse ne i kritikojmë disa njerëz kur bëjnë një gabim, por jo disa të tjerë kur bëjnë pikërisht të njëjtën gjë? _____

8. A është e mundur të kemi unitet në një situatë kur njerëzit merren me thashetheme për njëri-tjetrin? Pse jo? _____

9. Dihet se të thuash një gënjeshtër për dikë është e gabuar. Por a është e drejtë të bësh vërejtje kritike për dikë të tjerët lidhur me diçka që ai ose ajo vërtet e ka bërë? ____

10. Cili është ndryshimi midis përgojimit, thashethemeve dhe kritikës? _____

-
-
11. Çfarë pasojash kanë përgojimi dhe thashethemet dhe kritikrat e vazhdueshme në një komunitet? _____

12. Si mund t'i eliminojmë këto zakone nga jeta jonë? _____

13. Çfarë do të ndodhte nëse do të flisnim për njerëzit njëllor sikur të ishin të pranishëm?

14. Nëse merremi me thashetheme në sy të fëmijëve, çfarë efekti do të kishte kjo tek ata?

15. Ku e ka burimin tendenca për tu marrë me thashetheme dhe për të përfolur të tjerët?

16. Bahá'u'lláh na këshillon: “Në qoftë se ju mposht zjarri i egoizmit, _____ e jo _____, përderisa secili prej jush njih më mirë _____ sesa _____.”
17. Dashuria nuk shprehet thjesht me fjalë. Çfarë duhet tjetër? _____

18. Në lidhje me unitetin dhe dashurinë, ‘Abdu’l-Bahá na bën thirrje: “_____ as edhe për një çast dhe _____, as _____, për

një moment; përkundrazi _____ me _____
që ju të mund t'i jepni _____ sikur vetëm njërit prej miqve
dhe _____ sikur vetëm një zemre të ndritshme.
_____.”

19. Dhe Ai shpall më tej: “Nevoja supreme e njerëzimit është _____
dhe _____. Sa më të fuqishme të jenë lidhjet e
_____ dhe _____ midis njerëzve, aq më e madhe do të
jetë fuqia e _____ dhe _____ në të gjitha planet e
aktivitetit njerëzor.”
20. Cili është çelësi më i rëndësishëm për një veprim të suksesshëm të komunitetit? ____

21. ‘Abdu’l-Bahá thotë për ata që konsultohen: “Kërkesat kryesore për ata që këshillohen
bashkërisht janë _____ , _____
_____, _____ , _____
_____ midis të dashurve të Tij, _____
_____ në vështirësi dhe _____ ndaj Pragut të
Tij të lavdëruar. Po qe se ndihmohen me përdëllim që t’i fitojnë këto attribute,
_____ prej Mbretërisë së padukshme të
Bahá-it.”
22. Në lidhje me fuqinë e të punuarit në unitet, ‘Abdu’l-Bahá na tregon që: “Kurdoherë që
shpirtra të shenjtë, duke tërhequr _____ , do të ngrihen
me të tilla _____ , dhe do të ecin
_____ , me radhë të shtrënguara, _____ shpirtave do të jetë
si _____ , dhe valët e dallgëzuara të atij oqeani të madh do të jenë
si _____ e _____ .”

PJESA 9

Gjatë vizitës së saj të katërt me z. dhe znj. Sanchez, Alejandra ka kënaqësinë të takojë Beatricen, një mbesë e cila ka ardhur të jetojë me ta, ndërkohë që ndjek një shkollë të mesme aty pranë. Beatricja është shumë kurioze rreth temës së unitetit dhe merr pjesë me entuziazëm në diskutim. Ndërkohë që biseda i afrohet fundit, z. Sanchez ofron pak kek e kafe për gjithësecilin. Kjo i jep një mundësi Alejandrës që ta njohë Beatricen pak më mirë, dhe ajo arrin të lejojë një takim me të të nesërmen për të folur rreth përpjekjeve komunitet-ndërtuese në lagje.

“Ajo mund të jetë e interesuar në studimin e sekuencës kryesore të kurseve,” mendon Alejandra me vete. “Unë mund ta ndihmoj atë të kalojë librat e parë me një ritëm të qëndrueshëm. Ajo mund të dojë pastaj të fillojë një klasë fëmijësh apo të më ndihmojë mua me formimin e grupit të para të rinjve në lagje. Në atë rast, ajo mundet që gradualisht të marrë përsipër përgjegjësi për grupin ndërkohë që ajo përparon në të gjithë serinë deri tek Libri 5, gjë që do ta përgatisë atë të shërbejë si animatore.” Alejandra ka frekuentuar disa takime për të rinj të cilat, të fokusuara në tema të caktuara të diskutimit, kanë çuar në pjesëmarrjen e shumë vetave në procesin e institutit. Ajo vendos se do të ndjekë të njëjtën sekuencë ideshë në bisedën e saj me Beatricen ditën tjetër. Biseda hapet në këtë mënyrë:

Të gjithë ne dëshirojmë ta shohim botën tek bëhet një vend më i mirë. Ne mezi e presim një të ardhme kur paqja universale të jetë vendosur dhe familja njerëzore të jetojë në harmoni. Një e ardhme e tillë nuk është ëndërr dhe mund të ndërtohet ndërkohë që shumë e më shumë nga ne ushtrojnë përpjekje për përmirësimin e botës. Thellë në zemrat tona secili prej nesh ka dëshirën që t’i shërbejë komuniteteve tona. Ajo çfarë kemi nevojë është të zhvillojmë kapacitetin tonë për të ndërmarrë vepra vetmohuese shërbimi për të mirën e përbashkët.

Ne mund të mendojmë rreth shërbimit tonë ndaj njerëzimit duke imagjinuar një shteg shërbimi në të cilin ne ecim së bashku. Ky shteg është i hapur për të gjithë. Të gjithë ne zgjedhim të hyjmë në të dhe të përparojmë në të me hapin tonë. Ne nuk ecim në këtë shteg vetëm; por shërbejmë krah për krah me miqtë tanë, duke mësuar së bashku dhe duke shoqëruar njëri-tjetrin. Çdo hap që ne ndërmarrim gjeneron gëzim dhe siguri dhe çdo përpjekje që ne kryejmë sjell konfirmime hyjnore.

Beatrices i pëlqen ajo që dëgjon, dhe një bisedë e gjallë pason këtë prezantim të shkurtër. Përpara se të ecim më tej, le të pushojmë këtu dhe të reflektojmë mbi natyrën e bashkëveprimit ndërmjet dy mikeshave të reja. Alejandra ka vendosur të angazhohet në një bisedë substanciale me qëllim që të ftojë Beatricen të marri pjesë në procesin e institutit. Pse nuk do të ishte e mjaftueshme për të që thjesht t’i thotë Beatrices që një seri kursesh janë duke u ofruar nga Instituti dhe ta ftojë atë të marri pjesë në to?

PJESA 10

Biseda ndërmjet Alejandrës dhe Beatrices vazhdon për nja dy orë. Më poshtë ka disa ide shtesë që Alejandra i ndan me mikeshën e saj të re. Ne e kuptojmë sigurisht, se ajo nuk bën një prezantim të gjatë e të pandërprerë. Shumë kohë në dy orë harxhohet duke diskutuar së bashku mbi idetë e përshkruara në këto paragrafe:

Ne jemi të reja, kemi energji dhe entuziazëm të madh. Njerëzit mendojnë se jemi të pa shqetësuar. Por është krejt e kundërta; ne jemi të shqetësuar me gjendjen e vështirë të njerëzimit dhe do të donim të shihnim ndryshim të vërtetë të sjellë në shoqëri. Duhet të mendojmë gjithashtu për jetët tona—edukimin shkollor, punën, miqtë, familjen. Çdo vit ndërsa rritemi, e gjejmë veten të kemi mbi supë më shumë përgjegjësi; prindërit tanë presin shumë prej nesh. Ndonjëherë, kur unë mendoj për të gjitha përgjegjësitë e mija, unë ndihem e mbingarkuar. Më pas, kujtoj një citat nga shkrimet Bahá'í të cilin e kam mësuar përmendësh: “Jeta e njeriut ka pranverën e vet dhe është e paisur me lavdi të mrekullueshme. Periudha e rinisë karakterizohet nga forca dhe gjallëria dhe spikat si koha më e zgjedhur në jetën njerëzore.”

Ajo që do të doja të ndaja me ju është që shumë të rinj rrotull globit në komunitete si ky yni janë duke kuptuar që energjitë e tyre mund të drejtohen nga një qëllim i dyfishtë: të marrin përgjegjësi për rritjen e tyre intelektuale dhe shpirtërore dhe të kontribuojnë në transformimin e shoqërisë. Këto dy aspekte të qëllimit tonë janë të ndërlidhura. Ndërkohë që ne zhvillojmë aftësitë tona, ne jemi më në gjendje tu shërbejmë të tjerëve, dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin, ne rritemi si individë dhe forcojmë cilësitë që ne zotërojmë.

Këtu futet ideja e shtegut të shërbimit të cilën e përmenda më parë. Ecja nuk është diçka që ne thjesht ja shtojmë jetëve tona; ajo sjell kuptim në çdo gjë që ne bëjmë. Shërbimi ndaj komunitetit na ndihmon që të kuptojmë më mirë qëllimin e edukimit tonë, të qartësojmë mendimet tona rreth së ardhmes, të zhvillojmë cilësitë që kemi nevojë për të kontribuar në mirëqënien e familjeve tona. Ajo forcon miqësitë tona. Na mban larg shpërndarjes së energjive në aktivitete të parëndësishme.

Kur mendojmë për rritjen tonë shpirtërore dhe intelektuale, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm për shumë forca që na influencojnë. Disa prej tyre, si forca e diturisë, e drejtësisë, dhe e dashurisë, na lëvizin ne në drejtimin e duhur dhe ne duhet të mësojmë që ta rreshtojmë veten në krahun e tyre. Të tjerat, si forcat e materializmit dhe përqëndrimit tek vetvetja, bëjnë të kundërtën dhe ne duhet t'u rezistojmë atyre. Ne duhet të përpiqemi të arrijmë shkëlqyeshmërinë dhe të kemi besim që përpiqjet tona do të bekohen me konfirmim hyjnor.

Dhe kur mendojmë rreth kontributeve tona për transformimin e shoqërisë --- transformimin e një bote dhune, varfërie dhe vuajtjeje në një botë paqeje, përparimi dhe harmonie—na duhet të marrim në konsideratë si përparimin material edhe atë shpirtëror. Përparimi material për të gjithë njerëzit nuk do të arrihet nëse nuk do të bëjmë përparim shpirtëror gjithashtu. Vetëm nëse këto të dyja ecin krah për krah do të arrihet përmirësimi i botës. Ka një citat tjetër të cilin e kam memorizuar në kujtesë: “Civilizimi material është si një llampë, ndërkohë që civilizimi shpirtëror është si drita

në atë llampë. "Nëse civilizimi material dhe shpirtëror bëhen bashkë, atëherë do të kemi dritën dhe llampën së bashku, dhe rezultati do të jetë i shkëlqyer."

Ndërkohë që ecim në shtegun e shërbimit, mësojmë të punojmë me grupe individësh, veçanërisht fëmijë dhe para të rinj, duke i ndihmuar ata të fitojnë njohuri, aftësi, dhe veti shpirtërore. Ne gjithashtu mësojmë t'i kushtojmë vëmendje unitetit të komuniteteve tona. Individë, familje dhe organizata të cilët dëshirojnë të kontribuojnë për përparimin e komunitetit duhet të bashkëpunojnë. Ata duhet të ndërtojnë një vizion dhe qëllim të përbashkët dhe t'i lënë pas mënyrat konfliktuale.

Është e rëndësishme, pra, që si të rinj ne të zhvillojmë zakonet e bashkëveprimit harmonik me të tjerët. Ne kemi nevojë që të jemi miq: duke e shoqëruar njëri-tjetrin në punën që bëjmë, duke pranuar kontributet e njëri-tjetrit, duke inkurajuar dhe duke mbështetur njëri-tjetrin, duke parë përparësitë e njëri-tjetrit, duke kërkuar dhe duke dhënë këshilla të dobishme për njëri-tjetrin, dhe duke ndjerë gëzim në arritjet e njëri-tjetrit. Kur ecim në shtegun e shërbimit, ne duhet të veprojmë, të reflektojmë mbi veprimet tona, të konsultohemi dhe të studiojmë së bashku.

Gjatë këtyre pak dekadave të fundit, komuniteti Bahá'í ka patur sukses në ngritjen e një lloji shumë të veçantë të institucionit të të mësuarit praktikisht në çdo vend të botës. Këto institute, të cilave ne u referohemi kështu, ofrojnë kurse të cilat forcojnë aftësitë tona për t'i shërbyer komunitetit. Duke studiuar këto kurse, ne fitojmë njohuri shpirtërore dhe aftësi praktike të nevojshme për të ecur përpara në shtegun e shërbimit së bashku. Ndërsa përparojmë përmes tyre, aftësia jonë për të kryer akte gjithnjë e më komplekse të shërbimit rritet. Gjatë rrugës, ne shoqërohemi prej atyre të cilët kanë më shumë eksperiencë sesa ne dhe, me kohën, ne natyrshëm shoqërojmë miq me më pak eksperiencë. Që nga fillimi, ne të gjithë jemi protagonistë të transformimit personal dhe shoqëror, duke marrë përsipër me zell përgjegjësin për të mësuarit dhe për shërbimin tonë ndaj komunitetit.

"Të jesh një protagonist" do të thotë të kesh dëshirën të veprosh me mendje, të këmbëngulësh në përpjekjet e tua dhe të fitosh dhe aplikosh njohuri në çdo hap. Një protagonist nuk është thjeshtë një marrës pasiv përfitimesh, por një kontribues aktiv për përparim. Që dikush të jetë një protagonist duhet të mësojë të ushtrojë iniciativa krijuese dhe të disiplinuara. Kurset e Institutit na ndihmojnë ne të rrisim kapacitetin tonë për të qenë protagonistë të procesit komunitet-ndërtues.

Ne duhet të ndalojmë një moment të reflektojmë mbi idetë në paragrafët e mësipërm. Siç është përmendur në fillim të seksionit, Alejandra nuk e kishte zakon t'i paraqiste idetë thjesht njëra pas tjetrës, por do të sigurohej që Beatrice kishte mundësi të mjaftueshme për të menduar rreth tyre dhe të kontribuonte në diskutim. Ajo që mund të dëshironi të merrni në konsideratë - pasi të keni pasur një mundësi për të diskutuar çdo paragraf në grupin tuaj dhe të keni mësuar të shprehni mirë idetë - është nëse biseda është zhvilluar deri në atë pikë sa që Alejandra do të ndihej me besim në ndarjen e pak fjalëve rreth disa librave të Institutit Ruhi dhe duke e ftuar Beatricen t'i bashkohej studimit të Librit 1. A mund të shkruani në hapësirën më poshtë çfarë do të thoshit nëse ju ishit në vend të saj? Si do t'i përshkruanit Librat 1 dhe 2 dhe veprat e shërbimit që ato kërkojnë? Një referencë e shkurtër për akte shërbimi të ndërmarra në librat vijues—veçanërisht në mësimin e klasave me edukim shpirtëror për fëmijët dhe në

PJESA 12

Vizitat e Alejandrës në familjen e Sanchezëve vazhdojnë për disa javë, dhe ata kanë një mundësi për të diskutuar disa tema të cilat rrjedhin natyrshëm nga diskutimet e tyre mbi domethënien e lutjes—jeta e shpirtit, zhvillimi i vetive shpirtërore, bindja ndaj ligjeve dhe rregullave të Perëndisë dhe qëndrueshmërisë në dashurinë e Tij. Në një rast, ata gjithashtu bisedojnë paksa rreth institucioneve të Rendit Administrativ, veçanërisht rreth Asambleve Shpirtërore Kombëtare. Nuk është nevoja të marrim në konsideratë përmbajtjen e trajtuar gjatë secilës prej këtyre vizitave të njëpasnjëshme. Ka gjithësesi, dy pyetje të cilat dalin shpesh midis pjesëmarrësve në një seri bisedash të tilla si ajo që jemi duke përfytyruar. E para ka të bëjë me natyrën e takimeve të mbajtura prej komunitetit dhe e dyta me burimet financiare. Ne do ta shqyrtojmë temën e takimeve, në mënyrë specifike Festën e Nëntëmbëdhjetë Ditëve, në këtë seksion dhe ta shohim çështjen e financave tek pjesa tjetër.

Pikat që pasojnë, atëherë, mund të formojnë bazën për biseda mbi temën e Festës së Nëntëmbëdhjetë Ditëve:

- Në komunitetin Bahá'í, mbledhjet thirren për qëllime të ndryshme — për t'u lutur, për të studiuar, për të krenuar raste të ndryshme, për t'u konsultuar për punët e komunitetit dhe për t'i shërbyer komunitetit, për të diskutuar plane shërbimi. Bahá'u'lláh bën këtë premtim:

“Për Jetën Time dhe Kauzën Time! Rreth çdo vendi ku mund të hyjnë miqtë e Perëndisë e nga i cili do të ngrihet thirrja e tyre ndërsa i thurin lavde e lartësojnë Perëndinë, do të sillen qark shpirtrat e besimtarëve të vërtetë dhe të gjithë engjëjt e favorizuar.”²³

- Të dëgjuarit e Fjalës së Perëndisë në takimet mes miqve sjell gëzim në zemra dhe forcon lidhjet e unitetit. Bahá'u'lláh na këshillon:

“Është detyrë e miqve në çdo vend që të jenë, të mblidhen së bashku në takime dhe atje të flasin me urti e elokuencë, dhe të lexojnë vargjet e Perëndisë; sepse janë Fjalët e Perëndisë që ndezin e flakërojnë zjarrin e dashurisë.”²⁴

‘Abdu'l-Bahá shkruan:

“Bëni takime dhe lexoni e këndonni mësimet hyjnore, që ai vend të ndriçohet me dritën e realitetit dhe ajo tokë të bëhet një parajsë e vërtetë nga forca e Shpirtit të Shenjtë, sepse ky cikël është cikli i Zotit të Lavdishëm dhe melodia e njëshmërisë dhe e solidaritetit të botës së njerëzimit duhet të arrijë në veshët e Lindjes e të Perëndimit.”²⁵

- Nga gjithë takimet Bahá’í, Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve meriton të përmendet në mënyrë të veçantë. Kalendari Bahá’í ka 19 muaj me nga 19 ditë secili, dhe në çdo lokalitet, Bahá’ít mbledhen së bashku një herë në muaj për këtë takim siç është urdhëruar nga Vetë Bahá’u’lláh:

“Me të vërtetë, juve ju është urdhëruar të bëni një festë një herë në muaj, edhe sikur aty të shërbehet vetëm ujë; sepse Perëndia ka për qëllim t’i lidhë zemrat së bashku, si me mjete tokësore dhe me mjete qiellore.”²⁶

- Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve përbëhet nga tri pjesë. E para është pjesa devocionale, gjatë së cilës thuhet lutje dhe lexohen pjesë nga Shkrimet e Shenjta të Besimit. Pjesa e dytë është pjesa administrative, gjatë së cilës miqtë konsultohen për punët e komunitetit. Pjesa e tretë është pjesa sociale.
- Mund t’i hedhim një shikim fluturimthi rëndësisë së pjesës devocionale të Festës së Nëntëmbëdhjetë Ditëve, nga fjalët e mëposhtme të ‘Abdu’l-Bahá’it:

“O ju shërbëtorë besnikë të Bukurisë së Lashtë! Në çdo cikël e dispensacion festat i kanë pëlqyer e i kanë dashur dhe shtruarja e sofrës për ata që duan Perëndinë është konsideruar një vepër e lavdërueshme. Kjo është e vërtetë veçanërisht sot, në këtë dispensacion të pakrahasueshëm, në këtë epokë kaq bujare, në të cilën ato përshëndeten nxehtësisht, sepse me të vërtetë renditen ndër tubimet që mbahen për të adhuruar e lëvdur Perëndinë. Këtu këndohen vargjet e shenjta, oda e himne qiellore dhe zemra gjallërohet e entuziazmohet.”²⁷

- Gjatë pjesës administrative të Festës, miqtë e mbledhur dëgjojnë raporte për veprimtaritë e komunitetit Bahá’í afër e larg, konsultohen për punët e Besimit në komunitetin e tyre dhe reflektojnë lidhur me përparimin e tij, njihen me udhëzimet e dërguara nga Shtëpia Universale e Drejtësisë, reflektojnë mbi përparimin e planeve të tyre, dhe ofrojnë sugjerime për institucionet e Besimit. Konsultimet e Festës së Nëntëmbëdhjetë Ditëve kanë rëndësi të veçantë, sepse në këtë mënyrë çdo individ është në gjendje të marrë pjesë në punët e komunitetit mbarëbotëror Bahá’í.
- Përsa i përket pjesës sociale të Festës, kjo është koha për shoqëri, mikpritje. Mund të luhet muzikë, të mbahen biseda frymëzuese, të jepen shfaqje nga fëmijët, me një fjalë mund të përdoren shprehje të kulturës të zgjedhura me kujdes, që janë dinjitoze e të gëzueshme, për ta gjallëruar këtë pjesë të Festës.
- Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve është një tipar unikal i Rendit Administrativ të Besimit. Ajo bashkon aspektin devocional, administrativ e shoqëror të jetës së komunitetit. Theksi duhet të vihet njësoj mbi të gjitha këto aspekte, sepse suksesi i Festës varet nga baraspesha e drejtë midis këtyre tri pjesëve përbërëse. Në një mesazh të shkruar në

gusht 1989, drejtuar pasuesve të Bahá'u'lláh-ut kudo në botë, Shtëpia Universale e Drejtësisë thotë:

“Rendi Botëror i Bahá'u'lláh-ut përfshin të gjitha grupet e shoqërisë njerëzore; integron proceset shpirtërore, administrative dhe shoqërore të jetës; dhe kanalizon shprehjen njerëzore në format e saj të ndryshme drejt ndërtimit të një qytetërimi të ri. Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve i përfshin të gjitha këto aspekte që në vetë bazën e shoqërisë. Duke funksionuar në fshat, në qytetet e vogla e të mëdha, ajo është një institucion ku të gjithë njerëzit e Bahá-it janë anëtarë. Qëllimi i saj është të mbështesë unitetin, të sigurojë përparimin dhe të ngjallë gëzim.”²⁸

- Një ngjarje kaq e rëndësishme si Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve nuk mund të organizohet me ngut. Njëpërmjet lutjes e përsiatjes, çdo besimtar duhet ta përgatisë veten shpirtërisht për Festën dhe gjatë saj gjithsecili duhet të marrë pjesë me mendje e zemër, qoftë duke lexuar në pjesën devocionale ose thjesht duke dëgjuar pasazhet që lexohen, qoftë duke raportuar, duke marrë udhëzime ose duke bërë sugjerime, qoftë duke vepruar si mikpritësi i Festës ose thjesht si njeri që me gëzim e kënaqësi merr pjesë në mikpritjen e të zotit të shtëpisë. Në po atë letër mbi Festën e Nëntëmbëdhjetë Ditëve, Shtëpia Universale e Drejtësisë thotë:

“Aspekte të rëndësishme të përgatitjes së Festës janë zgjedhja e teksteve të përshtatshme për lexim, caktimi që më parë i lexuesve të mirë dhe një sens dekori si në paraqitjen dhe në mënyrën si pritet programi devocional. Kujdesi për mjedisin ku do të mbahet Festa, qoftë brenda ose jashtë në natyrë, ndikon së tepërmi në zhvillimin e saj. Pastërtia, rregullimi i vendit në mënyrë praktike e bukur – të gjitha luajnë një rol të rëndësishëm. Përpikmëria është gjithashtu tregues i një përgatitjeje të mirë.

“Në një masë të madhe sukcesi i Festës varet nga cilësia e përgatitjes dhe e pjesëmarrjes së individit. Mjeshtri i shumëdashur jep këtë këshillë: ‘Kushtojini rëndësi të madhe mbledhjeve të Nëntëmbëdhjetë Ditëve, në mënyrë që në këto raste të dashurit e Zotit dhe shërbëtoret e të Mëshirshmit ta kthejnë fytyrën drejt Mbretërisë, të këndojnë lutjet, t’i luten Perëndisë për ndihmë, të mbushen me gëzim e dashuri për njëri-tjetrin, të rriten nga pikëpamja e dëlirësisë dhe e shenjtërisë, e druajtjes së Perëndisë dhe e rezistencës ndaj pasioneve e vetvetes. Kështu ata do ta shkëpusin veten nga kjo botë materiale dhe do të zhyten në hovet e shpirtit’”²⁹

Si gjithmonë, ju duhet t’i lexoni disa herë me kujdes idetë e mësipërme dhe t’i diskutoni me grupin tuaj, në mënyrë që të mund t’i thoni me lehtësi. Ushtrimet e mëposhme do t’ju ndihmojnë të fitoni aftësinë për të kuptuar brendinë e Festës së Nëntëmbëdhjetë Ditëve:

1. Çfarë, na siguron Bahá'u'lláh, do të karakterizojë çdo banesë në të cilën mblidhemi së bashku për të thurur dhe për të lartësuar Perëndinë? _____

2. Në citatin e dytë më lart, Bahá'u'lláh na tregon që, kur jemi së bashku në takime ne duhet të flasim _____ dhe _____, dhe të lexojmë _____; sepse janë Fjalët e Perëndisë që _____ dhe _____.

3. Në citatin e tretë më lart, 'Abdu'l-Bahá-i na këshillon të mbajmë tubime dhe të recitojmë dhe të këndojmë Mësimet qiellore, që:
 - mund të jetë vendi në të cilin jetojmë _____.
 - toka ku ne banojmë mund të bëhet _____.

4. Sa muaj ka kalendari Bahá'í? _____

5. Sa ditë ka secili muaj? _____

6. Çfarë takimi të veçantë zhvillojnë Bahá'í-t një herë në muaj? _____

7. Cilat janë tri pjesët e Festës së Nëntëmbëdhjetë Ditëve? _____

8. A ka ndonjë radhë në zhvillimin e këtyre pjesëve të Festës? _____

9. Cili është qëllimi i pjesës devocionale të Festës? _____

10. Cili është qëllimi i pjesës administrative të Festës? _____

11. Cili është qëllimi i pjesës sociale të Festës? _____

12. Cila nga temat e mëposhtme do të ishte e përshtatshme të diskutohej në pjesën administrative të Festës?

- Nevojat financiare të sipërmarrjeve të komunitetit
- Rezultatet e skuadrës kombëtare të futbollit
- Si të zgjidhet një mosmarrëveshje midis dy anëtarëve të komunitetit
- Përparimi i klasave të fëmijëve Bahá'í në komunitet
- Kuptimi i një pasazhi që një prej anëtarëve të komunitetit ishte duke studiuar më parë gjatë javës
- Gjallëria e programit të para të rinjve në komunitet
- Mundësi vendesh pune në rang lokal të cilat hapen për të rinjtë
- Mbështetja e komunitetit mund të sigurojë grupet e para të rinjve, projektet e shërbimit të të cilëve janë bërë komplekse.
- Vizita tek prindërit e fëmijëve dhe para të rinjve pjesë e programeve edukative të nxitura nga Instituti
- Forcimi i karakterit devocional të komunitetit
- Programimi i emisioneve të shfaqura në televizion.
- Kuptimet që janë fituar rreth nxitjes së një atmosfere të gëzueshme dhe të disiplinuar në qarqet e studimit.
- Festimi i Ditës së Shenjtë të ardhshme.
- Iniciativa të veprimit social që ngrihen prej procesit komunitet-ndërtues.

13. Diskutoni pyetjen e mëposhtme me grupin tuaj: Pse është aq e rëndësishme baraspesha midis tri pjesëve të Festës?

14. Tani diskutoni dy pyetjet që vijojnë.

- a. Si do të përgatiteshit ju për Festën sikur ajo të zhvillohej në shtëpinë tuaj?
- b. Si do të përgatiteshit ju për Festën sikur të ishit thjesht pjesmarrës në të?

PJESA 13

Pyetja e dytë e cila ngrihet shpesh në biseda rreth Besimit është sesi i plotëson komuniteti Bahá'í nevojat e veta financiare. Këtu do gjeni disa pika të cilat mund t'ju ndihmojnë që t'u përgjigjeni pyetjeve të tilla:

- Instrumenti që komuniteti Bahá'í përdor për t'u kujdesur për nevojat e veta materiale është fondi Bahá'í. Ai administrohet prej Institucioneve të Besimit në nivele të ndryshme: lokale, kombëtare, kontinentale dhe ndërkombëtare. Bahá'í-t besojnë që duhet vetë ata t'i mbështesin shpenzimet e përpjekjeve për t'i dhënë shtysë Besimit të tyre, dhe prandaj Fondi pranon kontribute vetëm prej anëtarëve të komunitetit.
- Kontributi për Fondin është një akt vullnetar. Ai është konfidencial në kuptimin që është një çështje midis individit dhe institucioneve të Besimit; emrat e kontributorëve dhe shumat e dhëna nuk shpallen. Anëtarët e komunitetit nuk imponohen që të japin. Institucionet u bëjnë miqve thirrje të përgjithshme, u kujtojnë atyre rëndësinë e Fondit, dhe nxjerrin në pah nevojat e tij. Jo rrallë një komunitet vendos vetë një objektiv lidhur me aspektin e kontribimit. Por kurrë nuk caktohen shuma për individë dhe nuk kërkohen pará. I është lënë secilit individ të vendosi, sipas të kuptuarit të vet të parimeve të përfshira, për sasinë që do të japë.
- Qytetërimi që ne po përpiqemi të ngremë do të jetë i begatë, si materialisht dhe shpirtërisht. Pasuria është e pranueshme vetëm nëse plotësohen disa kushte. Atë duhet ta arrijmë me anë të një pune të ndershme dhe ta shpenzojmë për të mirën e njerëzimit. Dhe gjithë komuniteti duhet të gëzojë mirëqenie; nuk është e pranueshme që disa të jenë të pasur pamasë, ndërsa shumica nuk plotësojnë dot as nevojat minimale të jetesës. Bahá'u'lláh u thotë:

“Më të mirët e njerëzve janë ata që sipas prirjeve të tyre fitojnë mjetet e jetesës dhe i shpenzojnë për vete e për të afërmit për hir të dashurisë së Perëndisë, Zotit të të gjitha botëve.”³⁰

“... ju duhet të jepni fryte të bukura e të mahnitshme, që vetë ju dhe të tjerët të përfitoni prej tyre. Pra, është detyrë e secilit të merret me një zeje ose profesion, sepse në këtë qëndron sekreti i pasurisë, o njerëz që kuptoni!”³¹

Dhe ‘Abdu'l-Bahá shpjegon:

“Pasuria është shumë e lavdërueshme në qoftë se gjithë popullsia është e pasur. Por në qoftë se një pakicë kanë pasuri me tepri, ndërsa gjithë të tjerët janë të varfër dhe nga kjo pasuri nuk vijnë as fryte e as përfitime, atëherë ajo është një barrë për atë që e zotëron.”³²

- Që të ndërtojmë një shoqëri të lirë nga çdo padrejtësi e mjerim, ne të gjithë duhet të jemi bujarë e dhënë. Edhe pse burimet tona financiare mund të jenë të pakta, ne megjithatë duhet të japim diçka për përparimin e njerëzimit sepse mirëqenia e vërtetë mund të arrihet vetëm duke dhënë. Bujaria është një veti e shpirtit njerëzor dhe nuk ka fare të bëjë me rrethanat tona materiale. Në Fjalët e Fshehura, Bahá'u'lláh u thotë:

“Të japësh e të jesh bujar janë tipare të Miat; lum ai që stoliset me virtytet e Mia.”³³

- Nuk duhet të harrojmë se burimi i vërtetë i çfarëdo pasurie që zotërojmë është Perëndia, Bujariploti. Ai na siguron neve mjetet e jetesës; Ai bën të mundur që ne të përparojmë, dhe kur ne kontribuojmë për Fondin, shpenzojmë për Kauzën e Tij një pjesë të asaj që Ai na ka dhënë. Për Bahá’í-t pra, të japësh për Fondin e Besimit nuk është thjesht çështje bujarie; është gjithashtu një mirësi shpirtërore dhe një përgjegjësi e madhe individuale. Ruajtësi na ka thënë se:

“Ne duhet të jemi si çezma ose burimi që e zbraz vazhdimisht veten nga çdo gjë që ka dhe që vazhdimisht rimbushet nga një burim i padukshëm. Të japësh vazhdimisht për të mirën e njerëzve, pa pasur frikë nga varfëria dhe duke u mbështetur në bujarinë e pashtershme të Burimit të çdo begatie e të çdo të mire - ky është sekreti i një jetese të drejtë.”³⁴

Ju do të keni rast këtu të merrni në konsideratë disa ide më në thellësi në një kurs të mëvonshme të kësaj sekuence, e cila trajton çështjen e mjeteve materiale. Tani për tani ju jeni të inkurajuar, si gjithmonë, ta diskutoni përmbajtjen më sipër pikë për pikë dhe t’i zbatoni ushtrimet e mëposhtme në mënyrë që të mësoni t’i shprehni idetë natyrshëm dhe me lehtësi:

1. Në bazë të citateve, mbushni vendet bosh në fjalitë më poshtë.
 - a. Bahá’u’lláh na tregon që ne duhet t’i fitojmë _____ sipas prirjeve tona dhe t’i shpenzojmë për _____.
 - b. Ne duhet të japim fryte _____ dhe _____, që ne vetë dhe të tjerë _____.
 - c. Çdonjëri prej nesh duhet _____ në _____ dhe _____, pasi aty gjendet _____ i _____.
 - d. ‘Abdu’l-Bahá’i shpjegon se pasuria është _____, në qoftë se _____ është e pasur.
 - e. Por nëse _____ kanë pasuri me tepri ndërkohë që _____ janë _____, dhe asnjë _____ apo _____ nuk vjen nga ajo _____, atëherë ajo është vetëm një _____ për atë që _____.
 - f. Bahá’u’lláh thotë, “Të _____ dhe të jesh _____ janë tipare të Miat; lum ai që _____ veten me _____ e Mia.”
 - g. Dhe Ruajtësi na inkurajon të jemi si _____ ose _____ që vazhdimisht e _____ nga çdo gjë që ka dhe është vazhdimisht _____.

PJESA 14

Për të fituar kuptim të thellë brenda llojeve të bisedave të cilat mund të shpalosen në një fshat apo lagje që grupohet në aktivitet, ne kemi ndjekur përpjekjet e Alejandrës, një studente e re universiteti. Gjatë një sërë vizitash, që zënë hapësirën e disa javëve, ajo ka diskutuar me z. dhe znj. Sanchez një numër temash që, ajo shpreson, se do të ndihmojnë të thellojnë njohuritë e tyre mbi Besimin dhe do t'i forcojnë zotimet e tyre ndaj mësimëve që ata kanë përçafuar. Në fund, ardhja në skenë e Beatrices, mbesës së Sanchezëve, na mundësoi të egzaminojmë një lloj tjetër bisede, kjo midis dy të rejave, të dyja të etura të mësojnë sesi mund t'i shërbejnë komuniteteve të tyre. Kur proçedojmë përmes tregimit dhe kur zbatojmë ushtrimet, ne kemi parë se, në vazhdim të një diturie në rritje të temave që kanë lidhje me njëra-tjetrën, kërkohen veti të caktuara shpirtërore, qëndrime dhe aftësi për të mbështetur bisedën që kemi marrë në konsideratë këtu.

Në këtë pjesë dhe në pjesën tjetër të seksionit do të eksplorojmë tema të një lloji tjetër — që janë, ato që në përgjithësi trajtohen për diskutim gjatë vizitave në familje me të rinj që marrin pjesë në programe edukative të nxitura prej institutit. Siç është treguar tashmë, klasat e mësimdhënies për fëmijë dhe udhëheqja e një grup para të rinjsh si animator janë vepra shërbimi të trajtuara në kurse të njëpasnjëshme, respektivisht në Librin 3 dhe në Librin 5. Ju mundet të jeni ose jo familjarizuar me dy programet korresponduese, varet nëse keni marrë pjesë në to vetë në një moshë më të hershme.

Le të shohim, së pari, në përmbajtjen e cila shpesh formon bazën për një bisedë të vazhdueshme me familjet e para të rinjve. Ne do të imagjinojmë që ka kaluar ca kohë qëkur ne e lamë historinë tonë dhe që Beatrice është duke studiuar tani Librin 2. Alejandra i kërkon shoqes së saj nëse asaj do t'i pëlqente ta shoqëronte atë kur ajo të vizitojë familjet e disa para të rinjve të cilët janë duke themeluar një grup me ndihmën e saj. Ajo e pranon me zell të madh.

Alejandra i shpjegon Beatrices se çfarë përfytyron ajo. “Ne do të fillojmë çdo vizitë,” ajo e informon atë, “duke i prezantuar prindërit me programin ndaj të cilit djali dhe vajza e tyre kanë treguar interes për t’u bashkuar dhe duke përmendur se është pjesë e procesit komunitet-ndërtues që po ecën përpara në lagje. Ne do të eksplorojmë pra me ta disa koncepte dhe ide qendrore për programin. Kjo do të jetë e para e një serie vizitash dhe shpresa jonë është që, ndërkohë që biseda përparon me kohën, familja jo vetëm që do ta mbështeti në mënyrë aktive grupin në një seri mënyrash, por bëhet nxitëse e fuqizimit shpirtëror të para të rinjve në komunitet.”

Alejandra dhe Beatrice vazhdojnë të diskutojnë disa pika që ato planifikojnë t’i ngrenë me secilën familje. Ato vendosin të shkruajnë të gjitha idetë që ato mendojnë se janë të rëndësishme, duke e ditur se do të trajtojnë vetëm disa në vizitën e parë dhe do të trajtojnë pjesën e mbetur në bisedat pasuese. Këtu janë pikat që ato rendisin rreth potencialeve të para të rinjve:

- Në jetën e një individi, tre vitet midis moshave 12 dhe 15 janë një periudhë kritike—një fazë tranzitore nga fëmijëria në pjekuri.
- Ne shpesh ju referohemi të rinjve në këtë lloj moshe si “para të rinj”. Ata nuk janë më fëmijë, por nuk kanë arritur ende kulmin e rinisë.

- Fatkeqësisht, ekziston akoma një imazh i gabuar i përhapur gjerësisht për para të rinjt si impulsivë, rebela, egocentrikë dhe të prirur për kriza të vazhdueshme. Ne sidoqoftë, i shohim ata në një tjetër këndvështrim. Është e vërtetë që, gjatë kësaj periudhe të shkurtër të jetës, ne të gjithë provojmë ndryshime të shpejta, fizike, emocionale dhe mendore. Dhe është gjithashtu e vërtetë që si rezultat, ne mund të shfaqim ca rebelizma. Por në realitet, kjo është një moshë e një potenciali dhe premtueshmërie të madhe.
- Ne vetë ishim para të rinj jo shumë kohë më parë dhe kujtojmë sesi ishim të ndikuar prej këtyre ndryshimeve. Ndonjëherë ne ishim me kurajo dhe ndonjëherë të ndrojtur. Ndonjëherë ne ishim thuajse plotësisht të shoqërueshëm dhe herë të tjera të turpshëm. Ne shpesh shprehim dëshirën të lieshim të vetmuar, duke shpresuar ndërkohë të merrim vëmendje. Ne donim të kujtonim në çfarë gjërash ne ishim të aftë dhe se çfarë talentesh dhe aftësish ne kemi. Dhe kishte rëndësi të madhe për ne sesi njerëzit e tjerë na shihnin dhe se çfarë mendonin për idetë tona.
- Ajo që është e rëndësishme për të kuptuar është se kjo lloj sjelljeje është vetëm e përkohshme. Në jetën e një qenieje njerëzore gjatë këtyre viteve fuqi të caktuara të mendjes zhvillohen me shpejtësi. Ne fillojmë të kërkojmë përgjigje për pyetje themelore të egzistencës. Analizojmë atë çfarë lëviz rrotull nesh dhe pyesim shumë për atë që na është mësuar. Dhe ne nuk kemi aq dëshirë sa kishim më parë për të ndjekur automatikisht atë çfarë të rriturit na thonë të bëjmë, veçanërisht kur ne shohim kontradikta ndërmjet fjalëve dhe veprave të tyre.
- Nëse të rinjtë ndihmohen në aplikimin me dobishmëri të fuqive të tyre në rritje, është thelbësore që të mënjanohet trajtimi i tyre si fëmijë. Ja sesi e përshkruan ‘Abdu’l-Bahá’i këtë periudhë:

“Pas një farë kohe ai hyn në periudhën e rinisë, në të cilën gjendjet dhe nevojat e tij të mëparshme ja kanë zënë vendin kërkesave të reja të aplikueshme për përparim në nivelin e tij. Aftësitë e tij të vëzhgimit janë zgjeruar dhe thelluar; kapacitetet e inteligjencës së tij janë trainuar dhe zgjuar; caqet dhe mjedisi i fëmijërisë nuk i kufizojnë më energjitë dhe arritjet e tij.”³⁵

- Shtëpia Universale e Drejtësisë, Trupi qeverisës i Besimit Bahá’í, rreth qasjes që kemi adoptuar në punën me para të rinjtë thotë këtë:

“Ndërkohë që prirjet botërore shfaqin një imazh të kësaj grupmoshe si problematike, e humbur në grahamat e ndryshimeve fizike dhe emocionale të trazuara, të papërgjegjshëm dhe të vetëkonsumuar, komuniteti Bahá’í – në gjuhën e përdorur dhe përjasjet që përvetësojnë – është duke lëvizur vendosmërisht në drejtimin e kundërt, duke parë te para të rinjtë altruizmin, një ndjenjë të mprehtë drejtësie, zell për të mësuar mbi universin dhe dëshirë për të kontribuar në ndërtimin e një bote më të mirë.”³⁶

Alejandra dhe Beatrice e kthejnë më pas vëmendjen drejt vetë programit të fuqizimit shpirtëror dhe përpiqen të identifikojnë disa prej tipareve të tij:

- Ato ndërmjet moshave 12 dhe 13 vjeçe kanë dëshirë t'i përkasin një grupi miqsh me të cilët ata mund të ndajnë mendimet e tyre, të punojnë në projekte, të bëjnë sport dhe kështu me rradhë. Për këtë arsye, programi është ndërtuar rreth konceptit të një “grupi i para të rinjve”. Secili grup udhëhiqet nga një “animator”, shpesh një i ri më i rritur i cili, si një mik i vërtetë ndaj anëtarëve, i ndihmon ata në zhvillimin e kapaciteteve të tyre
- Grupet mblidhen rregullisht. Në takimet e tyre, para të rinjtë mësojnë të eksplorojnë koncepte dhe të shprehin ide pa frikë, censure apo talljeje. Ata inkurajohen të dëgjojnë, të flasin, të reflektojnë, të analizojnë, të marrin vendime dhe të veprojnë mbi to.
- Ne jetojmë në një kohë kur kaq shumë forca negative ndikojnë në mënyrën sesi para të rinjtë mendojnë dhe sillen. Animatorët i ndihmojnë ata t'i luftojnë këto forca— jo vetëm për të ruajtur vetveten prej degradimit moral të shoqërisë, por edhe të punojnë për përmirësimin e botës.
- Programi kërkon të ushqejë fuqitë e brendshme në shpirtin njerëzor, fuqi që gjatë adoleshencës së hershme fillojnë ta manifestojnë veten në shkallë gjithmonë e më të mëdha. Veçanërisht të rëndësishme janë fuqitë e mendimit dhe të të shprehurit. Të rinjtë duhet të zhvillojnë gjuhën e nevojshme si për të shprehur ide të thella rreth botës ashtu dhe për të artikuluar sesi ata dëshirojnë ta shohin atë të ndryshojë.
- Para të rinjtë janë të etur të reflektojnë mbi kuptimin e koncepteve themelore për një jetë me qëllim. Lumturia, shpresa dhe shkëlqyeshmëria janë disa shembuj. Me keqardhje njerëzit priren të bisedojnë rreth këtyre ideve në mënyra sipërfaqësore. Duke fituar një të kuptuar të thellë të koncepteve të tilla, duke njohur sesi ato gjejnë shprehje në jetën e përditshme, mund t'i ndihmojë mendjet e të rinjve në ndërtimin e një strukture të shëndetshme morale si dhe në përbalimin e forcave negative të shoqërisë.
- Të kuptuarit e koncepteve është themelore për zhvillimin intelektual. Para të rinjtë ndonjëherë mund të përballen me vështirësi në shkollë sepse pritët që ata të mësojnë një sasi të madhe informacioni për lëndë të ndryshme, pa marrë ndihmë të mjaftueshme për të kuptuar konceptet themelore. Programi i motivon ata të mendojnë thellësisht për idetë—morale, matematikore, shkencore dhe kështu me rradhë—dhe kjo gjithmone përmirëson rendimentin e tyre në shkollë.
- Para të rinjtë zotërojnë një dëshirë të madhe për të gjetur kuptimin e gjërave. Ata duan të kuptojnë arsyet e atyre gjërave që ndodhin rrotull tyre. Për të patur sukses, ata duhet të jenë në gjendje të shohin jo vetëm me sytë e tyre fizikë, por gjithashtu me sytë e shpirtit. Një qëllim i rëndësishëm i programit, pra, është rritja e perceptimit shpirtëror: aftësia për të njohur forcat shpirtërore dhe për të identifikuar parimet shpirtërore në situatat e ndeshura.
- Programi arrin qëllimet e veta të ndryshme – zhvillimin e moralit, perceptimit shpirtëror dhe fuqive të shprehjes – me ndihmën e një serie tekstesh. Tekstet konsistojnë në histori të thjeshta rreth jetëve të të rinjve në pjesë të ndryshme të botës. Përveç studimit të këtyre teksteve së bashku, diskutimit të përmbajtjes së tyre dhe

kompletimit të ushtrimeve të kërkuara, para të rinjtë marrin pjesë në sporte dhe mësojnë arte dhe zeje.

- Me ndihmën e animatorëve, grupet gjithashtu projektojnë si dhe zbatojnë një seri projektesh shërbimi, gjë që është një përbërës madhor i programit. Përmes këtyre projekteve, para të rinjtë mësojnë të mendojnë rreth komunitetit dhe nevojave të tij, të konsultohen, si dhe të bashkëpunojnë midis tyre dhe me të tjerë në komunitet.
- Temat e trajtuara prej teksteve janë të ndryshme; secila fokusohet mbi një temë thelbësore për fuqizimin shpirtëror të para të rinjve. Teksti i parë, për shembull, trajton temën e “konfirmimit”—që Perëndia i konfirmon përpjekjet që ne ushtrojmë për të arritur qëllime fisnike. Një tekst tjetër është rreth “shpresës”—sesi ne duhet të vështrojmë me shpresë drejt të ardhmes madje edhe gjatë kohëve më të vështira. Një tjetër e analizon konceptin e “shkëlqyeshmërisë”. “Gëzimi” është tema e një historie, ndërkohë që “fuqia e fjalës” është tema e reflektimit tek një tjetër. Midis teksteve që trajtojnë koncepte matematikore, njëri eksploron zakonet e një mendjeje të organizuar. Në fushën e shkencës, ka një tekst i cili fokusohet në të treguarin kujdes ndaj shëndetit tonë—fizik, mendor, dhe shpirtëror. Dhe ka dhjetra apo më shumë të tilla që para të rinjtë i studiojnë gjatë tre viteve.

Alejandra dhe Beatrice planifikojnë të sjellin dy prej teksteve me vete, në rast se prindërit kanë dëshirë të shohin përmes tyre. Nëse ju nuk jeni familjarizuar mirë me tekstet, mund ta shikoni ndihmueset të merrni ca kohë për të lexuar sa më shumë histori që të jetë e mundur—kjo do t’ju aftësojë ju që të ndiqni më mirë biseda të ndryshme të cilat shpalosen në komunitet. Ndërkohë, ju inkurajoheni të diskutoni plotësisht me pjesëmarrësit e tjerë në grupin tuaj të studimit idetë e prezantuara më sipër, të cilat janë trajtuar me thellësi më të madhe në Librin 5. Pasi ta keni studiuar atë libër, ju vendosni të veproni si një animator i një grupi para të rinjsh, ju do të vizitoni sistematikisht familjet e anëtarëve të tij dhe të eksploroni me ta këto ide dhe shumë të tjera të ngjashme. Por edhe tani, ashtu si Beatrice, ju mund të dëshironi të shoqëroni dikë me eksperiencë në disa vizita në familjet e para të rinjve në komunitetin tuaj.

PJESA 15

Ditën tjetër, Alejandra dhe Beatrice vizitojnë shtëpitë e tre para të rinjve të cilët do t’i bashkohen grupit të formuar në lagje. Beatrice është e lumtur të shohë entuziazmin me të cilin prindërit angazhohen në bisedë rreth programit të fuqizimit shpirtëror. Nga fundi i mbasdites, ajo është e bindur se asaj do t’i pëlqente ta ndihmonte Alejandren me grupin e para të rinjve dhe të mësojë të shërbejë vetë si një animatore e një grupi të ri, me shpresën brenda vitit. Ajo e kupton, sigurisht, që ka disa libra instituti për të përfunduar ndërkohë. Por ajo është e vendosur të përparojë me studimin e tyre me të njëjtin ritëm të qëndrueshëm që e ka çuar atë deri këtu.

Kështu që me ndihmën konstante dhe inkurajimin nga Alejandra, Beatrice ecën përpara në shtegun e shërbimit. Le ta rimarrim histrinë e saj përsëri, pra, pak muaj më pas, kur ajo është gati të mbarojë Librin 3. Lehtësuesi i qarkut të saj të studimit i ka kërkuar Maribelit, një mësuese e klasës së fëmijëve, ta ftojë Beatricën dhe miqtë e tjerë pjesmarrës që ta shoqërojnë atë, me rradhë, në vizita tek prindërit e të rinjve në një klasë të krijuar rishtas për

Nivelin 1. Beatrice e ndjen se ajo ka mesuar shume nga studimi i Librit 3. Dhe ajo di nga Alejandra, e cila ja ka permendur disa here, qe idete qe ajo ka fituar nga libri do te shtojne kapacitetin e saj per te sherbyer si animatore.

Kur ato behen bashke, Maribeli i tregon Beatrices qe ato do te vizitojne mamanë e Emës. “Ajo është një vajzë e këndshme, e vogël, e cila dashuron me zemër të mësojë,” thotë Maribeli. “Unë i kam vizituar tashmë prindërit e saj njëherë dhe u kam shpjeguar atyre natyrën e klasave Bahá’í të fëmijëve. Ata ishin të lumtur ta lejonin Emën të merrte pjesë në to. Nëna e saj shprehu një interes për të dëgjuar shumë e më shumë për klasën e fëmijëve, dhe unë i premtova të kthehesha dhe t’i flisja paksa rreth ideve edukative që nënvizohen në materialin që ne japim mësim. Unë kam shkruar aktualisht disa shënime për veten time. Nëse ju dëshironi, ne mund t’i kalojmë ato së bashku dhe të flasim rreth tyre.” Beatrice bie dakort. Ja ku janë shënimet që ato diskutojnë:

- Së pari, unë do t’i tregoj znj. Martinez sesa e lumtur jam ta kem Emën në klasë dhe do të permend disa prej vetive të saj të mrekullueshme.
- Duket se më mirë do ishte të fillohej diskutimi duke lexuar me të këtë citat prej Shkrimeve të Bahá’u’lláh:

“Shihe njeriun si një minierë të pasur në gurë të çmuar me vlerë të pamatur. Vetëm edukimi mund t’i zbulojë thesaret e tij dhe t’i japë mundësi njerëzimit të përfitojë prej tyre.”³⁷

- Unë mund të ndaj disa mendime rreth asaj sesa shumë kjo fjali më ka influencuar mua si mësuese. Zemra ime mbushet me gëzim, do thoja, sa herë që shikoj fëmijët në klasë dhe mendoj për ta si miniera plot me xhevahirë të çmuar. Çdonjëri prej tyre ka potencialin të shfaqë veti qiellore. Çdonjëri prej tyre ka talente, të cilat mund të zbulohen dhe zhvillohen. Çdonjëri prej tyre mund të rritet e të bëhet një anëtar i çmuar i shoqërisë dhe të kontribuojë për përmirësimin e botës.
- Më pas, ndoshta duhet të jap disa shembuj për xhevahiret që edukimi duhet të përpiqet të zbulojë tek çdo fëmijë. Mund të permendja disa prej fuqive të mendjes, le të themi, zbulimin e ligjeve të natyrës, prodhimin e veprave të bukura të artit dhe shprehjen e mendimeve fisnike. Fëmijët mund të fillojnë të zhvillojnë të gjitha këto fuqi, do të sqaroja, kur ata marrin një edukim të përshtatshëm. Por, që kjo të ndodhë, ata duhet të fitojnë veti të caktuara në një moshë të hershme. Për shembull, ata duhet të mësojnë të tregojnë vëmendje, të punojnë shumë kur është e nevojshme dhe të fokusohen në atë që ata janë duke bërë. Ata duhet të rriten si individë që shqetësohen për mirëqenien e të tjerëve dhe që duan t’i shërbejnë komunitetit. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të merremi me zhvillimin e karakterit të tyre në një moshë të re.
- Ky do të ishte vendi i duhur, pra, t’i kërkonim znj. Martinez të ndante me ne disa ide rreth llojit të personit që ajo do të donte të ishte vajza e saj. Cilat janë disa prej tipareve që ajo mendon që janë të rëndësishme që Ema të ketë?
- Midis vetive që ajo permend, disa, sigurisht, i takojnë kategorisë së vetive shpirtërore, që është tema tjetër që unë do të prezantoj. Do të thoja se ka veti të caktuara që një

individ duhet të zotërojë, që janë thelbësore për egzistencën njerëzore. Ato i përkasin shpirtit të qenies njerëzore. Ne i zhvillojmë ato ndërkohë që pastrojmë pasqyrën e zemrave tona në mënyrë që të reflektojmë vetitë e Perëndisë. Këtyre ne u referohemi si veti shpirtërore dhe mësimet që ne mësojmë në klasat për Nivelin 1 fokusohen në pjesën më të madhe tek këto veti.

- Mendoj se do të rreshtoj disa veti shpirtërore të trajtuara në mësimet e Nivelit 1 në Librin 3 dhe të ndaj me të citatet korresponduese. Unë do t'i shpjegoj që Ema do t'i memorizojë këto citate dhe se ajo mund t'i kërkojë vajzës së saj t'ja recitojë ato, ashtu si dhe lutjet që ajo do të mësojë:

– Dashuria :

“O Mik! Në kopshtin e zemrës sate mos mbill asgjë veç trëndafilin të dashurisë . . .”³⁸

– Drejtësia:

“Ecni në shtegun e drejtësisë, sepse ky me të vërtetë është shtegu i drejtë.”³⁹

– Vërtetësia:

“Vërtetësia është themeli i të gjitha virtyteve njerëzore.”⁴⁰

– Gëzimi:

“O Bir i Njeriut! Gëzo në ngazëllimin e zemrës sate, që të jesh i denjë të më takosh Mua e të pasqyrosh bukurinë Time.”⁴¹

Maribeli dhe Beatriçe vendosin që idetë më sipër janë të mjaftueshme për një vizitë. Ju së shpejti do të ecni vetë drejt studimit të Librit 3 dhe do të keni një mundësi të reflektoni më tej mbi disa parime të cilat i japin formë programit të Institutit Ruhi prej gjashtë vitesh për edukimin shpirtëror të fëmijëve. Nëse, përpara kesaj, del rasti që ju të vizitoni disa prindër me një mësues klasash fëmijësh, idetë e ekspozuara këtu do të provojnë të jenë ndihmuese, dhe ju duhet t'i diskutoni ato tani pikë pas pike në grupin tuaj të studimit.

PJESA 16

Më herët ne lexuam fjalët që pasojnë nga ‘Abdu’l-Bahá’i: “Sa më të fuqishme lidhjet e miqësisë dhe të solidaritetit midis njerëzve, aq më e madhe do të jetë fuqia ndërtuese dhe arritjet në të gjitha planet e aktivitetit njerëzor.” Shtëpia Universale e Drejtësisë na thotë që, kur ne bëjmë vizita në shtëpi dhe kur u zgjasim ftesat tanëve, ne “jemi duke farkëtuar lidhje shpirtërore të cilat ushqejnë një sens komuniteti.” Ne nuk duhet të nënvlerësojmë, pra, efektin e kësaj praktike në kulturën e komunitetit tonë në rritje.

Në seksionet pararendëse ne kemi parë disa lloje të veçanta bisedash që mund të zënë vend gjatë vizitave që ne kryejmë në shtëpitë e njëri-tjetrit. Të gjithë ne, ndërsa ecim në shtegun e shërbimit, do të marrim pjesë në një bisedë zgjeruese në fshatin tonë, qytezën apo lagjen, rreth aplikimit të mësimave të Bahá'u'lláh'ut në jetët tona individuale dhe kolektive. Ndonjëherë kjo do të shpalosej në një seri vizitash formale të organizuara për të mundësuar numrin e njerëzve në rritje që të thellojnë njohuritë e tyre në këto mësim. Në shumë raste të tjera, programet edukative të institutit, qëllimet e tyre dhe përmbajtja e tyre, do të jenë subjekti i diskutimit. Ftesat për t'u angazhuar në procesin komunitet-ndërtues do të zgjerohen në shumë e më shumë fqinj dhe miq. Ndërkohë që shihni në të ardhmen, pra, dhe në shtegun e shërbimit që shtrihet para jush, ju duhet të bëni çdo përpjekje që ta mësoni mirë përmbajtjen e prezantuar në këtë seksion, të fitoni eksperiencë duke biseduar për secilën temë, dhe sigurisht, të vazhdoni të thelloni njohuritë tuaja në mësimet e Bahá'u'lláh'ut. Kështu do të jetë i juaji gëzimi, që s'ka fund, i ndarjes së Fjalës Së Zotit me të tjerët.

REFERENCE

- 1 . Bahá'u'lláh, *Fjalët e Fshehura*, Tiranë 1996, nga arabishtja no. 4.
- 2 . Bahá'u'lláh, in *Lutje Bahá'í*.
- 3 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, no. IV par 1.
- 4 . Po aty, V, par. 2.
- 5 . 'Abdu'l-Bahá, in *Lutje Bahá'í*.
- 6 . Po aty.
- 7 . Po aty.
- 8 . 'Abdu'l-Bahá - 16 Gusht 1912, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] par. 23.
- 9 . 'Abdu'l-Bahá, in *Lutje Bahá'í*.
- 10 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, XLV, par. 1.
- 11 . 'Abdu'l Bahá, cituar në Shoghi Effendi, *The World Order of Bahá'u'lláh* [Rendi Botëror e Bahá'u'lláh-ut], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1991, f. 139.
- 12 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut* V, par. 5.
- 13 . 'Abdu'l-Bahá - 5 Maj 1912, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] par. 4.
- 14 . 'Abdu'l-Bahá, Bisedat e Parisit, #6:7-8, Tiranë 2000, f. 29.
- 15 . *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXLVI, par. 1.
- 16 . 'Abdu'l-Bahá - 5 Maj 1912, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] par. 4.
- 17 . *Fjalët e Fshehura*, nga persishtja no. 44.
- 18 . Po aty., nga persishtja no. 66.
- 19 . Nga një Tabel e 'Abdu'l-Bahá. (përkthim i autorizuar)
- 20 . 'Abdu'l-Bahá - 25 Shtator 1912, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] par. 2.
- 21 . *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e 'Abdu'l-Bahá*, no. 43.1.

-
22. Po aty, no. 207.3.
 23. Bahá'u'lláh, në “*Takimet Bahá'í*”: përmbledhur nga Departamenti i Kërkimeve të Shtëpisë Universale të Drejtësisë.
 24. Po aty.
 25. *Tablets of Abdul-Baha Abbas* (New York: Bahá'í Publishing Committee, 1916, 1930 printing), vëll. 3, p. 631. (përkthim i autorizuar)
 26. Bahá'u'lláh, *Kitáb-i-Aqdas*: par. 57.
 27. *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e 'Abdu'l-Bahá-it*, no. 48.1.
 28. Shtëpia Universale e Drejtësisë: nga një letër e datës 27 Gusht 1989.
 29. Po aty.
 30. *Fjalët e Fshehura, nga persishtja no. 82.*
 31. Po aty, nga persishtja no. 80.
 32. ‘Abdu'l-Bahá, *Sekreti i qytetërimit*, par. 46.
 33. *Fjalët e Fshehura, nga persishtja no. 49.*
 34. Shoghi Effendi, cituar në *Bahá'í News*, no. 13 (Shtator 1926).
 35. ‘Abdu'l-Bahá - 17 Nëntor 1912, *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale] par. 3.
 36. Shtëpia Universale e Drejtësisë: nga një letër e datës 21 Prill 2010.
 37. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXXII, par. 1.
 38. *Fjalët e Fshehura, nga persishtja no. 3.*
 39. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut*, CXVIII, par. 1.
 40. ‘Abdu'l-Bahá, cituar nga Shoghi Effendi, *Ardhja e Drejtësisë Hyjnore*, par. 40.
 41. *Fjalët e Fshehura, nga arabishtja no. 36.*